



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**STANDARDET PROFESIONALE  
TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM  
DHE LËNDOR TË MËSUESIT  
NË ARSIMIN E MESEM TË ULËT  
DHE ARSIMIN E MESEM TË LARTË**

SHTATOR 2016



# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBAJTJA</b> .....	<b>0</b>
<b>PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME</b> .....	<b>2</b>
<b>1.1 Hyrje</b> .....	<b>2</b>
<b>1.2 Përse vlejné këto standarde?</b> .....	<b>3</b>
<b>1.3 Struktura e standardit</b> .....	<b>5</b>
<b>PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM TË MËSUESIT</b> .....	<b>6</b>
<b>2.1 Përshkrimi përmbledhës</b> .....	<b>6</b>
<b>2.2 Standardet e përgjithshme të mësuesit</b> .....	<b>8</b>
<b>PJESA E TRETË: STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT SIPAS FUSHAVE LËNDORE</b> .....	<b>16</b>
<b>3.1 Standardet profesionale të fushës “Gjuhët dhe komunikimi”</b> .....	<b>16</b>
3.1.1 Standardet profesionale të mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë .....	16
3.1.2 Standardet e mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë .....	17
3.1.3 Standardet profesionale të mësuesit të gjuhëve të huaja .....	28
<b>3.2 Standardet profesionale të mësuesit të "Matematikës"</b> .....	<b>34</b>
<b>3.3 Standardet profesionale të fushës “Shkencat e natyrës”</b> .....	<b>41</b>
3.3.1 Standardet profesionale të mësuesit të fizikës .....	43
3.3.2 Standardet profesionale të mësuesit të biologjisë .....	49
3.3.3 Standardet profesionale të mësuesit të kimisë .....	53
<b>3.4 Standardet profesionale të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”</b> .....	<b>56</b>
3.4.1 Standardet profesionale të mësuesit të Shkencave Sociale.....	56
3.4.2 Standardet profesionale të mësuesit të historisë .....	72
3.4.3 Standardet profesionale të mësuesit të gjeografisë .....	79
<b>3.5 Standardet profesionale të fushës “TIK dhe teknologji”</b> .....	<b>86</b>
3.5.1 Standardet profesionale të mësuesit të TIK-ut.....	86
<b>3.6 Standardet profesionale të fushës “Edukim fizik, sporte dhe shëndeti”</b> .....	<b>95</b>
<b>3.7 Standardet profesionale të fushës “Arte”</b> .....	<b>98</b>
3.7.1 Standardet profesionale të mësuesit të artit pamor .....	99
3.7.2 Standardet profesionale të mësuesit të muzikës .....	103
<b>PJESA E KATËRT: VETËVLERËSIMI I MËSUESIT BAZUAR NË STANDARDET PROFESIONALE</b> .....	<b>107</b>


# PJESA E PARË: TË PËRGJITHSHME

## 1.1 Hyrje

Shkolla krijon kushte dhe mundësi që nxënësi: të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkohen nga shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe në mirëqenien vetjake e të shoqërisë shqiptare dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës. Zbatimi i reformës kurrikulare bazuar në kompetenca kërkon ndryshimin e rolit të mësuesit dhe të shkollës, si dhe pritshmërinë ndaj tyre. Mësimdhënia dhe të nxënit me kompetenca nuk zhvillohet në “vakum”, por kërkon mësues cilësisht të aftë për të lehtësuar të nxënit e nxënësve, si dhe t’ju sigurojnë atyre strategji, mjete dhe burime të përshtatshme për ta bërë të nxënit sa më efektiv.

Paketa e zhvillimit profesional të mësuesve, pjesë e së cilës është edhe dokumenti i standardeve profesionale të mësuesit, kërkon që zhvillimi profesional i mësuesve të ketë fokus të fuqishëm në rezultatet e nxënësit. ***Pyetja që shtrohet është: Cili është impakti i mësimdhënies te nxënësit, pra sa efektive është mësimdhënia?***

Të gjithë mësuesve duhet t’u jepet mundësia të marrin pjesë në zhvillim profesional, gjë që i ndihmon ata “të ushqehen” dhe t’i përkushtohen nxënësve në progresin dhe suksesin e tyre. Zhvillimi intensiv i vazhdueshëm profesional i orientuar me standarde dhe tregues të matshëm ndihmon mësuesit të “rriten” dhe të vlerësojnë ecurinë e performancës së tyre. “Mësuesia” është profesioni më i rëndësishëm që ndikon në formimin e brezit të ardhshëm dhe duhet të formohet dhe të zhvillohet bazuar në standarde, të cilat përcaktojnë se çfarë duhet të dijë çdo mësues, çfarë aftësish duhet të demonstrojë dhe nga ç’vlera e qëndrime duhet të karakterizohet.



Dokumenti i standardeve profesionale të mësuesit, hartuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit, ka si qëllim kryesor të përshkruajë një vizion të ri për mësimdhënien, të cilin ne frymëzojmë, me fokus plotësimin e nevojave dhe të interesave individuale të nxënësit për dijen.

- Në pjesën e parë të këtij dokumenti përshkruhen qëllimi, kujt i adresohen këto standarde, si dhe struktura e tyre.
- Në pjesën e dytë përshkruhen standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit.
- Në pjesën e tretë përshkruhen standardet profesionale sipas profileve të mësuesve.
- Në pjesën e katërt përshkruhet mënyra e vetëvlerësimit të performancës së mësuesit bazuar në këto standarde.

## 1.2 Përse vlejné këto standarde?

Standardet profesionale të mësuesit përshkruajnë atë që pritet të njohë, të kuptojë, të zotërojë dhe të demonstrojë mësuesi, si specialistë në fushën e vet.

- a) Këto standarde i vlejné së pari, **vetë mësuesit**. Mësuesi mbështetet në to për të vlerësuar performancën e tij, duke dalluar anët e veta të forta dhe nevojat, si dhe për të kuptuar më mirë përparimin e tij profesional, pra mësuesit i duhen për t'u vetëvlerësuar. Ato ndihmojnë që mësuesi në mënyrë individuale të menaxhojë vetë secilën nga fazat e mëposhtme:



Nëpërmjet këtyre standardeve mësuesi kupton **vizionin e ri për mësimdhënien**, një panoramë të asaj se ku duam të shkojmë. Për të përmirësuar cilësinë e tij, mësuesi duhet të **identifikojë nevojat** e shkollës, në përgjithësi, por edhe të tij, në veçanti. Standardet përfshijnë një sërë treguesish të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, për të cilat mësuesi tregon **angazhimin** për kryerjen me sukses të rolit të tij në shkollë. Secili në punën e tij punon duke pasur parasysh disa standarde që tregojnë sesa kompetent është ai në punë. **Nivelet e performancës** tregojnë se sa një mësuesi i përmbush këto standarde. Mësuesi që e ka të qartë se çfarë duhet të arrijë, punon në mënyrë të vazhdueshme për rritjen dhe **zhvillimin e tij profesional**. Megjithatë mësues të ndryshëm kanë nevoja të ndryshme, përsëri ka fusha për të cilat të gjithë mësuesit e shkollës

kanë nevojë për trajnime. Përmbushja e standardeve mbështet mësuesin për *progresin e tij në karrierë* dhe për kualifikimin e tij. Mësues me performancë të kënaqshme dhe me rezultate shumë të mira në kualifikim ndikon në arritjet progresive të nxënësve.

- b) Standardet profesionale të mësuesit ia lehtësojnë mjaft punën, **drejtuesit** të shkollës kur i duhet të përmbledhë nevojat profesionale të mësuesve e të menaxhojë pastaj, bashkë me ta, hartimin dhe zbatimin e planit të zhvillimit profesional të tyre. Gjithashtu, drejtuesit i vlejné edhe standardet profesionale lëndore për të vlerësuar periodikisht performancën e mësuesit, për të kuptuar ngritjen e tyre profesionale dhe për të gjetur ose për të porositur, bashkë me ta, formën e përshtatshme të zhvillimit profesional, si dhe literaturën e nevojshme profesionale. Vendimi për përzgjedhjen e një mësuesi në një institucion arsimor duhet të merret pas përgjigjes së pyetjes: “*Sa kandidati përmbush të dyja llojet e standardeve të mësuesit?*”.
- c) **Këshilli i mësuesve, ekipet lëndore, komisioni psiko- social** janë organizma të tjerë të shkollës, të cilët mund të përdorin këto standarde për t’u mbështetur në përmirësimin e klimës në shkollë, në përmirësimin e procesit të mësimdhënie- nxënies. Tashmë, ato mund të përcaktojnë më mirë temat e diskutimeve e të debateve profesionale dhe të analizojnë më thellë arritjet e nxënësve, në sajë të filozofisë që përshkojnë këto standarde.
- d) Përfaqësuesve të **komunitetit të institucionit** d.m.th., bordit të shkollës dhe këshillit të prindërve u shërben shqyrtimi i standardeve për të kuptuar cilësinë e shërbimit arsimor që ofron shkolla.
- e) **Ministria e Arsimit dhe e Sportit** niset pikërisht nga këto standarde për të formuluar politikat mbarëkombëtare të zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe për të hartuar udhëzime, urdhra dhe rregullore që kanë të bëjnë me mësuesit. Mbi këto standarde bazohet kualifikimi dhe trajnimi i mësuesve.
- f) **Instituti i Zhvillimit të Arsimit** identifikon nevojat e mësuesve për zhvillim profesional dhe harton programe e module trajnimi në nivel kombëtar.
- g) **Inspektorati Shtetëror i Arsimit** ndihmon mësuesit në përmbushjen e këtyre standardeve duke kryer vlerësimin e jashtëm të performancës së tyre.
- h) **Njësitë arsimore vendore** (DAR/ZA-të) mbështetur në standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe sipas profileve hartojnë planet e zhvillimit profesional të mësuesve, si dhe planifikojnë veprimtaritë e rrjeteve profesionale.
- i) **Fakultetet e edukimit** mbështeten në këto standarde për të hartuar në koherencë standardet e formimit fillestar të mësuesve, si dhe kurrikulën përkatëse, referuar formimit shkencor sipas profilit dhe formimit të përgjithshëm, duke i përgatitur studentët për licencim.
- j) **Këshillat dhe shoqatat e mësuesve** kanë parasysh të dy llojet e standardeve për të veçuar ato nevoja profesionale, të cilat janë më të domosdoshme për t’u plotësuar në nivel shkolle, si dhe për të planifikuar veprimtarinë e zhvillimit profesional të mësuesve dhe këshillimin profesional të tyre.
- k) Po kështu, **OJF-të, donatorët** dhe shoqatat e interesuara për zhvillimin profesional të mësuesve kanë nevojë për një dokument të plotë të standardeve profesionale të mësuesit, në

mënyrë që të ideojnë bashkëpunime të suksesshme me institucionet arsimore dhe që të për zgjedhin më mirë kontributet e tyre në arsim.

Duke unifikuar pretendimet profesionale dhe etike, standardet nuk e kufizojnë origjinalitetin dhe krijimtarinë e mësuesit, madje e nxisin atë.

### 1.3 Struktura e standardit

*Standardet profesionale të mësuesit janë pohime të cilat harmonizojnë njohuritë dhe të kuptuarin profesional, aftësitë profesionale, si dhe qëndrimet e vlerat profesionale të mësuesit.*

Struktura e standardit përmban titullin e tij dhe përshkrimin e përmbledhur të standardit. Ky standard zërthehet në *disa tregues të detajuar dhe të matshëm*, të cilat i referohen në mënyrë të harmonizuar njohurive që duhet të zotërojë mësuesi, klasifikojnë aftësitë që duhet të demonstrojë ai dhe reflektojnë qëndrimet apo vlerat që e karakterizojnë atë gjatë procesit të mësimdhënie - nxënies. Këta tregues vlerësohen sipas niveleve përkatëse, të përshkruara në këtë dokument.



# PJESA E DYTË: STANDARDET PROFESIONALE TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM TË MËSUESIT

## 2.1 Përshkrimi përmbledhës

Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit janë hartuar duke u bazuar në dokumente rekomanduese<sup>1</sup> hartuar nga Komisioni Evropian. Këto standarde janë zbërthyer në tregues, të cilët e ndihmojnë mësuesin dhe të tjerët që të përcaktojnë nëse është përmbushur dhe në ç'shikallë është përmbushur një standard i caktuar.

Standardet nuk mund të jenë të ndara prerazi nga njëri-tjetri, përkundrazi janë të ndërlidhura dhe duhen menduar si një e tërë, ku secili standard, bashkë me treguesit e tij, vështron një aspekt të rëndësishëm të mësuesit cilësor.

Standardi "*Përgatitja shkencore*"<sup>2</sup> i kushtohet zotërimit nga mësuesi i anës shkencore të lëndës, parakusht pa të cilin nuk mund të pretendohet më tej.

Standardi "*Njohuri për kurrikulën dhe planifikimi i saj*" i referohet njohurive që ka mësuesi për dokumentet kurrikulare të shkruara në nivel qendror si: Korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë, programet lëndore, zberthimi i tyre në bazë shkolle, planifikimi i tyre sipas nevojave dhe interesave të nxënësve.

Standardi "*Zhvillimi i kompetencave kyçe të të nxënësve*" bazohet në përshkrimin e tyre në ligjin për sistemin Arsimor Parauniversitar në Shqipëri. Kompetencat kyçe janë pikënisja dhe pikëmbërritja e kurrikulës. Mbi bazën e tyre hartohet dokumentacioni kurrikular dhe zbatohet e krijohet kurrikula në bazë shkolle, gjithashtu vlerësohet formimi i nxënësve. Mësuesi duhet të kuptojë thellë dobinë e tyre. Aspekte të kompetencave kyçe gjenden edhe te standardet e tjera, por te ky standard janë të përqendruara posaçërisht. Aspekte të veçanta të këtyre kompetencave theksohen në disa lëndë/fusha më shumë se në të tjerat, por të gjitha lëndët përshkohen prej tyre. Pjesë e tyre janë, gjithashtu, aftësi të tilla ndërkurrikulare si: aftësia e të menduarit kritik, aftësia e të menduarit krijues, aftësia e menaxhimit të informacionit, aftësia e të punuarit individual në mënyrë të pavarur dhe e punës në grupe, aftësia e qëndrimit etik ndaj ngjarjeve e dukurive. *Mësuesi mund t'ua kultivojë nxënësve të tij të gjitha këto aftësi, vetëm pasi ai vetë t'i ketë zotëruar mirë ato.*

Standardi "*Njohja dhe zbatimi i dokumentacionit arsimor*" merret me njohjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo mësues. Mësuesi e planifikon punën e tij mbi bazën e disa dokumenteve themelore, të cilat ndahen në dy grupime. Nga njëra anë, ai duhet të njohë mirë disa dokumente që, ndonëse nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mësimdhënien, përbëjnë themelet e tij si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Konventa e të drejtave të Fëmijëve, Ligji mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës etj. Nga ana

<sup>1</sup> "Supporting teacher competence development, for better learning"

<sup>2</sup>Ky standard përshkruhet i detajuar në pjesën e tretë të dokumentit "Standardet profesionale të mësuesit sipas profileve"

tjetër, mësuesi duhet të njohë disa dokumente themelore arsimore, pa të cilat nuk do të mund të zhvillonte proces mësimor sipas këtyre standardeve si ligji për Sistemin Arsimor Parauniversitar, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, udhëzime të tjera të MAS-it që lidhen me procesin e mësimdhënie -nxënies.

Një standard tjetër përqendrohet posaçërisht te *“Mësimdhënia dhe nxënia”*. Mësuesi bashkëkohor nuk është vetëm transmetues i të vërtetave të pranura dhe as thjesht vlerësues i zotërimit të tyre nga nxënësit. Ai ka tanimë role të shumëfishta, çka e bën këtë profesion, një sfidë përherë e më interesante. Mësuesi i sotëm është edhe person burimor, lehtësues i procesit të të nxënimit dhe këshillues i nxënësit. Nuk ekziston një metodë universale e mësimdhënies që mund të përdoret kudo dhe përherë. Merita e mësuesit është të njohë e të përdorë larmi metodash dhe të përzgjedhë njërën ose një kombinim të atyre, sipas natyrës së njohurive që nxënësit do të përvetësojnë, aftësive e qëndrimeve që duhet të formojnë, sipas veçorive të nxënësve dhe interesave e dëshirave të tyre.

*“Vlerësimi i të nxënimit”*, si një përmasë e veçantë e procesit të mësimdhënie - nxënies, zë një standard më vete. Mësuesi duhet të përqendrohet më shumë te vlerësimi i procesit të të nxënimit se sa te produkti, duke përdorur larmi strategjish e praktikash. Qëllimi i vlerësimit për të nxënë i nxënësit nuk është thjesht nota dhe nuk përfundon shpesh me notë, por synon përmirësimin e të nxënimit.

Si një plotësim, madje më shumë si një theksim i standardit për mësimdhënien dhe nxënien është standardi *“Gjithëpërfshirja dhe përkujdesja ndaj nxënësit”*. Ky standard trajton në mënyrë të posaçme përkujdesjen që mësuesi duhet të ketë për suksesin e çdo nxënësi e veçanërisht për nxënësit me vështirësi në të nxënë.

Standardi *“Zhvillimi profesional individual”* e vështron mësuesin si nxënës gjatë gjithë jetës. Një mësues cilësor është në përmirësim të paseshtur, në sajë të reflektimit ndaj përvojës së tij të përditshme, përvojave të kolegëve të tij dhe qëmtimit në literaturën profesionale. Pikënisja e reflektimeve të tij janë arritjet e nxënësve të tij dhe qëllimi i vetëm është përmirësimi i këtyre arritjeve.

Standardi *“Bashkëpunimi me kolegët dhe puna në grup”* parashtron ato kërkesa ndaj mësuesit që e bëjnë atë një anëtar produktiv në bashkëpunimin me kolegët e tij. Te formimi i një nxënësi ndikojnë të gjithë mësuesit e tij brenda një shkolle dhe nëse përveç dallimeve të natyrshme midis tyre, këta mësues do të kenë diferenca të mëdha për sa i përket filozofisë së kurrikulës së zbatuar, atëherë ndikimet tek ai nxënës nuk do të jenë konvergjente dhe nxënësit do të përfitonin shumë më pak nga sa do të mundnin. Mësuesi nuk është vetëm dhe thjesht mësues lëndor, por edhe pjesëtar i një komuniteti profesionistësh që interesohet dhe punon për institucionin në të gjitha aspektet e saj.

Standardi *“Bashkëpunimi me komunitetin”* parashtron nëpërmjet treguesve të tij, pretendimet ndaj mësuesit për krijimin e një marrëdhënieje të frytshme e të vazhdueshme me komunitetin, kryesisht, me prindërit e nxënësve për të zhvilluar shkollën si qendër komunitare. Prindërit janë mësuesit e parë të fëmijës, i kuptojnë më mirë dhe kanë aspiratat më këmbëngulëse për ta. Për



këtë arsye, prindërit janë bashkëpunëtorët e natyrshëm dhe më aktivë të mësuesit. Komunikimi prindër-mësues është thelbësor për të shtuar mundësitë në përmirësimin e arritjeve të nxënësve.

Standardi "*Komunikimi dhe etika*" përmban tregues mbi etikën, parimet e komunikimit dhe sjelljen e mësuesit, si themeli mbi të cilin ndërtohen të gjitha meritat e tjera profesionale.

Së fundmi, standardi "*Vlerat dhe qëndrimet profesionale*" përshkruan vlerat dhe qëndrimet që karakterizojnë mësuesin gjatë karrierës së tij si profesionist.

Veç këtyre standardeve të përgjithshme, çdo mësues duhet të përmbushë edhe standardet profesionale sipas profileve lëndore për të cilat është diplomuar. Kështu p.sh., mësuesi i matematikës duhet të përmbushë si standardet profesionale të formimit të përgjithshëm, po ashtu edhe standardet profesionale të profilit të matematikës.

## 2.2 Standardet e përgjithshme të mësuesit

### Standardi 1: PËRGATITJA SHKENCORE<sup>3</sup>

#### 1.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron anën shkencore të lëndës si parakusht pa të cilin nuk mund të pretendohet puna e tij e mëtejshme.

#### 1.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 1.2.1. zotëron strukturën shkencore të lëndës dhe konceptet themelore bashkëkohore të saj;
- 1.2.2. zotëron metodat e kërkimit shkencor të lëndës;
- 1.2.3. njih lidhjet shkencore të lëndës me lëndët e tjera;
- 1.2.4. njih historinë e zhvillimit shkencor të lëndës;
- 1.2.5. zotëron njohuri të lëndëve të tjera, të cilat janë të domosdoshme për lëndën e tij;
- 1.2.6. është në dijeni të risive kryesore shkencore që i përkasin lëndës.

### Standardi 2: NJOHURI PËR KURRIKULËN DHE PLANIFIKIMIN E SAJ

#### 2.1. Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron njohuri që lidhen me përmbajtjen e dokumenteve kurrikulare, programeve lëndore, zberthimin e tyre në bazë shkolle, planifikimin e tyre sipas nevojave dhe interesave të nxënësve.

#### 2.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 2.2.1. njih dhe shfaq kuptueshmëri të plotë për komponentët kryesorë që përmbajnë

<sup>3</sup>Ky standard përshkruhet i detajuar në pjesën e tretë të dokumentit "Standardet sipas profileve"

- dokumentet kurrikulare;
- 2.2.2. kupton dhe analizon të gjitha komponentët e programit lëndor;
  - 2.2.3. lidh njohuritë e lëndës që jep mësim me njohuritë e disiplinave të tjera që zhvillohen në shkollë;
  - 2.2.4. planifikon kurrikulën sipas nevojave të nxënësve;
  - 2.2.5. planifikon rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës;
  - 2.2.6. siguron koherencë në planifikim duke lidhur të gjitha dokumentet kurrikulare;
  - 2.2.7. vlerëson burimet e ndryshme të mësimdhënies dhe materialet kurrikulare që ndihmojnë në prezantimin sa më të qartë dhe më të dobishëm të ideve dhe të koncepteve.
  - 2.2.8. zhvillon dhe përdor kurrikul shkollore që i nxit nxënësit të kërkojnë, pyesin dhe interpretojnë idetë nga këndvështrime të ndryshme.

### **Standardi 3: ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇE TË TË NXËNIT**

#### **3.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi zotëron kompetencat kyçe, të cilat janë pikënisja dhe pikëmbërritja e kurrikulës. Ai ua kultivon nxënësve të tij të gjitha këto kompetenca, vetëm pasi t'i ketë zotëruar vetë ato.

#### **3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1. ka një kuptim të qartë për kompetencat kyçe dhe mënyrat e mishërimit të tyre në procesin e mësimdhënies e nxënies dhe të vlerësimit të nxënësve;
- 3.2.2. aftëson nxënësit të komunikojnë me argumente, qartë, rrjedhshëm, me fjalor të pasur, me fjali të strukturuar mirë, duke respektuar drejtshkrimin ose drejtshqiptimin dhe përdorur larmi mënyrash sipas qëllimit të komunikimit;
- 3.2.3. aftëson nxënësit të jenë dëgjues të vëmendshëm dhe të nxjerrin në pah idetë themelore;
- 3.2.4. zotëron teknikat e të shkruarit, hartimit të eseve dhe i aftëson nxënësit të shkruajnë ese;
- 3.2.5. aftëson nxënësit duke zhvilluar të menduarin argumentues, analizues, vlerësues, krahasues etj.;
- 3.2.6. kultivon te nxënësit aftësitë digjitale, aftësitë e përdorimit të TIK-ut për realizimin e objektivave të programit lëndor;
- 3.2.7. kultivon te nxënësit aftësitë personale dhe sociale;
- 3.2.8. kultivon te nxënësit aftësinë e të menduarit kritik, të menduarit krijues, aftësinë për të punuar në grup brenda në klasë dhe jashtë saj;
- 3.2.9. krijon rregullisht mundësinë që nxënësit të përballen me sfida dhe të papritura, për të cilat zbatohen skemat e zgjidhjes së situatave problemore;
- 3.2.10. përdor strategjitë dhe metodat e aftësimit të nxënësve për punë të pavarur individuale, brenda dhe jashtë klase;
- 3.2.11. përzgjedh, sipas dobisë për nxënësit, midis punës individuale të nxënësve, punës së tyre me grupe të vogla dhe punës me të gjithë klasën;

- 3.2.12.** ushtron nxënësit të mbajnë qëndrim etik aktiv ndaj ngjarjeve, dukurive, pikëpamjeve e sjelljeve nga këndvështrimi i vlerave demokratike;
- 3.2.13.** kultivon te nxënësit kompetencën e marrjes së nismave dhe të sipërmarrjes.

#### **Standardi 4: NJOHJA DHE ZBATIMI I DOKUMENTEVE ARSIMORE**

##### **4.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi zotëron njohuri për dokumentacionin e nevojshëm për çdo mësues, pa të cilin nuk do të mund të zhvillonte procesin mësimor sipas këtyre standardeve.

##### **4.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

**4.2.1.** ka njohuri<sup>4</sup>për:

- a) legjislacionin shqiptar që ka të bëjë drejtpërdrejt ose tërthorazi me veprimtarinë e tij;
- b) strategjitë arsimore;
- c) aktet nënligjore, urdhrat dhe udhëzimet e ministrisë që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij;

**4.2.2.** njeh procedurat e organizimit të institucionit arsimor;

**4.2.3.** ka një kuptueshmëri të plotë të strukturave që funksionojnë në shkollë;

**4.2.4.** njeh standardet e përgjithshme të mësuesit dhe të mësuesit lëndor.

#### **Standardi 5: MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT**

##### **5.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi zotëron njohuri dhe aftësi në përdorimin e një larmie metodash sipas natyrës së njohurive që nxënësit do të përvetësojnë, aftësive e qëndrimeve që duhet të formojnë, sipas veçorive të nxënësve dhe interesave e dëshirave të tyre.

##### **5.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

**5.2.1.** përdor praktika të larmishme të procesit të mësimdhënie - nxënies, në mënyrë krijuese, në përputhje me veçoritë e nxënësve;

**5.2.2.** motivon nxënësit me larmi mënyrash duke krijuar një atmosferë të nxëni intensiv dhe me emocione të këndshme;

**5.2.3.** vendos, vazhdimisht, nxënësit përballë sfidave të të nxënit, por duke mos i mbingarkuar në vëllim njohurish dhe me shkallë vështirësie;

**5.2.4.** shmang shtjellimin vetëm teorik të lëndës duke e konkretizuar rregullisht dhe duke u

<sup>4</sup>"Ka njohuri mbi një dokument" do të thotë që mësuesi të jetë në gjendje t'u përgjigjet pyetjeve mbi ato pjesë të dokumentit që lidhen me detyrat e tij, duke sjellë shembuj konkret të zbatimit.

- kërkuar nxënësve ta konkretizojnë me situata të jetës së tyre të përditshme dhe me dukuri të botës reale;
- 5.2.5.** aftëson nxënësit të thellojnë konceptet dhe pasurojnë informacionet e tekstit shkollor me anën e burimeve të larmishme plotësuese, përfshirë vëzhgimet e dukurive dhe bisedat me persona burimorë;
- 5.2.6.** kultivon te nxënësit integrimin e lëndëve dhe të fushave të të nxënit;
- 5.2.7.** organizon mësimdhënien dhe nxënien sipas rezultateve të të nxënit;
- 5.2.8.** harton dhe zbaton projekte kurrikulare në bashkëpunim me nxënësit duke nxitur nismat e tyre;
- 5.2.9.** merr pjesë aktive në hartimin e kurrikulës me zgjedhje të lirë duke bashkëpunuar me nxënësit dhe prindërit e tyre;
- 5.2.10.** zotëron një kuptim të qartë mbi temat ndërkurrikulare dhe i trajton ato nëpërmjet lëndës/lëndëve;
- 5.2.11.** nxit përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar dhe lehtësuar procesin e mësimdhënies dhe të nxënit<sup>5</sup>.

## **Standardi 6: VLERËSIMI I TË NXËNIT**

### **6.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi zotëron njohuri dhe aftësi të përdorë larmi metodash sipas natyrës së njohurive që nxënësit do të përvetësojnë, aftësive e qëndrimeve që duhet të formojnë, sipas veçorive të nxënësve dhe interesave e dëshirave të tyre.

### **6.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 6.2.1.** mban në fokus vlerësimin për të nxënë dhe vlerësimin e të nxënit, kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit të programeve lëndore;
- 6.2.2.** vlerëson jo thjesht faktet, por kryesisht formimin e koncepteve bazë dhe lidhjet në mes tyre;
- 6.2.3.** mbledh informacione dhe përdor evidenca për ecurinë e të nxënit të nxënësit;
- 6.2.4.** zbaton teknika alternative të vlerësimit për të nxënë dhe të arritjes së rezultateve të të nxënit;
- 6.2.5.** zbaton teorinë dhe praktikën e hartimit të testeve e të përpunimit statistikor të tyre;
- 6.2.6.** zotëron praktikën e vlerësimit të nxënësve në projekte kurrikulare (portofolin e nxënësit);
- 6.2.7.** sqaron paraprakisht nxënësit për kriteret dhe mënyrën se si do të vlerësohen;
- 6.2.8.** nxit dhe ushtron nxënësit të reflektojnë mbi të nxënit e tyre, të vetëvlerësohen dhe të vlerësojnë njëri-tjetrin;

<sup>5</sup> Standardet e mësuesit për përdorimin e TIK dhe teknologjisë në mësimdhënie janë në dokument të veçantë

**6.2.9.** ushtron nxënësit të reflektojnë dhe të analizojnë anët e forta dhe anët e dobëta në përvetësimin e lëndës.

## **Standardi 7: GJITHËPËRFSHIRJA DHE PËRKUJDESJA NDAJ NXËNËSIT**

### **7.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi zotëron njohuri dhe aftësi për gjithëpërfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe përkujdeset për suksesin e çdo nxënësi e veçanërisht për nxënësit me vështirësi në të nxënë.

### **7.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 7.2.1.** zbaton teorinë e inteligjencave të shumëfishta në veprimtarinë e tij me nxënësit;
- 7.2.2.** zbaton teknika të gjithëpërfshirjes së nxënësve në procesin mësimor;
- 7.2.3.** organizon aktivitete të përbashkëta me nxënësit dhe u jep mundësi të gjithëve të japin kontributin e tyre;
- 7.2.4.** këshillohet me mësuesit e tjerë dhe me psikologun për të identifikuar barrierat e të nxënësve të veçantë;
- 7.2.5.** përdor strategji të diferencuara mësimdhënieje e nxënieje sipas interesave të nxënësve:
  - a) duke hartuar programe mësimore të individualizuara;
  - b) duke u kushtuar më shumë kohë jashtë klase, nxënësve me vështirësi në të nxënë;
- 7.2.6.** krijon në klasë një kulturë mikpritjeje dhe bashkëpunimi nga nxënësit e tjerë për nxënësit me aftësi të kufizuara;
- 7.2.7.** bashkëpunon posaçërisht me prindërit e nxënësve me vështirësi në të nxënë.

## **Standardi 8: ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE INDIVIDUAL**

### **8.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi demonstroi aftësi për të nxënë gjatë gjithë jetës. Ai përmirësohet përshtur, në sajë të reflektimit ndaj përvojës së tij të përditshme, përvojave të kolegëve të tij dhe qëmtimit në literaturën profesionale.

### **8.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 8.2.1.** reflekton vazhdimisht ndaj praktikave të tij mësimdhënëse;
- 8.2.2.** identifikon vazhdimisht nevojat e tij individuale për zhvillimin profesional;
- 8.2.3.** bashkëpunon rregullisht me kolegët, brenda ose jashtë institucionit arsimor, me specialistët, prindërit e nxënësit, për të përmirësuar praktikën e veta mësimdhënëse;
- 8.2.4.** krahason arritjet e nxënësve të tij me arritjet e nxënësve në nivel vendor dhe kombëtar, për të pikasur burimet e tij të suksesit dhe shkaqet e mangësive të tij;

- 8.2.5. harton dhe zbaton planin e zhvillimit të tij profesional për të përmirësuar arritjet e nxënësve;
- 8.2.6. merr pjesë rregullisht në takimet profesionale si atë të këshillit të mësuesve, të ekipit lëndor, të rrjetit profesional sipas profilit etj., përgatitet seriozisht për to, është aktiv në to, ndan përvojat e shqetësimet dhe parashtron ide të reja;
- 8.2.7. studion rregullisht literaturë profesionale nga burime të ndryshme, përfshirë dhe atë elektronike, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.

## **Standardi 9: BASHKËPUNIMI ME KOLEGËT DHE PUNA NË GRUP**

### **9.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi demonstroi aftësi bashkëpunuese të punës në grup me kolegët e tij, duke treguar që ai nuk është vetëm thjesht mësues lëndor, por edhe pjesëtar i një komuniteti profesionistësh që interesohet dhe punon për institucionin në të gjitha aspektet e tij.

### **9.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 9.2.1. bashkëpunon me kolegët për përmirësimin e punës në institucion;
- 9.2.2. mirëpret dhe nxit risitë e kolegëve, propozimet e nismat e tyre për përmirësimin e kushteve të të nxënësve;
- 9.2.3. propozon ose ndërmerr nisma për përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe të nxënësve në institucion;
- 9.2.4. ndihmon mësuesit e rinj;
- 9.2.5. punon në grupe pune, në komisione lëndore dhe në përbërje të ekipit të shkollës;
- 9.2.6. angazhohet për të arritur objektiva të përbashkëta në nivel shkolle;
- 9.2.7. përfshihet në bashkëpunimet dhe bashkëveprimet, kudo ku ia kërkon puna.

## **Standardi 10: BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN**

### **10.1. Përshkrimi i standardit**

Mësuesi demonstroi aftësi për marrëdhënie të frytshme e të vazhdueshme me komunitetin, kryesisht me prindërit e nxënësve, për të zhvilluar shkollën si qendër komunitare.

### **10.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 10.2.1. beson se bashkëpunimi i vazhdueshëm me prindërit është i domosdoshëm për përmirësimin e arritjeve të fëmijëve të tyre dhe të nxënësve në përgjithësi;
- 10.2.2. përdor mënyra të larmishme të komunikimit dhe të bashkëpunimit me prindërit dhe me komunitetin;
- 10.2.3. u siguron prindërve, drejtpërdrejt, informacionet e nevojshme dhe në kohën e duhur për arritjet e fëmijës së tyre;



- 10.2.4.** organizon aktivitete me nxënësit duke përfshirë edhe komunitetin;
- 10.2.5.** nxit prindërit të japin ndihmesën e tyre vullnetare, sipas njohurive dhe profesioneve të tyre:
- si persona burimore për nxënësit e mësuesit;
  - për të hartuar ose për të vënë në jetë module me zgjedhje;
  - për të bashkëpunuar në projekte kurrikulare;
  - për të punuar me nxënës me vështirësi në të nxënë;
- 10.2.6.** nxit prindërit dhe kujdestarët që të marrin pjesë në diskutime rreth ecurisë dhe mbarëvajtjes së nxënësve.

## **Standardi 11: KOMUNIKIMI DHE ETIKA**

### **11.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi zotëron njohuri për etikën, parimet e komunikimit, si dhe demonstroi aftësi të zbatimit të tyre në sjelljen e tij, si themeli mbi të cilën ndërtohen të gjitha meritat e tjera profesionale.

### **11.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 11.2.1.** respekton të drejtat e liritë e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve dhe është i aftë të krijojë në mjediset e të nxënësve atmosferën ku respektohen këto të drejta;
- 11.2.2.** krijon një mjedis miqësor për nxënësit;
- 11.2.3.** nuk ushtron diskriminim, dhunë, keqtrajtim e dëm moral të nxënësve dhe të personeli;
- 11.2.4.** kultivon te nxënësve respektin ndaj dallimeve individuale, kulturave të etnive dhe të popujve të tjerë:
- duke përdorur stile dhe praktika të ndryshme të komunikimit me nxënësve, kolegët, prindërit etj.;
  - duke komunikuar hapur, në mënyrë korrekte, bindëse dhe frymëzuese me nxënësve;
  - duke krijuar në mjediset e të nxënësve frymën e komunikimit të hapur e të lirshëm të nxënësve me të dhe të nxënësve në mes tyre;
- 11.2.5.** krijon një atmosferë, ku nxënësve ndjehen të lirshëm të pyesin atë dhe shokët dhe të mos kenë frikë se gabojnë, si dhe kultivon kurajën e tyre për të shprehur mendimin vetjak;
- 11.2.6.** është transparent në veprimtarinë e tij dhe krijon në mjediset e të nxënësve kulturën e transparencës;
- 11.2.7.** është i hapur ndaj gabimeve të tij dhe krijon në mjediset e të nxënësve një klimë të hapur dhe reflektuese;
- 11.2.8.** përdor metoda të ndryshme të negociimit, të zgjidhjes së konflikteve dhe të arritjes së konsensusit në marrëdhëniet me kolegët, me nxënësve dhe të nxënësve mes tyre;
- 11.2.9.** shmang çfarëdo lloj konflikti interesi dhe njofton drejtorin e institucionit për raste të tilla.

## Standardi 12: VLERAT DHE QËNDRIMET PROFESIONALE

### 12.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesi zotëron dhe demonstroi vlera dhe qëndrime që karakterizojnë mësuesin gjatë karrierës së tij si profesionist duke qenë një model pozitiv për nxënësin.

### 12.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 12.2.1. është i përkushtuar, entuziast dhe i aftë të krijojë te nxënësit një kulturë përkushtimi e entuziazmi;
- 12.2.2. nxit te nxënësit dashurinë për lëndët dhe për shkollën;
- 12.2.3. nxit te nxënësit përdorimin e teknologjisë dhe pajisjeve digjitale në procesin e mësimdhënies dhe nxënies<sup>6</sup> për të rritur efektivitetin e këtij procesi;
- 12.2.4. nxit idetë origjinale të nxënësve dhe i ndihmon ata në prezantimet e tyre nëpërmjet detyrave krijuese dhe projekteve kurrikulare;
- 12.2.5. promovon të nxënësit duke e bërë atë të ndihet i suksesshëm;
- 12.2.6. respekton punën e nxënësit (personale dhe në grup) dhe nxit pranimin me tolerancë të opinionëve të tjerëve (madje edhe të kundërta);
- 12.2.7. nxit nxënësit të mësojnë nga gabimet e tyre dhe të përballen me sfidat në shkollë;
- 12.2.8. vlerëson rregullisht veten mbi bazën e standardeve profesionale të mësuesit dhe standardeve të mësuesit lëndor;
- 12.2.9. përdor me efektivitet kohën e punës;
- 12.2.10. kujdeset për kushtet shëndetësore, të higjienës, të sigurisë nga rreziqet dhe për kushtet ekologjike në mjediset e mësimdhënies.

<sup>6</sup> Përdorimi nga mësuesi i teknologjisë në procesin e mësimdhënies – nxënies trajtohet në dokument të veçantë.

## **PJESA E TRETË: STANDARDET PROFESIONALE TË MËSUESIT SIPAS FUSHAVE LËNDORE**

### **3.1 Standardet profesionale të fushës “Gjuhët dhe komunikimi”**

#### **Përshkrim përmbledhës**

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” u mundëson nxënësve të zhvillojnë dhe të përdorin gjuhët si mjete komunikimi në jetën e përditshme, si dhe në veprimtaritë e tyre mësimore e shoqërore.

Nëpërmjet kësaj fushe nxënësit shprehin dhe interpretojnë koncepte, ide, ndjenja, fakte e opinione me gojë e me shkrim; zhvillojnë aftësitë për të lexuar, shkruar, folur dhe dëgjuar në mënyrë aktive dhe të qëllimshme; dallojnë dhe përdorin tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare, tekste të shtypura dhe elektronike; gjejnë, krahasojnë, analizojnë e vlerësojnë informacione të ndryshme; zotërojnë njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e duhura rreth sistemit gjuhësor; e përdorin gjuhën në mënyrë pozitive dhe të përgjegjshme në marrëdhëniet shoqërore; kuptojnë, analizojnë dhe vlerësojnë tekste të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare, nga krijimtaria e autorëve që janë përfaqësues të periudhave të ndryshme nga letërsia shqipe dhe ajo botërore.

Kjo fushë përfshin lëndët: Gjuhë shqipe, Gjuha e huaj e parë, Gjuha e huaj e dytë. Më poshtë janë dhënë standardet e mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë dhe të mësuesit të gjuhës së huaj.

#### **3.1.1 Standardet profesionale të mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë**

##### **Përshkrim përmbledhës**

Gjuha amtare është një pasuri e çmuar njerëzore. Ajo u krijon mundësi njerëzve të zbulojnë veten, të njohin botën rreth tyre, të ndërtojnë marrëdhënie me të tjerët, të shprehin ndjenjat, t’u japin jetë ëndrrave, shpresave dhe prirjeve e tyre, të zgjidhin probleme, si dhe të prezantojnë njohuritë dhe idetë që kanë për çështje të ndryshme. Ndërsa letërsia u pasuron botën emocionale dhe u zhvillon ndjenjës e së bukurës. Duke qenë kaq të rëndësishme në jetën njerëzore, gjuha shqipe dhe letërsia janë trajtuar si të tilla edhe në kurrikulën e shkollës.

Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë ndërtojnë dhe zhvillojnë te nxënësit njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime rreth të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit, si dhe rreth sistemit gjuhësor. Kështu, përmes të lexuarit nxënësit lidhen me botën dhe me njerëzit e tjerë. Duke lexuar ata përjetojnë emocione të bukura, takohen me kultura dhe ngjarje të panjohura më parë, njihen dhe admirojnë personazhe që vijnë nga kohë dhe vende të ndryshme etj. Leximi u krijon mundësi nxënësve që të diskutojnë rreth librave, të ndërtojnë së bashku kuptimin e tyre, rrjedhimisht edhe të ndërtojnë marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin.

Nëpërmjet të shkruarit dhe të folurit nxënësit mund të prezantojnë idetë e tyre, mund të bëhen faktorë të ndryshimeve shoqërore, si dhe mund të krijojnë mundësi të reja për veten dhe për të tjerët.

Nëpërmjet gjuhës shqipe dhe letërsisë në shkollë, nxënësit vlerësojnë pasurinë e gjuhës dhe aspektet estetike të saj. Ato mundësojnë zhvillimin e kompetencave për të nxënit gjatë gjithë jetës. Suksesi dhe arritjet në këto lëndë kanë një ndikim të fuqishëm në arritjet e nxënësve edhe në lëndët e tjera shkollore, si dhe në jetën personale dhe shoqërore.

### **3.1.2 Standardet e mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë**

Çdo nxënës meriton një mësues të kualifikuar, një mësues i cili e pajis me njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet e domosdoshme për të përmbushur me sukses kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës. Për të plotësuar këtë kërkesa janë hartuar standardet e mësuesit. Standardet përshkruajnë se çfarë duhet të dijë, çfarë duhet të jetë i aftë të bëjë, si dhe çfarë vlerash dhe qëndrimesh duhet të demonstrojë një mësues. Standardet e mësuesit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë janë një dokument që plotëson standardet e përgjithshme të mësuesit. Çdo standard prezanton një marrëveshje profesionale në lidhje me aftësitë dhe vlerat që duhet të ketë një mësues i kualifikuar gjuhe dhe letërsie.

Ato mund të përdoren si bazë për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve, por edhe si orientim për universitetet e mësuesisë që përgatisin mësues të gjuhës shqipe dhe të letërsisë.

Edhe pse të gjitha aspektet e mësimdhënies janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën, ato janë ndarë në disa standarde për ta bërë më të lehtë për mësuesit që të analizojnë profesionin dhe praktikën e tyre të mësimdhënies, si dhe të vlerësojnë pikat e tyre të forta dhe të dobëta.

## **Standardi 1: PËRZGJEDHJA E MATERIALEVE MËSIMORE**

### **1.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi njeh përfitimet dhe kufizimet e materialeve të ndryshme mësimore dhe i përzgjedh e i përdor ato në mënyrën e duhur.

### **1.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 1.2.1** ka njohuri për shumëllojshmërinë e materialeve mësimore që mund të përdoren gjatë mësimdhënies, përfshirë lloje të ndryshme tekstesh (letrare dhe joletrare), antologji, revista, reklama, tekste elektronike, fjalorë etj.;
- 1.2.2** krijon, organizon, pasuron dhe përdor bibliotekën e shkollës ose të klasës;
- 1.2.3** analizon dhe vlerëson cilësinë dhe përshtatshmërinë e materialeve të ndryshme mësimore në aspektin e lexueshmërisë, përmbajtjes, gjatësisë, formatit, ilustrimeve etj.;
- 1.2.4** përzgjedh tekste letrare dhe joletrare duke u bazuar te interesat, njohuritë, përvojat,

prejardhjen kulturore dhe nivelet e ndryshme të zhvillimit të nxënësve;

## **Standardi 2: RËNDËSIA E TË LEXUARIT**

### **2.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi kupton natyrën komplekse të të lexuarit, si dhe rëndësinë e tij në arritjet e nxënësve në shkollë dhe në jetë.

### **2.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 2.2.1** vlerëson rëndësinë e lexim-shkrimit, si një veprimtari që zhvillohet gjatë gjithë jetës dhe që mundëson përmbushjen personale dhe funksionimin si qytetar i suksesshëm në shoqëri;
- 2.2.2** kupton se të lexuarit është procesi i ndërtimit të kuptimit nëpërmjet ndërveprimit të njohurive të mëparshme të lexuesit me informacionin e sugjeruar nga teksti i shkruar dhe me situatën në të cilën ndodh procesi i të lexuarit;
- 2.2.3** motivon nxënësit dhe nxit interesin e tyre gjatë procesit të të lexuarit;
- 2.2.4** kupton që njohuritë gjuhësore nga fonetika, morfologjia, sintaksa, semantika etj., luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive të të lexuarit;
- 2.2.5** njeh marrëdhëniet mes të lexuarit, të shkruarit, të folurit dhe të dëgjuarit dhe siguron mundësi për t'i integruar ata gjatë mësimdhënies;
- 2.2.6** vlerëson rëndësinë e aftësive të lexim-shkrimit në arritjet e nxënësve në të gjitha lëndët dhe fushat e të nxënësve, si p.sh., matematika, shkencat e natyrës, shkencat shoqërore etj.;
- 2.2.7** kupton rëndësinë e të lexuarit dhe njeh përvojat në shkollë dhe në shtëpi që e mbështesin atë.

## **Standardi 3: RRJEDHSHMËRIA NË LEXIM**

### **3.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi planifikon, zhvillon dhe vlerëson veprimtari të ndryshme që përmirësojnë rrjedhshmërinë e nxënësve.

### **3.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

#### **Treguesit e njohurive**

Mësuesi:

- 3.2.1** vlerëson rolin e rrjedhshmërisë në lexim, si dhe njeh faktin që me rrjedhshmëri kuptohet saktësi, shpejtësi dhe shprehësi në lexim;
- 3.2.2** përdor poezi, këngë dhe tekste të ndryshme për të zhvilluar rrjedhshmërinë gjatë të lexuarit;
- 3.2.3** mbështet dhe nxit nxënësit në përmirësimin e rrjedhshmërisë;
- 3.2.4** përdor strategji të ndryshme për zhvillimin e rrjedhshmërisë duke përfshirë leximin e

- përbashkët, leximin me zë, leximet e përsëritura, leximin zinxhir, leximin me role etj.;
- 3.2.5** vlerëson rrjedhshmërinë e nxënësve gjatë të lexuarit;
- 3.2.6** përdor teknika të ndryshme për matjen e rrjedhshmërisë dhe ndërton plane për përmirësim, duke u bazuar në rezultatet e matjeve të saj.

## **Standardi 4: PASURIMI I FJALORIT TË NXËNËSVE**

### **4.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi planifikon dhe u jep nxënësve njohuri për kuptimet e fjalëve, si dhe i nxit dhe i motivon ata që të lexojnë për të pasuruar fjalorin.

### **4.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1** kupton rëndësinë e fjalorit (njohja e kuptimit të fjalëve) për të kuptuar tekstet që nxënësit lexojnë;
- 4.2.2** përdor tekste të ndryshme për të pasuruar fjalorin e nxënësve;
- 4.2.3** angazhon nxënësit në lojëra fjalësh, lexime me role ose dramatizime në mënyrë që ata të mësojnë fjalë të reja;
- 4.2.4** udhëzon nxënësit që të përdorin kontekstin për të zbuluar kuptimin e fjalëve;
- 4.2.5** aftëson nxënësit të dallojnë kuptimin e parë dhe kuptimin e figurshëm të fjalëve;
- 4.2.6** aftëson nxënësit për të kuptuar ndërtimin e fjalës (parashtesa, prapashtesa, tema, rrënja);
- 4.2.7** pajis nxënësit me njohuri dhe aftësi për sinonimet, antonimet, homonimet, si dhe për funksionet e tyre;
- 4.2.8** aftëson nxënësit që të dallojnë fushën leksikore dhe familjen e fjalëve;
- 4.2.9** aftëson nxënësit që të zbulojnë lidhjet ose marrëdhëniet mes fjalëve;
- 4.2.10** nxit nxënësit që të lexojnë për të pasuruar fjalorin e tyre;
- 4.2.11** përdor teknologjinë për të zhvilluar dhe për të pasuruar fjalorin e nxënësve;
- 4.2.12** nxit nxënësit të përdorin fjalorët për njohjen e shumëllojshmërisë së kuptimeve të fjalëve.

## **Standardi 5: TË KUPTUARIT E TEKSTEVE**

### **5.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi planifikon dhe zhvillon orë mësimore në të cilat mbështet, pasuron, zhvillon dhe vlerëson aftësitë e nxënësve për të kuptuar tekste të ndryshme.

### **5.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**



## **Treguesit e njohurive**

Mësuesi:

- 5.2.1 ka njohuri për aftësitë e të kuptuarit të një teksti;
- 5.2.2 njihet marrëdhënien mes të dëgjuarit dhe të lexuarit;
- 5.2.3 përdor lloje të ndryshme pyetjesh, të cilat ndikojnë te nxënësit për të kuptuar më mirë një tekst;
- 5.2.4 nxit nxënësit të ndërtojnë pyetje rreth të kuptuarit të një teksti;
- 5.2.5 nxit nxënësit që të lexojnë tekste letrare e joletrare dhe i mbështet ata që të lidhin njohuritë e tyre të mëparshme me tekstin që lexojnë;
- 5.2.6 udhëzon nxënësit që të përdorin strategjitë e të lexuarit;
- 5.2.7 nxit nxënësit që të diskutojnë, të bëjnë dramatizime, të realizojnë prezantime etj., rreth teksteve që lexojnë;
- 5.2.8 aftëson nxënësit që të përdorin elementet e ndryshme të tekstit (p.sh., tabela e përmbajtjes, ilustrimet) ose strukturën e tekstit për të përmirësuar të kuptuarit e tekstit;
- 5.2.9 aftëson nxënësit për të monitoruar të kuptuarit, si dhe për të shmangur keqkuptimet ose konfuzionin gjatë leximit;
- 5.2.10 aftëson nxënësit që të përmbledhin, të analizojnë në mënyrë kritike, të vlerësojnë dhe të sintetizojnë informacionin e një teksti letrar ose joletrar;
- 5.2.11 nxit nxënësit që të shkruajnë rreth teksteve që lexojnë me qëllim përmirësimin e të kuptuarit.

## **Standardi 6: MJEDISI I TË LEXUARIT**

### **6.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi krijon një mjedis pozitiv në klasë, i cili nxit dhe motivon leximin e pavarur.

### **6.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 6.2.1 zotëron njohuri rreth strategjive që nxitin leximin e pavarur;
- 6.2.2 përdor metoda, teknika të ndryshme mësimore për të organizuar punë të diferencuar me nxënësit;
- 6.2.3 dallon kur problemet e nxënësve në lexim kërkojnë trajtim të specializuar (p.sh., disleksia);
- 6.2.4 orienton nxënësit drejt burimeve alternative të të lexuarit jashtë procesit mësimor;
- 6.2.5 përdor kohë të mjaftueshme mësimore për të zhvilluar aftësitë e të lexuarit;
- 6.2.6 përdor metoda, teknika ose strategji të ndryshme mësimore për të rritur motivimin dhe interesin e nxënësve për të lexuar;
- 6.2.7 organizon dhe motivon nxënësit në punë në grupe;
- 6.2.8 nxit dhe motivon nxënësit që të bëhen lexues të pavarur;
- 6.2.9 u jep nxënësve detyra shtëpie të diferencuara, të cilat mbështesin zhvillimin e aftësive të të lexuarit;

- 6.2.10** krijon mjedis pozitiv leximi që nxjerr në pah nivelin dhe progresin e nxënësve;
- 6.2.11** angazhon prindërit në procesin e të nxënësve brenda dhe jashtë klasës;
- 6.2.12** përmbledh informacionin rreth arritjeve të nxënësve dhe ua komunikon prindërve.

## **Standardi 7: TEKSTET LETRARE DHE JOLETRARE**

### **7.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi zotëron njohuri rreth teksteve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe pajis nxënësit me njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime rreth këtyre teksteve.

### **7.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 7.2.1** përzgjedh literaturë që është në përshtatje me moshën dhe me zhvillimin e nxënësve, duke përfshirë tekste të shtypura, letërsi gojore dhe tekste elektronike;
- 7.2.2** siguron mundësi që nxënësit të lexojnë për qëllime të ndryshme;
- 7.2.3** aftëson nxënësit të dallojnë tiparet e teksteve letrare dhe joletrare, si dhe të përcaktojnë dallimet dhe ngjashmëritë mes tyre;
- 7.2.4** aftëson nxënësit të lexojnë në mënyrë shprehëse me qëllim që të interpretojnë dhe të vlerësojnë në mënyrën e duhur, tekste të ndryshme;
- 7.2.5** pajis nxënësit me aftësitë e duhura për të kuptuar, analizuar, vlerësuar dhe gjykuar tekste të ndryshme përshkruese, rrëfyese, argumentuese, informuese- paraqitëse dhe udhëzuese;
- 7.2.6** pajis nxënësit me njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime rreth teksteve të ndryshme të gjinisë lirike, epike dhe dramatike;
- 7.2.7** aftëson nxënësit të përcaktojnë dallimet dhe ngjashmëritë mes teksteve të gjinive të ndryshme letrare;
- 7.2.8** edukon te nxënësit vlerësimin dhe dashurinë për letërsinë shqipe dhe për letërsinë botërore;
- 7.2.9** aftëson nxënësit për të kuptuar, interpretuar, analizuar, vlerësuar dhe gjykuar tekste të periudhave dhe të drejttimeve të ndryshme letrare;
- 7.2.10** aftëson nxënësit për të lexuar, interpretuar, analizuar dhe vlerësuar vepra të shkrimtarëve, përfaqësues të letërsisë shqipe dhe të letërsisë botërore;
- 7.2.11** identifikon së bashku me nxënësit, temat universale që trajtohen në vepra letrare të periudhave, të drejttimeve dhe të gjinive të ndryshme letrare;
- 7.2.12** ofron mundësi që nxënësit të lexojnë tekste të periudhave, kulturave, gjinive dhe drejttimeve të ndryshme në mënyrë që të kuptojnë dimensione të shumta (p.sh., etike, filozofike dhe estetike) të përvojës njerëzore;
- 7.2.13** pranon se letërsia është një mjet për përhapjen dhe për transmetimin e vlerave morale, estetike dhe kulturore brenda një komuniteti;

- 7.2.14** aftëson nxënësit që të bëjnë konkluzione, të nxjerrin përfundime, të bëjnë krahasime nisur nga këndvështrimi personal dhe t'i ndajnë idetë dhe përshtypjet e tyre me shokët dhe shoqet e klasës;
- 7.2.15** aftëson nxënësit që të kuptojnë dhe të lidhin elemente të ndryshme të teksteve letrare dhe joletrare me ngjarjet aktuale dhe historike, si dhe me përvojat personale;
- 7.2.16** edukon te nxënësit dashurinë për librin dhe letërsinë.

## **Standardi 8: STRUKTURA E TEKSTEVE, GJUHA DHE STILI**

### **8.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi zotëron njohuri rreth strukturës së teksteve të ndryshme, rreth gjuhës dhe tipareve të stilit të një autori, si dhe i pajis nxënësit me njohuri dhe me aftësi për të dalluar dhe për të shpjeguar elementet e mësipërme.

### **8.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

#### **Treguesit e njohurive**

Mësuesi:

- 8.2.1** aftëson nxënësit për të dalluar, analizuar dhe vlerësuar karakteristikat e teksteve të ndryshme letrare, si p.sh.: tregime, novela, romane, fabula, mite, poezi, legjenda etj.;
- 8.2.2** aftëson nxënësit për të dalluar, analizuar dhe vlerësuar elementet e strukturës (hyrje, zhvillim, mbyllje) së një teksti letrar e joletrar;
- 8.2.3** aftëson nxënësit për të dalluar, analizuar dhe vlerësuar elementet komplekse të subjektit (p.sh., konfliktin dhe zgjidhjen);
- 8.2.4** aftëson nxënësit për të dalluar, analizuar dhe vlerësuar elementet letrare, si p.sh., personazhet, subjektin, temën, konfliktin, mjedisin, kohën, atmosferën etj., si dhe për të shpjeguar funksionin e tyre në një tekst letrar;
- 8.2.5** aftëson nxënësit për të dalluar, analizuar dhe vlerësuar mjetet e ndryshme që përdoren për të përshkruar personazhet në gjini dhe tekste të ndryshme letrare (p.sh., tipare të karakterit, zhvillimi, marrëdhëniet me personazhet e tjera etj.);
- 8.2.6** aftëson nxënësit të përcaktojnë këndvështrimin në një tekst letrar dhe vetën e rrëfimit (p.sh., rrëfim në vetën e parë dhe në vetën e tretë) dhe shpjegon efektin që krijojnë te lexuesi;
- 8.2.7** aftëson nxënësit për të dalluar dhe për të shpjeguar strukturat gjuhësore, fjalët, formën etj., që një autor përdor për të përcjellë idetë e tij dhe për të përfshirë emocionalisht lexuesin;
- 8.2.8** aftëson nxënësit të vlerësojnë gjuhën dhe stilin e autorëve ose të shkrimtarëve;
- 8.2.9** mundëson që nxënësit të dallojnë mjetet dhe figurat stilistike (p.sh., gjuha e figurshme, alegoria, metafora, dialogu, përshkrimi, rrëfimi, zgjedhja e fjalëve, simbolika etj.) në tekste të ndryshme, si dhe të përcaktojnë funksionin e tyre.

## Standardi 9: VLERËSIMI I TË LEXUARIT

### 9.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi krijon dhe përzgjedh mjete të vlefshme vlerësimi për aftësitë e të lexuarit. Mësuesi përdor rezultatet e vlerësimit të nxënësve me qëllim që të ndërtojë punën e tij për të përmirësuar arritjet e tyre. Ai nxit nxënësit që të vetëvlerësojnë arritjet e tyre. Mësuesi, gjithashtu, komunikon me prindërit rreth procesit të vlerësimit të nxënësve.

### 9.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 9.2.1 kupton rëndësinë e përdorimit të vlerësimeve të standardizuara dhe joformale të leximit, duke përfshirë edhe vëzhgimet e vazhdueshme;
- 9.2.2 përcakton nivelin e njohurive dhe të aftësive të nxënësve në lexim;
- 9.2.3 interpreton dhe analizon rezultatet e vlerësimeve të standardizuara për të lexuarit (testeve), përfshirë edhe testimet në nivel kombëtar;
- 9.2.4 nxit dhe mbështet nxënësit për të vetëvlerësuar aftësitë e të lexuarit.

## Standardi 10: TË SHKRUARIT PËR QËLLIME TË NDRYSHME

### 10.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i pajis nxënësit me njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet e nevojshme për të shkruar tekste të ndryshme, në përshtatje me qëllimet dhe audiencat e tyre.

### 10.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 10.2.1 ka njohuri rreth faktit që të shkruarit varet nga audiencia, qëllimi, lloji i tekstit të shkruar etj.;
- 10.2.2 krijon mundësi që nxënësit të shkruajnë për qëllime dhe audiencia të ndryshme;
- 10.2.3 njeh dhe zbaton strategji të ndryshme, të cilat i ndihmojnë nxënësit për t'i rishikuar tekstet në lidhje me përshtatshmërinë me qëllimin, audiencën, situatën, formën etj.;
- 10.2.4 aftëson nxënësit në përdorimin e teknologjisë për të prodhuar tekste të ndryshme për qëllime dhe situata të ndryshme.

## Standardi 11: FAZAT E TË SHKRUARIT

### 11.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi ka njohuri dhe i aftëson nxënësit në përdorimin e strategjive të nevojshme gjatë fazës përgatitore (parashkrimi), në mënyrë që ata të shkruajnë qartë dhe saktë për qëllime të ndryshme. Ai demonstroi njohuri dhe aftëson nxënësit që të rishikojnë dhe të redaktojnë punët e tyre me shkrim, aftëson nxënësit që të përgatitin një punë me shkrim për prezantim, publikim ose botim.

## **11.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 11.2.1** vlerëson parashkrimin dhe draftimin, si komponentë të rëndësishëm në procesin e të shkruarit;
- 11.2.2** udhëzon dhe orienton nxënësit që të kërkojnë, të mbledhin dhe të përzgjedhin informacionin e nevojshëm për punët me shkrim;
- 11.2.3** nxit nxënësit të hulumtojnë rreth të shkruarit të teksteve të llojeve të ndryshme;
- 11.2.4** ofron tekste të ndryshme si model që ndihmojnë dhe i nxit nxënësit për një shkrim cilësor;
- 11.2.5** aftëson nxënësit për të përdorur strategji të ndryshme si një mjet për të gjeneruar dhe për të organizuar ide, në kuadër të procesit të të shkruarit (planifikimi, listimi, draftimi etj.);
- 11.2.6** u mëson nxënësve elementet dhe veçoritë e teksteve të ndryshme (p.sh.:tregime të shkurtra, ese, letra, raporte etj.);
- 11.2.7** ndihmon nxënësit të nxjerrin vetë rregullat e të shkruarit të një teksti dhe karakteristikat e tij;
- 11.2.8** udhëzon dhe orienton nxënësit që t'i përmbahen gjatë të shkruarit, temës dhe karakteristikave të tekstit;
- 11.2.9** aftëson nxënësit që të shkruajnë tekste me disa paragrafë, në cilat përcjellin ndjenja, informacione ose ide, me një stil të qartë dhe konciz;
- 11.2.10** aftëson nxënësit që të përzgjedhin fjalët dhe leksikun e duhur në varësi të llojit të punës me shkrim;
- 11.2.11** aftëson nxënësit që të përdorin gjuhën standarde shqipe.
- 11.2.12** vlerëson rishikimin dhe redaktimin si komponentë të rëndësishëm në procesin e të shkruarit;
- 11.2.13** shpjegon dhe sqaron nxënësit për vlerën e rishikimit dhe të redaktimit si komponentë të rëndësishëm të procesit të të shkruarit;
- 11.2.14** aftëson nxënësit që të rishikojnë dhe të redaktojnë punët e tyre në lidhje me qartësinë, saktësinë, stilin, organizimin, koherencën etj.;
- 11.2.15** udhëzon nxënësit si të redaktojnë punët e tyre dhe punët e njëri-tjetrit;
- 11.2.16** u mëson nxënësve teknikat e redaktimit që realizohen nëpërmjet teknologjisë;
- 11.2.17** kupton rëndësinë dhe vlerën e prezantimit, publikimit ose botimit të punëve me shkrim, si një pjesë integrale e procesit të të shkruarit;
- 11.2.18** aftëson nxënësit në përdorimin e formateve të ndryshme që shërbejnë për të prezantuar, publikuar ose botuar punë të ndryshme me shkrim;
- 11.2.19** vlerëson rolin e teknologjisë në prezantimin, publikimin ose botimin e punëve me shkrim;
- 11.2.20** sqaron nxënësit rreth rëndësisë dhe vlerës së prezantimit, publikimit ose botimit të punëve me shkrim;
- 11.2.21** u siguron mundësi nxënësve për të prezantuar, publikuar ose botuar punë të ndryshme me shkrim;

- 11.2.22 vlerëson dhe udhëzon nxënësit gjatë gjithë procesit të shkruarit;
- 11.2.23 përdor skema të qarta vlerësimi të punëve me shkrim;
- 11.2.24 udhëzon dhe orienton nxënësit që të vlerësojnë punët me shkrim të njëri-tjetrit.

## Standardi 12: RËNDËSIA E KOMUNIKIMIT

### 12.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi njeh elementet e procesit të komunikimit dhe kupton rëndësinë e komunikimit efektiv në klasë.

### 12.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 12.2.1 vlerëson rëndësinë e procesit të komunikimit;
- 12.2.2 aftëson nxënësit me elementet që përbëjnë procesin e komunikimit (dhënësi, marrësi, mesazhi, kodi etj.);
- 12.2.3 aftëson nxënësit të përcaktojnë dallimet dhe të përbashkëtat mes gjuhës së folur, gjuhës së shkruar dhe komunikimit elektronik;
- 12.2.4 aftëson nxënësit të përcaktojnë elementet e veçanta dhe të përbashkëta mes komunikimit verbal dhe komunikimit joverbal;
- 12.2.5 edukon te nxënësit përgjegjësitë e folësit (dhënësit) dhe të dëgjuesit (marrësit) në një proces komunikimi;
- 12.2.6 aftëson nxënësit që të përdorin cilësitë e zërit (volumi, toni, theksi, shpejtësia e të folurit etj.) dhe elementet joverbale që duhen përdorur gjatë komunikimit;
- 12.2.7 aftëson nxënësit që të njohin audiencën e tyre dhe në varësi të saj dhe të qëllimit, të përshtatin mesazhin gjatë komunikimit;
- 12.2.8 u shpjegon nxënësve rolin dhe rëndësinë e përqendrimit dhe të vëmendjes gjatë dhënies së mesazheve;
- 12.2.9 aftëson nxënësit që të reagojnë brenda rregullave të etikës ndaj mesazhit të folësit.

## Standardi 13: ZHVILLIMI I TË FOLURIT

### 13.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i aftëson nxënësit që të përshtatin të folurit me qëllimin, me situatën ose me mjedisin, si dhe të japin dhe të vlerësojnë mesazhe të ndryshme.

### 13.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 13.2.1 vlerëson rëndësinë e përshtatjes së të folurit me qëllimin, situatën, mjedisin dhe kohën;
- 13.2.2 vlerëson ndikimin e kontekstit mbi komunikimin;
- 13.2.3 aftëson nxënësit të dallojnë kur të tjerët nuk i kuptojnë, si dhe të vlerësojnë rolin e



- kritikës konstruktive dhe të mendimit ndryshe;
- 13.2.4** aftëson nxënësit që të zbatojnë rregullat gjatë komunikimit në grupe të vogla dhe të mëdha;
- 13.2.5** u krijon mundësi nxënësve që diskutojnë në grup për zgjidhjen e problemeve;
- 13.2.6** pajis nxënësit me njohuri dhe me aftësi për llojet e teksteve të ndryshme gojore, për përdorimin e tyre, si dhe për ndikimin dhe funksionet e tyre;
- 13.2.7** aftëson nxënësit që të organizojnë, në mënyrën e duhur, mesazhet me qëllim që të mbështesin qartë një tezë të caktuar;
- 13.2.8** aftëson nxënësit në përdorimin e teknikave dhe mjeteve joverbale gjatë komunikimit në grup dhe në publik;
- 13.2.9** ndërjegjëson nxënësit për rëndësinë e komunikimit dhe të fjalës në shkollë, në punë dhe në jetë;
- 13.2.10** aftëson nxënësit në përdorimin e TIK-ut, për prezantime të ndryshme individuale dhe në grup.

#### **Standardi 14: MENAXHIMI I EMOCIONEVE GJATË KOMUNIKIMIT**

##### **14.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi udhëzon dhe ndihmon nxënësit që të menaxhojnë ose të kontrollojnë ankthin ose emocionet e tyre gjatë komunikimit.

##### **14.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 14.2.1** zotëron njohuri rreth strategjive, të cilat ndihmojnë në shmangien e ankthit dhe të emocioneve gjatë komunikimit;
- 14.2.2** aftëson nxënësit në përdorimin e strategjive që lehtësojnë ankthin gjatë komunikimit;
- 14.2.3** zotëron njohuri për faktorët individualë dhe shoqërorë që ndikojnë në ankthin dhe emocionet gjatë komunikimit;
- 14.2.4** udhëzon nxënësit që të shfaqin siguri dhe qetësi gjatë të folurit;
- 14.2.5** u krijon mundësi nxënësve që të menaxhojnë dhe të kapërcejnë ankthin dhe emocionet e tyre gjatë të folurit.

#### **Standardi 15: ZHVILLIMI I TË DËGJUARIT**

### **15.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi aftëson nxënësit që të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura për të dëgjuarit. Mësuesi udhëzon nxënësit se si të shmangin pengesat gjatë të dëgjuarit.

### **15.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 15.2.1** zotëron njohuri për llojet dhe qëllimet e të dëgjuarit, për rolin dhe përgjegjësinë e dëgjuesit në një situatë komunikimi;
- 15.2.2** njeh pengesat gjatë të dëgjuarit si: paragjykimi, indiferenca, përfshirja emocionale etj.;
- 15.2.3** aftëson nxënësit që të përcaktojnë qëllimin e dëgjimit;
- 15.2.4** ushtron nxënësit që të analizojnë dhe të vlerësojnë sjelljet e tyre gjatë të dëgjuarit;
- 15.2.5** aftëson nxënësit që të kuptojnë, analizojnë dhe vlerësojnë tekstin që dëgjojnë;
- 15.2.6** pajis nxënësit me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kuptuar dhe për të analizuar mjetet që përdor folësi për ta bërë interesant mesazhin e tij;
- 15.2.7** pajis nxënësit me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përcaktuar faktet dhe opinionet e folësit, si dhe besueshmërinë dhe vërtetësinë e mesazhit;
- 15.2.8** aftëson nxënësit që të vëzhgojnë me vëmendje, gjatë të dëgjuarit, jo vetëm fjalët, por edhe gjestet, tonin, mimikën e fytyrës, gjuhën e trupit të folësit;
- 15.2.9** ushtron nxënësit që të pyesin, të përmbledhin dhe të parafrzojnë me qëllim që të arrijnë të kuptojnë një tekst;
- 15.2.10** edukon te nxënësit respektin për të drejtat e tjetrit që ka pikëpamje të kundërta me ta;
- 15.2.11** edukon nxënësit të jenë të vëmendshëm dhe empatikë, si dhe të tregojnë respekt dhe vlerësim për folësin.

## **Standard 16. SISTEMI GJUHËSOR**

### **16.1. Përshkrimi i standardit**

Mësuesi zhvillon te nxënësit aftësitë për të njohur e për të zbatuar rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit, si dhe për të vlerësuar aspektet funksionale e estetike të gjuhës. Mësuesi u krijon mundësitë e nxënësve për ta përdorur gjuhën në mënyrë efektive.

### **16.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 16.2.1** kërkon nga nxënësit zbatimin e rregullave gramatikore dhe ndërtimin e përshtatshëm të fjalive, gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim;
- 16.2.2** aftëson nxënësit të dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës (klasat e fjalëve), kategoritë e tyre gramatikore dhe t'i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit;
- 16.2.3** aftëson nxënësit të dallojnë dhe të përdorin saktë llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali;
- 16.2.4** kërkon nga nxënësit që të përdorin në mënyrë korrekte gjuhën standarde gjatë

- komunikimit me gojë dhe me shkrim;
- 16.2.5** aftëson nxënësit të njohin dialektet dhe pjesët e tjera të leksikut;
- 16.2.6** pajis nxënësit me njohuri dhe aftësi për dallimet fonetike, morfologjike e leksikore mes dialekteve të gjuhës shqipe;
- 16.2.7** kultivon te nxënësit vlerësimin për pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- 16.2.8** përcjell te nxënësit njohuri për mënyrat e formimin të fjalëve në gjuhën shqipe, si dhe i aftëson ata që të dallojnë kuptimet e fjalëve dhe t'i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre;
- 16.2.9** pajis nxënësit me njohuri dhe aftësi për tingujt e shqipes dhe për klasifikimin e tyre, si dhe për theksin e fjalës dhe të fjalisë;
- 16.2.10** ndërton dhe zhvillon te nxënësit njohuri aftësi dhe qëndrime rreth rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- 16.2.11** aftëson nxënësit të vënë në zbatim njohuritë fonetike, morfologjike, sintaksore, drejtshkrimore, drejtshqiptimore, fjalëformuese e leksikore;
- 16.2.12** pajis nxënësit me njohuri për historinë e gjuhës shqipe;
- 16.2.13** nxit nxënësit të hulumtojnë rreth historisë së gjuhës shqipe;
- 16.2.14** edukon te nxënësit dashurinë dhe vlerësimin për gjuhën shqipe;
- 16.2.15** ndërëgjegjëson nxënësit që të respektojnë diversitetin gjuhësor.

### **3.1.3 Standardet profesionale të mësuesit të gjuhëve të huaja**

#### **Përshkrim përmbledhës**

Mësuesi i gjuhës së huaj ka përgjegjësi të rëndësishme në përgatitjen e nxënësve për t'i drejtuar ata me sukses në jetën produktive. Mësuesi i efektshëm mund të jetë një burim frymëzimi po aq i rëndësishëm që të sigurojë një ndikim të besueshëm dhe të qëndrueshëm tek nxënësit në mënyrë që ata të bëjnë zgjedhje për arsimim, punë dhe jetë. Mësimdhënia është një profesion dinamik dhe i dobishëm. Mësuesi i mirë i pajis nxënësit me përvoja mësimore të pasura, interesante dhe të strukturuar mirë. Kapaciteti për të siguruar këto përvoja kërkon një bazë njohurish, aftësish dhe kapacitetesh të ndërtuara në vitet e para të mësimdhënies.

Standardet profesionale për mësuesin e gjuhëve të huaja përshkruajnë njohuritë, aftësitë dhe të kuptuarit që duhet të ketë mësuesi kompetent dhe efektiv. Përmbushja e këtyre standardeve siguron integritetin dhe përgjegjësinë e mësuesit të gjuhëve të huaja në profesionin që ka zgjedhur. Standardet janë të ndërlidhura, të ndërvarura midis tyre.

#### **Standardi 1: KRIJIMI I AMBJENTIT INKURAJUES PËR MËSIMIN E GJUHËS SË HUAJ**

### **1.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i gjuhës së huaj kupton proceset e përfshira në marrjen e një gjuhe tjetër. Ai/ajo inkurajon nxënësit të marrin pjesë në aktivitetet e organizuara për një përvetësim sa më të mirë të gjuhës së huaj që po mësojnë.

### **1.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 1.2.1.** inkurajon nxënësit të kuptojnë proceset e përfshira në zhvillimin e aftësisë së të dëgjuarit në gjuhën e huaj;
- 1.2.2.** inkurajon nxënësit të kuptojnë proceset e përfshira në zhvillimin e aftësisë së të folurit në gjuhën e huaj;
- 1.2.3.** motivon nxënësit të kuptojnë proceset e përfshira në zhvillimin e aftësisë së të kuptuarit dhe leximit në gjuhën e huaj;
- 1.2.4.** motivon nxënësit të kuptojnë proceset e përfshira në zhvillimin e aftësisë së shkrimit në gjuhën e huaj;
- 1.2.5.** zbaton njohuri për përvetësimin e gjuhës së huaj duke projektuar një veprimtari të thjeshtë për të nxitur aftësinë e të dëgjuarit;
- 1.2.6.** zbaton njohuri për përvetësimin e gjuhës së huaj duke projektuar veprimtari për zhvillimin e aftësive folëse;
- 1.2.7.** zbaton njohuri për përvetësimin e gjuhës së huaj duke projektuar veprimtari të përshtatshme lidhur me të kuptuarit e një pjese leximi të zgjedhur;
- 1.2.8.** zbaton njohuri për përvetësimin e gjuhës së huaj duke projektuar një aktivitet të thjeshtë.

## **Standardi 2: KOMUNIKIMI NË GJUHË TË HUAJ**

### **2.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi kompetent i gjuhës së huaj e kupton rëndësinë e komunikimit gojor dhe bashkëvepron në mënyrën e duhur në gjuhën e caktuar në mjedise të ndryshme. Ai/ajo krijon ambient motivues për nxënësit për të zhvilluar biseda, prezantime dhe diskutime në gjuhë të huaj.

### **2.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 2.2.1.** aftëson nxënësit të kuptojnë idenë kryesore dhe detajet e prezantimeve me gojë dhe audio pa u mbështetur nga aparati vizual;
- 2.2.2.** inkurajon nxënësit të marrin pjesë në biseda mbi tema të njohura që lidhen me veprimtaritë e përditshme dhe mjedisit personal me një shkallë të lartë të saktësisë gramatikore;
- 2.2.3.** inician, zhvillojnë dhe përfundojnë një bisedë rreth një situatë të caktuar;

- 2.2.4. bën prezantime në situata akademike, sociale ose të punës;
- 2.2.5. përcjell tek nxënësit informacionin e duhur me një gjuhë të saktë dhe të kuptueshme për ta;
- 2.2.6. menaxhon diskutimet dhe debatet e nxënësve mbi temat që diskutohen;
- 2.2.7. përzgjedh sipas moshës, interesave dhe njohurive të nxënësve temën për të diskutuar;
- 2.2.8. vlerëson rëndësinë e komunikimit në gjuhë të huaj duke përfshirë të gjithë nxënësit në diskutime në çift ose grup.

### **Standardi 3: PËRGATITJA DHE PËRSHTATJA E MATERIALEVE PLOTËSUESE**

#### **3.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi kompetent i gjuhës së huaj kupton dhe krijon materiale të shkruara në gjuhën e caktuar për qëllime dhe audienca të ndryshme. Ai/ajo përzgjedh materiale autentike nga gazeta dhe revista duke i përshtatur dhe thjeshtuar në bazë të moshës dhe nivelit gjuhësor të nxënësve.

#### **3.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1 kupton mesazhin kryesor, detajet mbështetëse dhe kontekstin kulturor të materialeve komplekse;
- 3.2.2 përzgjedh informacione të printuara të marra nga burime të ndryshme, duke përfshirë mediet elektronike;
- 3.2.3 krijon materiale të shkruara që përfshijnë përshkrim, përkufizim dhe analiza;
- 3.2.4 përfshin nxënësit në përzgjedhjen dhe përgatitjen e materialeve të ndryshme;
- 3.2.5 modelon materialet e përzgjedhura duke u bazuar në temën që zhvillohet mësimi;
- 3.2.6 përdor materiale autentike për të krijuar situata gjuhësore sa më afër gjuhës reale.

### **Standardi 4: PERDORIMI I SAKTË I STRUKTURAVE GJUHËSORE**

#### **4.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi kompetent i gjuhës së huaj është në gjendje të përdorë gjuhën e synuar për të shpjeguar strukturën e saj në mënyrë të kuptueshme për nxënësit. Ai/Ajo shpjegon dhe përdor saktë stukturat gramatikore të gjuhës duke inkurajuar nxënësit të përdorin gjuhën standarde kur flasin dhe shkruajnë.

#### **4.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1 zotëron plotësisht gramatikën dhe sintaksën e gjuhës së huaj;
- 4.2.2 inkurajon nxënësit të përdorin rregullat gjuhësore kur shkruajnë dhe flasin;

- 4.2.3 aftëson nxënësit të organizojnë pjesët e ligjëratës në fjali të sakta për sa i përket gramatikës dhe sintaksës;
- 4.2.4 mundëson nxënësit të analizojnë strukturat gjuhësore të gjuhës së huaj;
- 4.2.5 krijon mundësi që nxënësit të bëjnë dallimin midis gjuhës amtare dhe asaj të huaj;
- 4.2.6 lehtëson procesin e marrjes së strukturave gramatikore të vështira në gjuhën e huaj;
- 4.2.7 krahason dhe bën dallimet midis gjuhës së huaj standarde dhe jostandarde;
- 4.2.8 motivon nxënësit të korrigjojnë veten dhe shokët për sa i përket saktësisë gjuhësore kur flasin dhe shkruajnë.
- 4.2.9 argumenton përdorimin e strukturave gjuhësore në situata të ndryshme.

## **Standardi 5: KULTURA NËPËRMJET GJUHËS SË HUAJ**

### **5.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi kompetent i gjuhës së huaj kupton sjelljet, zakonet dhe shprehjet kulturore të shoqërive të ndryshme ku flitet gjuha e huaj. Ai/ajo ju jep mundësinë nxënësve që nëpërmjet gjuhës të mësojnë për kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme.

### **5.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 5.2.1. shpjegon praktikat kulturore të një ose më shumë zonave ku flitet gjuha e huaj;
- 5.2.2. identifikon nga pikëpamja kulturore sjelljet e duhura sociale (p.sh. ritualet e urimit, gjestet etj. në një shumëllojshmëri kontekstesh;
- 5.2.3. krahason praktikat kulturore dhe rolet sociale (p.sh., këmbimet, ceremonitë, marrëdhëniet ndërpersonale etj.) në mesin e vendeve të ndryshme ku flitet gjuha e synuar.
- 5.2.4. interpreton traditat dhe kulturat e vendeve ku flitet gjuha e huaj dhe i krahason ato me traditat dhe kulturën e vendit tonë;
- 5.2.5. zotëron njohuri të gjera për sa i përket kulturës së vendit ku flitet gjuha e huaj;
- 5.2.6. përzgjedh tradita të vendeve të ndryshme dhe ndihmon nxënësit të gjejnë ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre.

## **Standardi 6: PËRDORIMI I FJALORIT TË PASUR**

### **6.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi kompetent i gjuhës së huaj demonstroi njohuri të përgjithshme të formave shprehëse që lidhen me shoqëritë e ndryshme ku flitet gjuha e huaj dhe zotëron fjalor të gjerë dhe të shumëllojshëm për të shprehur qartë dhe saktë informacionin e duhur. Mësuesi mundëson nxënësit që të përdorin fjalorin e duhur në situata të ndryshme.

### **6.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**



Mësuesi:

- 6.2.1. zotëron në mënyrë thelbësore fjalorin e gjuhës objektive që u referohet mjeteve, proceseve dhe produkteve (p.sh. materialet e artit, pikturë, portret etj.) në një ose më shumë nga format e artit, shkencës etj;
- 6.2.2. përzgjedh grupe të ndryshme sinonimike për të mësuar në orë të ndryshme mësimi të cilat lidhen me temën dhe moshën e nxënësve;
- 6.2.3. harton ushtrime të larmishme me fjalorin (harta semantike, tabela T etj) ku nxënësit punojnë individualisht, në çift ose në grup;
- 6.2.4. kërkon në mënyrë sistematike nga nxënësit të përdorin fjalorin e ri në situata personale;
- 6.2.5. organizon lojëra dhe konkurse që ndihmojnë nxënësit të zgjerojnë fjalorin e tyre.

## **Standardi 7: PËRDORIMI I MEDIAS NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS SË HUAJ**

### **7.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi kompetent i gjuhës së huaj kupton llojet e ndryshme të letërsisë dhe mediet e ndryshme të shoqërive ku flitet gjuha e huaj e synuar. Ai/ajo e përdor informacionin e marrë nga mediet e ndryshme për të ndihmuar nxënësit të zotërojnë gjuhën e huaj.

### **7.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 7.2.1. përzgjedh tematikat letrare dhe perspektivat e autorëve dhe zhanreve në përputhje me moshën, interesat dhe nivelin e nxënësve;
- 7.2.2. argumenton implikimet e nxjerra nga mediet e ndryshme në gjuhën e synuar;
- 7.2.3. krahason dhe analizon temat letrare dhe perspektivat e autorëve dhe zhanreve të ndryshme;
- 7.2.4. shpjegon ndikimin e kontekstit historik mbi formën dhe pikëpamjet e ndryshme të veprave letrare;
- 7.2.5. krahason dhe analizon tema ashtu siç janë paraqitur në mediet e ndryshme (p.sh., televizion, radio, CD-ROM, filma, faqe interneti, revista etj.);
- 7.2.6. gjykon informacionin e nxjerrë nga mediet e ndryshme;
- 7.2.7. interpreton tekstet letrare dhe informacionin e marrë nga mediet e ndryshme në funksion të orës së mësimi.

## **Standardi 8: NJOHJA E HISTORISË SË VENDIT KU FLITET GJUHA E HUAJ**

### **8.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi kompetent i gjuhës së huaj ka njohuri të mjaftueshme për historinë, gjeografinë, personalitetet, institucionet sociale, ngjarjet bashkëkohore të vendeve ku flitet gjuha e huaj. Ai/ajo i prezanton këto njohuri tek nxënësit duke marrë parasysh moshën, interesat dhe nivelin gjuhësor të tyre.

### **8.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 8.2.1.** zotëron njohuri të mbi figurat kryesore (p.sh. shkencëtarët, matematicienët, shpikësit, udhëheqësit) dhe ngjarjet, si në të kaluarën edhe sot dhe ndërton ushtrime për tema të caktuara;
- 8.2.2.** harton pyetje dhe ushtrime ( veçanërisht gjatë braintorming) mbi aspektet gjeografike (p.sh., burimet natyrore, moti / klima, shpërndarja e popullsisë dhe aktivitetet kryesore ekonomike) kur tekstet flasin për vende të ndryshme;
- 8.2.3.** shpjegon thjeshtë dhe qartë strukturat sociale, rolet dhe qëndrimet (p.sh., klasa, gjinia, popullsia, familja, puna, koha e lirë) të paktën në dy prej vendeve ku flitet gjuha e huaj;
- 8.2.4.** kupton sistemet politike dhe institucionale (p.sh., qeveria, arsimi, ligji dhe drejtësia), minimalisht të dy prej vendeve ku flitet gjuha e huaj;
- 8.2.5.** përdor harta, tabela, grafikë, imazhe elektronike etj. gjeografike për të përshkruar dhe diskutuar për vendet ku flitet gjuha e huaj e synuar;
- 8.2.6.** identifikon dhe përshkruan institucionet e rëndësishme sociale, rolet dhe perspektivat e tyre në vendet ku flitet gjuha e huaj;
- 8.2.7.** krahason dhe bën dallimin e rolit dhe ndikimin e figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme në zhvillimin e vendeve ku flitet gjuha e huaj ;
- 8.2.8.** analizon perspektiva të ndryshme të ngjarjeve historike dhe bashkëkohore të vendeve ku flitet gjuha e huaj, duke përdorur një shumëllojshmëri të medieve dhe teknologjisë.

## **Standardi 9: TË SHKRUARIT SI PROCES**

### **9.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi kompetent i gjuhës së huaj synon përdorin e saktë të gjuhës së huaj gjatë procesit të të shkruarit duke ndihmuar dhe motivuar nxënësit të shkruajnë lloje të ndryshme tekstesh. Ai/ajo zotëron mënyra dhe strategji të mësimdhënies për të gjitha fazat e të shkruarit.

### **9.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 9.2.1.** përzgjedh tema të larmishme për të shkruar me qëllim që ky proces të jetë i thjeshtë dhe

tërheqës për nxënësit;

- 9.2.2. harton skema të gatshme të cilat ndihmojnë nxënësin të shkruajnë me lehtësi një letër, tregim ose ese;
- 9.2.3. identifikon gabimet më të zakonshme që bëjnë nxënësit gjatë të shkruarit dhe mundëson korrigjimin e tyre në çift ose në grupe pune;
- 9.2.4. përdor me kujdes të gjitha fazat që përmban procesi i të shkruarit;
- 9.2.5. vlerëson përpjekjet e nxënësve gjatë procesit të të shkruarit dhe ndihmon ata në argumentimin e problemeve ;
- 9.2.6. kërkon nga nxënësit të ndjekin strukturat e të shkruarit dhe ju ofron atyre modele të ndryshme letrash,tregimesh, esesh.

## Standardi 10: PUNA ME PORTOFOLIN NË GJUHË TË HUAJ

### 10.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesi kompetent i gjuhës së huaj organizon punën në mënyrë efektive dhe racionale që nxënësit të punojnë në mënyrë krijuese me portofolin. Ai/ajo harton me kujdes planin e punës me portofolin dhe kërkon nga nxënësit plotësimin dhe pasurimin e tij.

### 10.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 10.2.1. prezanton dhe u shpjegon nxënësve portofolin e gjuhëve si edhe planin se si do të punohet dhe vlerësohet puna me atë;
- 10.2.2. kërkon që nxënësit të jenë objektivë në vetëvlerësimin e tyre si edhe krijues në punën me portofolin;
- 10.2.3. vlerëson përparimin e nxënësve si edhe i inkurajon ata të punojnë sistematikisht me materialet për portofolin;
- 10.2.4. eksploron strategji të ndryshme pune me portofolin dhe jua prezanton ato nxënësve;
- 10.2.5. organizon grupet e punës për prezantime projektesh të bazuara në punët e portofolit dhe tematikat e zhvilluara në mësim.

## 3.2 Standardet profesionale të mësuesit të matematikës

### Përshkrim përmbledhës

Matematika, si lëndë shkollore, është me natyrë të dyfishtë. Nga njëra anë, nëpërmjet numërimit, matjes, modelimeve dhe koncepteve gjeometrike, ajo zbulon botën rreth nesh

dhe siguron gjuhën dhe teknikat bazë për menaxhimin e shumë aspekteve, përfshirë dhe ato të jetës së përditshme. Nga ana tjetër, me forcën e abstragimit, argumentit logjik dhe bukurisë së vërtetimit, ajo paraqitet si një disiplinë intelektuale dhe si një burim kënaqësie estetike. Përpos kësaj, aktualisht, mësimi i matematikës, paraqet edhe sfida, një pjesë e të cilave kanë të bëjnë me mësuesit e matematikës, formimin dhe zhvillimin e tyre profesional. Krahas zhvillimit profesional të formimit të përgjithshëm, mësuesi duhet të orientohet drejt një sfondi më të fortë në matematikën akademike, si dhe drejt didaktikës së matematikës.

Standardet e mësuesit të matematikës përmbajnë njohuri, aftësi, shprehje e qëndrime që ky mësues duhet të demonstrojë në disa drejtime kryesore: në atë të **kompetencave matematikore**; në **kurrikulën përmbajtësore të matematikës**, si dhe në **aftësitë praktike**.

- **Standardi për kompetencat matematikore** bazohet në konceptimin e matematikës si një e tërë. Konceptet, procedurat dhe proceset intelektuale duhet të jenë në raportin “e tëra është shumë më mirë se shumica e pjesëve”. Ky trajtim organizohet nga ndërthurja e gjashtë kompetencave matematikore që lidhen me: **zgjdhjen problemore, arsyetimin dhe vërtetimin, komunikim matematikor, lidhjen konceptuale, modelimin dhe përdorimin e teknologjisë**.
- **Standardet për kurrikulën përmbajtësore** të lëndës së matematikës fokusohen në demonstrimin nga mësuesi, të besimit në vetvete për njohuritë e tij matematikore që transmeton dhe për mënyrën se si i transmeton ato. Njohja e matematikës përfshin konceptet specifike të të gjitha tematikave: **numri, matja, gjeometria, algjebra dhe funksioni, si dhe statistika dhe probabiliteti**, të lidhura me procedurat përkatëse për t’ua transmetuar nxënësve.
- Arritja e standardeve kërkon të gjithë **inputin e aftësive dhe qëndrimeve**. Këto standarde udhëheqin natyrën e mësuesit dhe temperamentin përkatës për të qenë një mësues matematike, një instruktor i mirë, një lehtësues i të nxënësve, një planifikues kurrikule, një anëtar i një komuniteti profesionistësh në matematikë dhe një komunikues me nxënësit dhe familjet e tyre.

## **Standard 1: KONCEPTIMI I MATEMATIKËS NËPËRMJET KOMPETENCAVE MATEMATIKORE**

### **1.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i matematikës zotëron dhe demonstroi aftësi në përdorimin e procedurave të zgjidhjes problemore duke arsyetuar me argumente matematikore, duke vlerësuar rigorozitetin dhe kërkimin matematikor. Ai komunikon idetë matematikore në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme, me shkrim dhe me gojë, duke përdorur dhe duke krijuar varësi midis koncepteve matematikore në kontekste brenda e jashtë matematikës. Mësuesi i matematikës përdor prezantime të ndryshme të njohurive matematikore për të mbështetur dhe për të thelluar të kuptuarin matematikor të nxënësve dhe përdor teknologjinë si një mjet thelbësor për mësimdhënien dhe nxënien në matematikë.

### **1.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 1.2.1. identifikon dhe parashtron probleme matematikore në mënyra të ndryshme;
- 1.2.2. zgjidh problema që përfshijnë matematikën në kontekste dhe praktika nga jeta reale;
- 1.2.3. ndërton njohuri të reja matematikore nëpërmjet zgjidhjes problemore;
- 1.2.4. modelon matematikisht situata reale dhe gjykon vlefshmërinë e modelit;
- 1.2.5. monitoron dhe gjykon proceset e zgjidhjes problemore në matematikë;
- 1.2.6. arsyeton dhe operon qartë me argumente matematikore;
- 1.2.7. konsideron arsyetimet dhe argumentimet, si një aspekt themelor i mësimit të matematikës;
- 1.2.8. krijon dhe investigon supozimet matematikore;
- 1.2.9. zhvillon dhe vlerëson argumentet dhe vërtetimet matematikore;
- 1.2.10. përzgjedh dhe përdor tipa të ndryshme të arsyetimit dhe të metodave të vërtetimit;
- 1.2.11. përdor gjuhën e matematikës për të shprehur në mënyrë të saktë idetë;
- 1.2.12. komunikon idetë e tij matematikore në mënyrë të kuptueshme dhe të qartë;
- 1.2.13. analizon dhe vlerëson idetë matematikore të dhëna nga të tjerët;
- 1.2.14. krijon lidhje varësie ndërmjet/nëpërmjet koncepteve të ndryshme matematikore në kontekste brenda dhe jashtë matematikës;
- 1.2.15. demonstroi idetë matematikore për ndërtimin e një produkti tjetër me lidhje logjike;
- 1.2.16. mbështet dhe thëllon të kuptuarin matematik nëpërmjet prezantimeve të ndryshme;
- 1.2.17. përdor prezantimet për të modeluar dhe interpretuar fenomene matematikore, fizike dhe sociale;
- 1.2.18. përzgjedh, aplikon dhe modifikon ide matematikore nëpërmjet prezantimit të zgjidhjes problemore;
- 1.2.19. përdor teknologjinë për të rritur cilësinë e mësimdhënies - nxënies në matematikë si: mjete digjitale jetësore, programe kompjuterike matematikore (math type), llogaritje të grafikëve dhe të diagrameve, mënyra për mbledhjen e të dhënave dhe prezantime në softëare.

## **Standardi 2: MJESHTËRIA PËR NUMRAT DHE VEPRIMET ME TO**

### **2.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i matematikës demonstroi aftësi dhe mjeshtëri në llogaritje, zotëron një të kuptuar konceptual të numrave, të mënyrave të paraqitjes së numrave, marrëdhëniet midis tyre, sistemeve numerike, si dhe kuptimet e veprimeve me to.

### **2.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 2.2.1. zotëron një të kuptuar konceptual të teorisë së numrave realë;
- 2.2.2. koncepton strukturën e sistemeve numerike, kuptimin e sasisë, marrëdhënien ndërmjet sasisë dhe paraqitjes simbolike;
- 2.2.3. krijon lidhjet ndërmjet koncepteve numerike, veprimeve dhe algoritmeve, vetive të

- numrave;
- 2.2.4. analizon dhe shpjegon konceptet matematikore, të cilat lidhen me veprimet përfshirë numrat e plotë, racionalë, realë dhe numrat kompleks;
  - 2.2.5. përdor veti të veprimeve me numrat, llogaritjet me mend dhe llogaritjet vlerësuese;
  - 2.2.6. zbaton rregullat themelore për logaritmet dhe eksponencialët;
  - 2.2.7. përdor kuptimin e numrave shumë të mëdhenj dhe shumë të vegjël, si dhe nocionet shkencore lidhur me to;
  - 2.2.8. krahason ndryshimet e vetive të numrave në bashkësi të ndryshme;
  - 2.2.9. krahason matricat dhe vektorët si sisteme të cilat kanë disa veti të përbashkëta dhe të ndryshme të sistemit të numrave realë;
  - 2.2.10. zotëron evoluimin e konceptit të numrit dhe veprimeve me numra nga një klasë në tjetrën;
  - 2.2.11. demonstroi njohuri për historinë e zhvillimit të numrave dhe sistemet numerike përfshirë kontributet e kulturave të ndryshme.

### Standardi 3: ZHVILLIMI I ALGJEBRËS DHE I FUNKSIONIT

#### 3.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesi i matematikës njeh dhe demonstroi marrëdhëniet ndërmjet madhësive, mënyrat e prezantimit, si dhe analizën e këtyre marrëdhënieve. Ai prezanton në disa mënyra zgjidhjen e situatave problemore algjebrike dhe ndërton grafikë të funksioneve të ndryshme duke i lidhur me situata nga jeta reale.

#### 3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 3.2.1. modelon situata problemore duke përdorur vetitë, grafikët dhe zbatimet e funksioneve;
- 3.2.2. përdor lidhjet ndërmjet paraqitjeve grafike, numerike dhe simboleve të funksioneve;
- 3.2.3. analizon lidhjet ndërmjet ndryshoreve, ekuacioneve, inekuacioneve dhe sistemeve algjebrikë;
- 3.2.4. analizon modele, relacione dhe funksione me një dhe dy ndryshore;
- 3.2.5. aplikon formulat themelore të algjebërës;
- 3.2.6. zbaton konceptet kryesore të algjebërës për të shpjeguar veprimet algjebrike dhe strukturat algjebrike;
- 3.2.7. përdor modele të ndryshme matematikore për të paraqitur marrëdhëniet e madhësive;
- 3.2.8. argumenton shndërrimet algjebrike të shprehjeve shkronjore, ekuacioneve dhe inekuacioneve;
- 3.2.9. zbaton konceptet për relacionet dhe funksionet;
- 3.2.10. zbaton konceptet për vargjet numerike dhe progresionet;
- 3.2.11. përdor teknologjinë për të demonstruar ide algjebrike, grafikë funksionesh dhe zgjidhje problemash;



- 3.2.12.** përdor tabela, grafikë, teknika algjebrike për të zgjidhur ekuacione, inekuacione dhe sisteme;
- 3.2.13.** referon evoluimin e koncepteve algjebrike nga njëra klasë në tjetrën;
- 3.2.14.** demonstroi njohuri për historinë e zhvillimit të algjebres dhe të funksionit, përfshirë kontributin e kulturave të ndryshme.

#### **Standardi 4: PROCESET E MATJES DHE TË TRIGONOMETRISË**

##### **4.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i matematikës zbaton dhe përdor konceptet për matje të drejtpërdrejta me anë të mjeteve të matjes. Ai zbaton matjet me anë të formulave kryesore të matjeve, duke krahasuar rezultatin dhe vlerësimin e përafërt. Mësuesi përdor formulat trigonometrike për të përshkruar dukuri të thjeshta periodike.

##### **4.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1.** zgjedh mjetet dhe njësitet e përshtatshme për matjet duke prezantuar rezultatet;
- 4.2.2.** përdor kalimet e njëvlershme nga një sistem matje në një tjetër;
- 4.2.3.** aplikon teknika të përshtatshme, mjete dhe formula për të përcaktuar matjet dhe zbatimet e tyre në kontekste të ndryshme;
- 4.2.4.** kontrollon me anë të matjeve, parashikimet e gabuara nëpërmjet përcaktimit të saktë të numrave të fituara nga matjet;
- 4.2.5.** interpreton formula, për njehsimin e perimetrit, syprinës dhe vëllimit, si edhe masa këndesh në figura gjeometrike, në plan dhe në hapësirë;
- 4.2.6.** zotëron kuptimin e përafrimit në matje;
- 4.2.7.** demonstroi raportet bazë trigonometrike në trekëndëshin kënddrejtë dhe të çfarëdoshëm;
- 4.2.8.** referon për evoluimin e matjes si koncept nga njëra klasë në tjetrën;
- 4.2.9.** demonstroi njohuri për historinë e zhvillimit të matjeve dhe sistemeve të matjeve përfshirë kontributin e kulturave të ndryshme.

#### **Standardi 5: METODAT GJEOMETRIKE NË PLAN DHE NË HAPËSIRË**

##### **5.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i matematikës përdor arsyetimin dhe vërtetimin gjeometrik për të zgjidhur situata problemore gjeometrike abstrakte ose të lidhura me jetën reale. Ai përdor përfytyrimin hapësinor dhe modele të ndryshme për të shpjeguar dhe për të analizuar hapësirat gjeometrike, ndërtimin dhe vetitë e tyre.

##### **5.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 5.2.1. zbaton vetitë e gjeometrisë në plan dhe në hapësirë për të shpjeguar ndërtimin e modeleve të ndryshme;
- 5.2.2. përdor arsyetimin matematikor për të përgjithësuar, argumentuar dhe provuar marrëdhëniet gjeometrike;
- 5.2.3. demonstroi njohuri për konceptet dhe parimet e gjeometrisë euklidiane në forma dy dhe tredimensionale;
- 5.2.4. ekspozon njohuri në rolin themelor të sistemit të aksiomave dhe vërtetimeve në gjeometri;
- 5.2.5. analizon vetitë dhe marrëdhëniet me hapësirat dhe strukturat gjeometrike;
- 5.2.6. ndërton dhe përdor prezantime të formave dydimensionale dhe tredimensionale dhe përfytyron një objekt nga pamje të ndryshme;
- 5.2.7. përcakton vendndodhjen dhe përshkruan marrëdhënie hapësinore duke përdorur koordinatat, vektorët dhe sistemet e tjera të paraqitjes;
- 5.2.8. aplikon transformime dhe përdor kongruencën, ngjashmërinë, simetrinë, zhvendosjen, rrotullimin për të analizuar situata matematikore;
- 5.2.9. përdor modele konkrete vizatimi, për të shpjeguar idetë gjeometrike dhe aplikimet e tyre në botën reale;
- 5.2.10. referon për evoluimin e koncepteve gjeometrike nga njëra klasë në tjetrën;
- 5.2.11. zbaton formulat themelore të trigonometrisë në zgjidhjen e problemave;
- 5.2.12. demonstroi njohuri për historinë e zhvillimit të gjeometrisë euklidiane dhe jo - euklidiane, përfshirë dhe kontributet e kulturave të ndryshme.

## Standardi 6: NJEHSIMET DIFERENCIALE DHE INTEGRALE <sup>7</sup>

### 6.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesi i matematikës demonstroi dhe aplikon kuptimin e limitit, vazhdueshmërisë, derivatit dhe integralit, si një formim tërësor në teknikat dhe në zbatimet e njehsimeve.

### 6.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 6.2.1. demonstroi njohje konceptuale dhe thelbësore të koncepteve bazë të njehsimit diferencial dhe integral;
- 6.2.2. përdor kuptimin e limitit, vazhdueshmërisë në situata të ndryshme problemore;
- 6.2.3. zbaton konceptet e njehsimit diferencial dhe integral në zgjidhjen e problemave të algjebërës, gjeometrisë, fizikës etj.;
- 6.2.4. përdor teknologjinë për të shpjeguar dhe për të paraqitur konceptet themelore të njehsimeve;
- 6.2.5. përdor diferencialin dhe integralin në zbatimet e njehsimeve;
- 6.2.6. demonstroi njohuri për historinë e zhvillimit të njehsimeve diferenciale e integrale

<sup>7</sup>Ky standard i referohet mësuesit të arsimit të mesëm të lartë

përfshirë kontributet e kulturave të ndryshme.

## **Standardi 7: ZBATIMI I STATISTIKËS DHE I PROBABILITETIT**

### **7.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i matematikës njih dhe përdor statistikën dhe probabilitetin për të analizuar, modeluar dhe zgjidhur problema nga jeta reale. Ai kryen eksperimente statistikore për çështje të ndryshme.

### **7.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 7.2.1.** projektton hetime, mbledh të dhëna dhe përdor mënyra të ndryshme për t'i paraqitur ato, si dhe për të interpretuar prezantimet e tyre;
- 7.2.2.** përdor metoda të përshtatshme si zgjedhja e rastit ose funksione të rastit për të kryer një studim statistikor;
- 7.2.3.** përdor metoda statistikore të duhura dhe mjete teknologjike për të analizuar të dhëna dhe vëzhgime të përshkruara;
- 7.2.4.** përdor konkluzione statistikore për të hartuar konkluzionet përfundimtare të të dhënave;
- 7.2.5.** identifikon përdorimet e statistikës dhe probabilitetit, me kusht në ngjarje nga jeta reale;
- 7.2.6.** harton konkluzione paraprake, përfshirë pasiguritë, për të vlerësuar probabilitetet dhe të dhënat e mbledhura si dhe për të hartuar konkluzione dhe vendime përfundimtare;
- 7.2.7.** demonstroi njohuri për elementet bazë të kombinatorikës dhe formulon zgjidhje të situatave problemore në kontekste reale;
- 7.2.8.** përdor teknologjinë për të zgjidhur problema, përfshirë edhe përdorimin e strukturave diskrete dhe zbatimin e algoritmit;
- 7.2.9.** demonstroi njohuri për historinë e zhvillimit të probabilitetit dhe statistikës përfshirë dhe kontributet e kulturave të ndryshme.

## **Standardi 8: QËNDRIME DHE VLERA NË MËSIMDHËNIEN E LËNDËS SË MATEMATIKËS**

### **8.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i matematikës trajton me përgjegjshmëri rëndësinë e mësimit dhe nxënies dhe vlerësimit në lëndën e matematikës duke përdorur situata të nxënies që lidhin matematikën me jetën reale. Ai nxit vetëvlerësimin dhe vetëbesimin te nxënësit duke frymëzuar te ata faktin se matematikën mund ta mësojnë të gjithë.

### **8.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 8.2.1.** nxit te nxënësit të kuptuarin dhe komunikimin matematik;
- 8.2.2.** planifikon situata të nxënies që lidhin matematikën me situata nga jeta reale;
- 8.2.3.** nxit idetë origjinale të nxënësve në matematikë dhe prezantimin e tyre nëpërmjet

- detyrave krijuese dhe projekteve kurrikulare;
- 8.2.4.** frymëzon të nxënësi kuriozitetin ose kërshtërinë për konceptet matematikore;
  - 8.2.5.** respekton punën e nxënësit (personale dhe në grup) dhe nxit pranimin me tolerancë të opinionëve të të tjerëve (madje edhe të kundërta) në argumentime apo zgjidhje të situatave problemore matematikore;
  - 8.2.6.** demonstroi përgatitje dhe angazhim serioz në procesin e mësimdhënies-nxënies në lëndën e matematikës duke përdorur metodën e induksionit dhe të deduksionit në situata konkrete matematikore dhe duke treguar zhvillimit të tij akademik profesional;
  - 8.2.7.** nxit nxënësit të vetëvlerësojnë (ose të vlerësojnë shokun) progresin e tyre në lëndën e matematikës nëpërmjet kryerjes së ushtrimeve dhe zgjidhjes së situatave problemore;
  - 8.2.8.** inkurajon nxënësit të mësojnë nga gabimet e tyre dhe të përballen me sfidat e matematikës;
  - 8.2.9.** motivon nxënësit dhe nxit te ata vetëbesimin për të nxënësit në matematikë.

### 3.3 Standardet profesionale të fushës “Shkencat e natyrës”

#### Përshkrimi përmbledhës

Standardet e mësuesve të shkencave të natyrës përcaktojnë pritshmërinë e performancës dhe dijet shkencore që u nevojiten këtyre mësuesve për të garantuar një mjedis të nxënësit, ku të gjithë nxënësit të mësojnë shkencë. Ato reflektojnë ndryshimin e rolit të mësuesit, nga të qenit në qendër të orës së mësimin, në udhëheqës i procesit të të nxënësit.

Standardet lidhin idetë dhe disiplinat e fushës me njëra-tjetrën, si dhe me përvojat personale, me mjediset dhe me komunitetet e nxënësve. Për rrjedhojë, procesi i mësimdhënies duhet të jetë dinamik dhe reciprok, duke iu përgjigjur shumë konteksteve në të cilat nxënësit mësojnë shkencën. Kjo kërkon që mësuesit të integrojnë dijet e lëndëve të fushës dhe programet për të krijuar një urë në mes qëllimeve të mësimin të shkencave me jetën e nxënësve.

Në këtë kontekst të gjithë mësuesit e shkencave të natyrës do të demonstrojnë kompetenca sipas standardeve themelore të fushës si dhe kompetenca specifike që i përkasin secilës prej lëndëve biologji, kimi, fizikë.

#### Standardi 1: SHKENCA SI KËRKIM

##### 1.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesi i shkencës njeh dhe zotëron kompetencat e kërkimit shkencor.

##### 1.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 1.2.1.** zotëron hapat proceduralë për planifikimin e një kërkimi shkencor;

- 1.2.2. demonstroi njohje të rolit dhe zbatimin e matematikës në shkencë;
- 1.2.3. paraqet, ilustron me shembuj dhe mbron me argumente rezultatet e kërkimit;
- 1.2.4. formulon hipoteza të testueshme, si dhe zotëron parimet dhe procedurat e dizenjimit dhe kryerjes së kërkimeve shkencore;
- 1.2.5. përdor evidenca dhe logjikën shkencore për t'u dhënë shpjegime pyetjeve dhe hipotezave shkencore;
- 1.2.6. vlerëson rolin e rishikimit dhe vlerësimit kritik të rezultateve të kërkimeve shkencore, modeleve dhe interpretimeve.

## **Standardi 2: LIDHJA E SHKENCËS ME TEKNOLOGJINË DHE NDIKIMI I TYRE NË JETËN SHOQËRORE**

### **2.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i shkencës shpjegon ndërveprimin ndërmjet shkencës dhe teknologjisë dhe ndikimin e saj në shoqërinë njerëzore, duke përfshirë zhvillimin historik dhe bashkëkohor të ideve shkencore dhe risive në teknologji.

### **2.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 2.2.1. kupton se si shkenca dhe teknologjia ndikojnë në jetën e përditshme, vlerat shoqërore, mjedisin, njohuritë e reja gjatë gjithë historisë së zhvillimit;
- 2.2.2. shpjegon si ndikojnë zbulimet shkencore dhe teknologjike në fushat e tjera të studimit, edukimin për karrierë dhe tregjet e punës;
- 2.2.3. vlerëson rëndësinë e kriterëve për përcaktimin e politikave efikase për çështjet shkencore, teknologjike dhe mjedisore;
- 2.2.4. heton dhe vlerëson kërkesat shkencore të prezantuara në media, gjatë debateve publike, në reklamat apo fushatat e marketingut.

## **Standardi 3: UNIFIKIMI I KONCEPTEVE SHKENCORE**

### **3.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i shkencës përdor koncepte të unifikuara për të gjitha lëndët e fushës dhe tregon si lidhen këto koncepte me ato të disiplinave të tjera në mënyrë të veçantë me matematikën dhe shkencat shoqërore.

### **3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1. shpjegon lidhjet ndërmjet koncepteve dhe njohurive të lëndëve të fushës së shkencave të natyrës;
- 3.2.2. shpjegon proceset e përbashkëta ndërmjet lëndëve të fushës së shkencave të natyrës;
- 3.2.3. demonstroi njohje të gjuhës dhe aftësive matematikore për zgjidhjen e problemeve

shkencore, përdorur simbole shkencore për interpretimin e grafikëve përdorimin e probabilitetit;

**3.2.4.** shpjegon marrëdhëniet ndërmjet shkencave të natyrës dhe shkencave shoqërore.

#### **Standardi 4: MJEDISI I TË NXËNIT NË SHKENCË**

##### **4.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i shkencave skicon dhe menaxhon mjedise të sigurta dhe mbështetëse të mësuarit në të cilin të gjithë nxënësit mund të angazhohen në hetimin shkencor dhe zhvillimin e koncepteve shkencore.

##### **4.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1** zbaton procedurat e sigurisë dhe etikës të kujdesit ndaj kafshëve në mësimin e shkencës;
- 4.2.2** vlerëson mjedise të mësuarit për të përdorur praktika të sigurta dhe për të parandaluar problemet të mundshme lidhur me inventarizimin, ruajtjen dhe asgjësimin e kimikateve, burimeve dhe pajisjeve;
- 4.2.3** zhvillon një sërë kriteresh për matjen dhe vlerësimin e mjedisit mësimor optimal që promovon hetimin shkencor dhe të mësuarit;
- 4.2.4** zhvillon procedurat për të përshtatur mjedise të nxëni për të plotësuar nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta.

#### **3.3.1 Standardet profesionale të mësuesit të fizikës**

Standardet profesionale të mësuesit të fizikës, duhet të përmbushen nga çdo mësues i fizikës për ta ushtruar këtë profesion në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar. Këto standarde, mësuesi duhet t'i përmbushë gjatë gjithë karrierës së tij dhe përmbajnë kompetencat që duhet të zotërojë mësuesi për zotërimin e njohurive bazë dhe praktikave profesionale në procesin mësimor, si dhe për zhvillimin profesional të vazhdueshëm të tij.

#### **Standardi 1: KËRKIMI SHKENCOR DHE ROLI I TIJ NË LËNDËN E FIZIKËS**

##### **1.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i fizikës shpjegon, zbaton dhe vlerëson procesin e kërkimit shkencor në lëndën e fizikës.

##### **1.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 1.2.1.** zotëron hapat e procedurës për planifikimin e një kërkimi shkencor që përmban;
  - a) përzgjedhjen e pajisjeve të përshtatshme për të kryer kërkimin shkencor;
  - b) formulimin e një pyetjeje shkencore apo një hipoteze të testueshme;



- c) kryerjen e provave dhe mbrojtjen me argumente të hipotezës së ngritur apo pyetjes shkencore.
- 1.2.2. përdor aparatit matematikor për mbledhjen, përpunimin dhe nxjerrjen e rezultateve;
- 1.2.3. paraqet, ilustron me shembuj dhe mbron me argumente rezultatet e kërkimit;
- 1.2.4. udhëzon nxënësit dhe i nxit ato të përfshihen në kërkimin shkencor;
- 1.2.5. përdor kriteret për vlerësimin e nxënësve në procesin e kërkimit shkencor.

## **Standardi 2: LIDHJA E FIZIKËS ME TEKNOLOGJINË DHE NDIKIMI I TYRE NË JETËN SHOQËRORE**

### **2.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i fizikës shpjegon ndërveprimin ndërmjet fizikës dhe teknologjisë dhe ndikimin e saj në jetën e shoqërisë njerëzore, duke përfshirë zhvillimin historik dhe bashkëkohor të ideve shkencore dhe inovacioneve teknologjike.

### **2.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 2.2.1. analizon marrëdhënien ndërmjet fizikës, teknologjisë dhe veprimtarive në jetën e përditshme;
- 2.2.2. argumenton se përdorimi i fizikës dhe teknologjisë nga njeriu mbështet nga disa faktorë: standardet etike, ekonomike, shoqërore dhe nevojat personale;
- 2.2.3. analizon burimet e energjisë dhe shfrytëzimin e saj dhe tregon si ndikon përdorimi i këtyre burimeve në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ruajtjes së mjedisit;
- 2.2.4. analizon rolin që luan fizika në përballimin e sfidave personale, shoqërore dhe globale;
- 2.2.5. shpjegon si ndikojnë zbulimet shkencore dhe teknologjike në fushat e tjera të studimit, edukimin për karrierë dhe tregjet e punës;
- 2.2.6. vlerëson me efikasitet kriteret për përcaktimin e politikave efektive për çështjet shkencore, teknologjike dhe mjedisore;
- 2.2.7. heton dhe vlerëson kërkesat shkencore të prezantuara në media, gjatë debateve publike, në reklamat apo fushatat e marketingut;
- 2.2.8. jep shembuj të zbatime të ligjeve të fizikës në jetën e përditshme, duke lidhur fizikën me teknologjinë.

## **Standardi 3: UNIFIKIMI I KONCEPTEVE TË FIZIKËS**

### **3.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i fizikës përdor koncepte të unifikuara për të gjitha tematikat ku mbështetet programi i saj, (diversiteti, ndërveprimet, sistemet, modelet, energjia, shkallëzimi dhe matjet) dhe tregon si

lidhen këto koncepte me konceptet e lëndëve brenda së njëjtës fushë, si dhe të lëndëve që i përkasin fushave të tjera të kurrikulës.

### **3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1. shpjegon lidhjet ndërmjet koncepteve bazë të lëndëve të fushës së shkencave të natyrës;
- 3.2.2. shpjegon proceset e përbashkëta ndërmjet lëndëve të fushës së shkencave të natyrës;
- 3.2.3. përdor koncepte të unifikuara të fizikës në procesin mësimor.

## **Standardi 4: FIZIKA DHE ZBATIMET E SAJ NË SITUATA TË JETËS SË PËRDITSHME**

### **4.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i fizikës zotëron njohuritë dhe aftësitë për zbatimin e ligjeve të fizikës në situata reale të jetës së përditshme.

### **4.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1 përkufizon saktë hipotezat, ligjet, teoritë, parimet për ti testuar ato në situata të jetës reale;
- 4.2.2 përdor metodat dhe përzgjedh pajisjet e duhura për kryerjen e matjeve të madhësive fizike;
- 4.2.3 jep shembuj konkretë të aftësive krijuese, mendimit kritik dhe inovacionit gjatë kërkimit shkencor;
- 4.2.4 demonstroi aftësitë për zbatimin e praktikave të sigurta në përdorimin e instrumenteve dhe funksionimin e tyre gjatë veprimtarive praktike të fizikës në klasat laboratorike;
- 4.2.5 përdor metodat për mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre gjatë eksperimenteve;
- 4.2.6 përdor pajisjet e duhura për të demonstruar parimet, dukuritë dhe ligjet e fizikës;
- 4.2.7 shpjegon rëndësinë e zhvillimit të njohurive bazë të fizikës në perspektivën historike;
- 4.2.8 përdor kompjuterin, për ndërtimin e grafikëve dhe kryerjen e procedurave statistikore, mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave.

## **Standardi 5: FORCAT DHE LËVIZJA**

### **5.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i fizikës përdor konceptet që përshkruajnë lëvizjet e trupit në çdo çast të kohës dhe ligjet që lidhen me veprimin e forcave që shkaktojnë këto lëvizje.

### **5.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 5.2.1 shpjegon konceptet e vendndodhjes, kohës, shpejtësisë, dhe nxitimit të pikës

- materiale/trupit të ngurtë;
- 5.2.2** dallon madhësitë fizike skalare nga ato vektoriale;
- 5.2.3** përshkruan efektet e forcave gravitacionale, elektromagnetike, bërthamore dhe të dobëta në situata konkrete të jetës reale;
- 5.2.4** shpjegon lëvizjen e trupit në plan dhe hapësirë në çdo çast të kohës duke e interpretuar me anën e shembujve konkretë;
- 5.2.5** shpjegon konceptin e forcës, llojet e saj dhe zbatimet e ligjeve të dinamikës në situata reale;
- 5.2.6** shpjegon dukurinë e inercisë, momentet e inercisë, momentin e forcës dhe momentin e çiftit të forcave, forcat dhe çiftet e forcave ,që zbatohen respektivisht në lëvizjet drejtvizore dhe rrotulluese;
- 5.2.7** përdor ligjet e ruajtjes dhe i zbaton ato në situata reale të jetës së përditshme;
- 5.2.8** parashikon lëvizjen e trupit në çdo çast të kohës kur njihen kushtet fillestare të lëvizjes së tij;
- 5.2.9** përdor konceptin e forcës së rëndësës në problemet që lidhen me ligjin e tërheqjes së gjithësishtme, rënien e lirë të trupave dhe lëvizjen e projektuar;
- 5.2.10** zbaton ligjet e Njutonit për një trup, lëvizja e të cilit shkaktohet nga një forcë ose nga një rezultante forcash që veprojnë mbi të;
- 5.2.11** zbaton ligjet e ruajtjes për një trup, kur mbi të nuk veprojnë forcat e jashtme;
- 5.2.12** përdor lidhjen ndërmjet punës dhe energjisë për të analizuar lëvizjen e trupave, të cilët janë nën veprimin e forcave konservative ose jo konservative.

## Standardi 6: FORCA DHE ENERGJIA

### 6.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i fizikës shpjegon konceptin e energjisë dhe format e ndryshme të saj, si dhe proceset përmes të cilave energjia shkëmbehet nga një trup te një tjetër apo shndërrohet nga një formë në një tjetër.

### 6.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 6.2.1** përshkruan burimet e ripërtërishme dhe të paripërtërishme të energjisë;
- 6.2.2** liston format e ndryshme të energjisë dhe i përshkruan ato nëpërmjet shembujve konkretë (kinetike, potenciale, mekanike, potenciale elasticitetit, kimike, elektrike, bërthamore, termike, radioaktive);
- 6.2.3** shpjegon lidhjen e punës me energjinë;
- 6.2.4** shpjegon ligjin e ruajtjes dhe shndërrimit të energjisë mekanike;
- 6.2.5** tregon si e shfrytëzon njeriu energjinë për nevojat e jetës së përditshme.

## Standardi 7: VALËT MEKANIKE DHE ELEKTROMAGNETIKE

### **7.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i fizikës shpjegon natyrën dhe vetitë e valëve mekanike dhe elektromagnetike, dhe tregon si bashkëveprojnë ato me lëndën.

### **7.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 7.2.1** identifikon llojet e valëve dhe shpjegon vetitë dhe karakteristikat e tyre;
- 7.2.2** identifikon madhësitë fizike që karakterizojnë valët mekanike dhe elektromagnetike;
- 7.2.3** analizon shpejtësinë e valës dhe varësinë e saj nga mjedisi ku përhapet;
- 7.2.4** shpjegon karakteristikat e tingullit dhe kushtet e përhapjes së tij në mjedise të ndryshme;
- 7.2.5** bën dallimin mes vetive fizike dhe fiziologjike të tingullit;
- 7.2.6** interpreton parimet bazë të optikës gjeometrike dhe optikës fizike;
- 7.2.7** analizon dualizmin valë-thërrmijë dhe relacionin e papërcaktueshmërisë;
- 7.2.8** analizon me shembuj përdorimin e ligjeve të optikës gjeometrike në ndërtimin e sistemeve optikë si: mikroskopi, teleskopi;
- 7.2.9** analizon përdorimin e ligjeve të optikës gjeometrike te syri si sistem optik për të bërë korrigjimin e defekteve të tij.

## **Standardi 8: NXEHTËSIA DHE TEMPERATURA**

### **8.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i fizikës shpjegon si lidhen nxehtësia me temperaturën përmes ligjeve të termodinamikës.

### **8.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 8.2.1** shpjegon konceptet bazë të nxehtësisë dhe temperaturës, dhe si ndryshon temperatura nga vetitë e lëndës;
- 8.2.2** zbaton ligjet e termodinamikës duke analizuar lidhjet e temperaturës, punës, energjisë dhe entropisë;
- 8.2.3** përdor formulën që shpreh lidhjen përmes nxehtësisë dhe punës për sistemet termodinamike;
- 8.2.4** analizon teorinë molekulare-kinetike të lëndës;
- 8.2.5** identifikon proceset e kthyeshme dhe të pakthyeshme duke zbatuar ligjet e termodinamikës;
- 8.2.6** llogarit madhësitë termodinamike gjatë zbatimit të ligjeve të gazeve;
- 8.2.7** analizon lidhjen mes nxehtësisë dhe punës në motorët termikë.

## **Standardi 9: ELEKTRICITETI DHE MAGNETIZMI**

### **9.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i fizikës shpjegon elektricitetin dhe magnetizmin dhe lidhjen ndërmjet tyre.

## 9.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 9.2.1 shpjegon karakteristikat dhe natyrën e ngarkesës elektrike, fushës elektrike dhe potencialit elektrik;
- 9.2.2 ndërton skemat e qarqeve në seri dhe në paralel, dhe përshkruan elementet e një qarku elektrik;
- 9.2.3 tregon si ndikon fusha magnetike mbi një ngarkesë elektrike apo mbi një përcjellës me rrymë;
- 9.2.4 tregon si ndikon rryma që kalon në përcjellësin drejtvizor ose te një solenoid për lindjen e fushës magnetike;
- 9.2.5 demonstroi dukurinë e induksionit elektromagnetik;
- 9.2.6 analizon përdorimet e magnetëve dhe fushave magnetike në jetën e përditshme;
- 9.2.7 identifikon parimet dhe përdorimet e elektromagnetizmit në jetën e përditshme;
- 9.2.8 ilustron nëpërmjet demonstrimeve vizuale apo simulimeve ngarkesat elektrike, fushën elektrike, potencialin elektrik, dhe intensitetin e rrymës elektrike;
- 9.2.9 analizon ndërtimin dhe funksionimin e elektromagnetëve, elektromotorëve dhe gjeneratorëve.

## Standardi 10: STRUKTURA E ATOMIT DHE BËRTHAMËS

### 10.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i fizikës shpjegon strukturën e atomit dhe bërthamës.

### 10.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 10.2.1 shpjegon modelin e strukturës së atomit;
- 10.2.2 analizon formulën që shpreh lidhjen e energjisë së elektronit në nivele të ndryshme energjetike me frekuencën që i përgjigjet vijave spektrale të atomeve të ndryshme;
- 10.2.3 tregon karakteristikat e grimcave elementare;
- 10.2.4 shpjegon ligjet e rrezatimit termik dhe dukurinë e foto efektit;
- 10.2.5 analizon reaksionet bërthamore duke u mbështetur në ligjin e ruajtjes së ngarkesave dhe përdorimet e tyre;
- 10.2.6 identifikon përdorimet e radioaktivitetit në shkencë dhe teknologji;
- 10.2.7 shpjegon si përftohen dhe transmetohen rrezatimet radioaktive;
- 10.2.8 analizon bashkëveprimin e rrezatimeve me lëndën dhe organizmat e gjalla.

## Standardi 11: TEORIA SPECIALE E RELATIVITETIT

### 11.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i fizikës shpjegon elementët bazë të teorisë speciale të relativitetit dhe zbatimet e saj, elemente të mekanikës kuantike dhe fizikën e trupit të ngurtë.

### 11.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 11.2.1 shpjegon lidhjen e kohës, hapësirës dhe masës në teorinë speciale të relativitetit;
- 11.2.2 interpreton dualizmin valë-thërrmijë dhe parimin e papërcaktueshmërisë;
- 11.2.3 tregon natyrën e mekanikës kuantike dhe bashkëveprimin ndërmjet rrezatimit dhe lëndës;
- 11.2.4 tregon rolin e elementëve të elektronikës, si: përcjellësit, gjysmëpërcjellësit në ndërtimin e diodave dhe transistorëve;
- 11.2.5 përcakton ndryshimin e madhësive fizike në lëvizjen relativiste dhe shpjegon shkakun e ndryshimit të këtyre madhësive;
- 11.2.6 demonstroi me modele teorike të thjeshta vetitë e lëndës dhe bashkëveprimin e lëndës me energjinë;
- 11.2.7 përshkruan rëndësinë e energjisë së kuantifikuar dhe tregon si varet ajo nga lloji i atomit dhe natyra e lëndës.

### 3.3.2 Standardet profesionale të mësuesit të biologjisë

Standardet profesionale të mësuesve të biologjisë ndahen në 6 standarde, të cilat lidhen organikisht me standardet e përgjithshme profesionale të mësuesit dhe me ato të fushës. Hierarkia në renditjen e standardeve nuk është e rëndësishme sepse të gjitha aspektet e mësimdhënies-mësimnxënies që ato pasqyrojnë janë njësoj të rëndësishme.

Të gjithë mësuesit e biologjisë duhet të demonstrojnë kompetenca si të standardeve të përgjithshme profesionale dhe standardeve themelore të fushës, ashtu edhe të standardeve specifike lëndore që duhet ti udhëheqin ata në punën e tyre.

### Standardi 1: NJOHURI PËR BIOLOGJINË MOLEKULARE DHE QELIZORE

#### 1.1. Përshkrimi i standardit

Mësuesi i biologjisë zotëron një kuptim të thellë të koncepteve të biologjisë qelizore.

#### 1.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 1.2.1. demonstroi njohje të strukturës dhe funksionit të acideve nukleike, proteinave, karbohidrateve, lipideve dhe reaktivitetin kinetik të enzimave;
- 1.2.2. analizon përdorimin dhe sintezën e materialeve organike nga sistemet e gjalla, marrëdhëniet e këtyre proceseve në prodhimin e energjisë dhe përdorimin në nivel qelizor;
- 1.2.3. demonstroi njohje të metodave themelore dhe proceset e përdorura për hulumtimin e qelizave, biologjinë molekulare, indeve të specializuara, organeve dhe organizmit;
- 1.2.4. vizaton dhe /ose përshkruan modele që paraqesin reaksione kimike bërthamore dhe qelizore kimike në nivel mikroskopik dhe mikroskopik;
- 1.2.5. tregon përdorimin dhe aplikimin e teknologjisë dhe instrumentet e përdorura për të



- studiuar fenomenet biologjike në nivel qelizor për prokariotët dhe eukariotët;
- 1.2.6. përcakton ecurinë historike të studimeve të biologjisë qelizore duke theksuar ndryshimet në njohuritë mbi përparimet në teknologji dhe tregon pasojat shoqërore;
  - 1.2.7. zhvillon, zgjedh dhe realizon punë në laborator në kushte të sigurta dhe të përshtatshme për të zhvilluar të kuptuarit nga nxënësit të biologjisë qelizore.

## Standardi 2: BAZAT MOLEKULARE TË TRASHËGIMISË

### 2.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesi i biologjisë zotëron një kuptim të thellë të bazave molekulare të trashëgimisë dhe probabilitetin matematikor lidhur me gjenealogjinë.

### 2.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 2.2.1. analizon natyrën dhe funksionin e gjenit, duke vënë theksin mbi bazat molekulare të trashëgimisë dhe shprehjen e gjenit;
- 2.2.2. kupton proceset që përfshihen në sekuencën e gjeneve dhe teknologjive që do të kontribuojnë në përparimet në këtë fushë;
- 2.2.3. demonstroi njohje të shpjegimeve gjenetike dhe matematikore që lidhen me probabilitetin e transmetimit të tipareve dhe defektet në organizmat;
- 2.2.4. demonstroi njohje të bazave dhe ndikimin e koncepteve *mutacion* dhe *zhdukje*;
- 2.2.5. kupton konceptet, teknologjitë dhe pasojat që lidhen me zbatimet e ADN rekombinante;
- 2.2.6. shpjegon në mënyrë skematike teknologjitë që lidhen me strategji të ndryshme të sekuencave gjenike dhe manipulimet;
- 2.2.7. skicon modele fizike dhe matematikore , shkallë të ndryshme të sofistikimit, të cilat shpjegojnë natyrën e gjenit dhe shprehjen e parashikuar të tij në organizmat të ndryshëm;
- 2.2.8. tregon përdorimin dhe aplikimin e instrumenteve të përdorura në studimet bioteknologjike;
- 2.2.9. përcakton ecurinë historike të studimeve të bioteknologjisë, duke theksuar ndryshimet në njohuritë mbi përparimet në teknologji dhe tregon pasojat shoqërore;
- 2.2.10. zhvillon, zgjedh dhe realizon punë të sigurt dhe të përshtatshme, në laborator, në terren dhe klasë, aktivitete për të zhvilluar te nxënësit të kuptuarit e bioteknologjisë.

## Standardi 3: EVOLUCIONI BIOLOGJIK

### 3.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesi i biologjisë zotëron një të kuptuar të thellë të evolucionin biologjik.

### 3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 3.2.1. shpjegon diversitetin biologjik duke vënë theksin në marrëdhëniet evolutive midis

- grupeve të mëdha;
- 3.2.2. analizon proceset e seleksionimit natyror dhe formimit të llojeve në të cilën një pjesë ose e tëra e tipit, klasës rendit, gjinisë dhe lloje të organizmave kanë evoluar ose janë zhdukur gjatë kohës;
  - 3.2.3. demonstroi njohje të evidencave nga anatomia krahasuese, sjelljet, embriologjia, gjenetika, paleontologjia dhe studimet fiziologjike që kontribuojnë në shpjegimet e teorisë së evolucionit;
  - 3.2.4. përmend dhe përshkruan shembuj të provave evolutive nga të dhënat gjeologjike, biokimike, gjenetike, embriologjike dhe fosilet;
  - 3.2.5. krahason dhe dallon strukturat qelizore dhe nën-qelizore dhe proceset molekulare midis grupeve të mëdha të organizmave;
  - 3.2.6. përshkruan zbulimet e fundit ose hulumtimet që lidhen me testimin e teorisë së evolucionit dhe mekanizmat e saj;
  - 3.2.7. përcakton ecurinë historike të studimeve të evolucionit, duke theksuar ndryshimet në njohuritë mbi përparimet në teknologji dhe tregon pasojat shoqërore;
  - 3.2.8. zhvillon, zgjedh dhe realizon aktivitete e duhura në klasë për të zhvilluar te nxënësit të kuptuarit e evolucionit.

#### **Standardi 4: BIOLOGJIA E ORGANIZMAVE DHE DIVERSITETI**

##### **4.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i biologjisë zotëron një kuptim të thellë të biologjisë së organizmave dhe diversitetin.

##### **4.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1. demonstroi të kuptuarit e biologjisë molekulare dhe biokiminë e proceseve themelore të funksioneve metabolike në sisteme të ndryshme të organizmave të gjallë;
- 4.2.2. shpjegon se si organizmat njohin dhe lokalizojnë sinjale të ndryshme për të mbajtur homeostazën kudo në gjithë organizmin;
- 4.2.3. analizon diversitetin biologjik që përfshin strukturën, funksionin dhe nomenklaturat e grupeve të mëdha të organizmave në nivel lokal, rajonal dhe global;
- 4.2.4. kupton proceset dhe kërkesat e nevojshme për mbarëvajtjen dhe vazhdimësinë e jetës përfshirë edhe njerëzit;
- 4.2.5. harton dhe shpjegon modelet që tregojnë se si organizmat reagojnë ndaj stimuljeve brenda dhe jashtë organizmit;
- 4.2.6. analizon lidhjet midis funksioneve të sistemeve të ndryshme të organizmit;
- 4.2.7. demonstroi përdorimin e instrumenteve të ndryshme dhe teknologjive që mundësojnë studimin e organizmave në nivele mikroskopike dhe mikroskopike;
- 4.2.8. zhvillon, zgjedh dhe realizon veprimtari të sigurt dhe të përshtatshme në laborator, në terren dhe klasë për të zhvilluar te nxënësit të kuptuarit e biologjisë së organizmave dhe diversitetin e tyre.

## Standardi 5: EKOLOGJIA

### 5.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesi i biologjisë zotëron të kuptuarit e ekologjisë.

### 5.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 5.2.1. analizon kategoritë e bashkëveprimit dhe varësisë së ndërsjelltë të organizmave në ekosisteme të ndryshme, duke përfshirë ndikimet mjedisore dhe faktorët kufizues që ndikojnë mbi to;
- 5.2.2. kupton konceptet dhe ndikimin e dinamikës së popullatave në mjedise dhe komunitete;
- 5.2.3. vlerëson ndikimin e njeriut në mjedis si dhe ndikimin e mjedisit ndaj njerëzve;
- 5.2.4. kupton efektin e faktorëve abiotikë në vendndodhjen e komuniteteve të ndryshme biotike;
- 5.2.5. analizon ndikimin e klimës, lartësisë, gjeografisë, etj. në vendndodhjen e bashkësive bimore dhe habitatet e kafshëve;
- 5.2.6. shpjegon konceptet e teknikat e mbijetesës për organizmat në mjedise të ndryshme dhe se si këto njohuri mund të aplikohen në kushte të ndryshme;
- 5.2.7. analizon faktorët e rrezikut/kostot/ përfitimet në studimet e ndikimit ndaj mjedisit;
- 5.2.8. kryen studime në terren për të zbuluar praninë e llojeve të ndryshme si indikatorë për shëndetin e ekosistemit;
- 5.2.9. demonstroi përdorimin e instrumenteve të ndryshme, teknologjinë dhe strategjitë e përdorura në hulumtimin e ekologjisë;
- 5.2.10. zhvillon, zgjedh dhe realizon veprimtari të përshtatshme dhe të sigurt, në laborator terren dhe klasë për të zhvilluar te nxënësit të kuptuarit e ekosistemeve lokale, rajonale dhe globale.

## Standardi 6: NJOHURI MBI LËNDËN, ENERGJINË DHE ORGANIZIMIN NË SISTEMET E GJALLA

### 6.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesi i biologjisë zotëron një kuptim të thellë mbi lëndën, energjinë dhe organizimin në sistemet e gjalla.

### 6.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 6.2.1. analizon rrjedhën e energjisë në sistemet biologjike dhe mjedisin fizik;
- 6.2.2. kupton shpërndarjen dhe sasinë e organizmave dhe popullatave në ekosisteme që kufizohen nga disponueshmëria e lëndës dhe energjisë;
- 6.2.3. kupton lidhjen ndërmjet konsumatorëve dhe prodhuesve dhe rrugët biokimike që çojnë

- në transferimin e energjisë;
- 6.2.4. kupton nevojën për marrjen, shndërrimin, transportimin, lirimin dhe eliminimin e lëndës dhe energjisë që përcaktohet nga variacioni i kompleksiteteve dhe organizimit të organizmave;
  - 6.2.5. skicon modele që tregojnë ndërtimin dhe ndarjen e qartë të molekulave në reaksionet biologjike;
  - 6.2.6. përshkruan transformimin e energjisë në reaksione të ndryshme biologjike;
  - 6.2.7. analizon shpërndarjen dhe sasinë e organizmave brenda një ekosistemi të kufizuar nga disponueshmëria e lëndës dhe energjisë;
  - 6.2.8. demonstroi përdorimin e instrumenteve, teknologjive dhe strategjive që analizojnë;
  - 6.2.9. zhvillon, zgjedh dhe realizon veprimtari të përshtatshme dhe të sigurt, në laborator terren dhe klasë për të zhvilluar te nxënësit të kuptuarit e faktorëve fizike dhe kimike në lidhje me sistemet e gjalla.

### 3.3.3 Standardet profesionale të mësuesit të kimisë

Mësuesit e kimisë duhet të zotërojnë një kuptim të thellë dhe të plotë të njohurive dhe aftësive të nevojshme për profesionin e mësuesisë dhe t'i përdorin ato për të ndihmuar nxënësit të përgatiten për sfidat dhe mundësitë që ofron shoqëria e hapur. Kjo kërkon aftësinë për të identifikuar, kuptuar, analizuar, sintetizuar dhe vlerësuar parimet bazë, konceptet themelore, përmbajtjen e përcaktuar në këto standarde, për t'i zbatuar ato në planifikimin efektiv të mësimdhënies dhe vlerësimit.

#### Standardi 1: STRUKTURA E ATOMIT

##### 1.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesit e kimisë zotërojnë një kuptim të gjerë dhe tërësor të strukturës së atomeve.

##### 1.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi zotëron:

- 1.2.1 masën, ngarkesën, dhe strukturën e grimcave në atom;
- 1.2.2 modelet historike dhe bashkëkohore të strukturës së atomit;
- 1.2.3 konfigurimin elektronik të atomeve dhe joneve dhe ndikimin e tij në sjelljet kimike;
- 1.2.4 marrëdhëniet midis grimcave përbërëse të atomeve dhe strukturës së tabelës periodike;
- 1.2.5 ndryshimi i vetive fizike dhe kimike të elementeve sipas periodave të tabelës periodike;
- 1.2.6 vetitë e lëndëve radioaktive, përfshirë qëndrueshmërinë bërthamore, gjysmëperiodat dhe llojet e emetimeve radioaktive;
- 1.2.7 natyrën e reaksioneve bërthamore dhe proceset e ndarjes dhe bashkimit.
- 1.2.8 parimet e teorisë kinetike molekulare;
- 1.2.9 lëvizjen, strukturën dhe ndërveprimin e grimcave në lëndët në gjendje të ngurtë, të lëngët, të gaztë dhe në gjendjen plazmode;

- 1.2.10 karakteristikat e elementeve, molekulave, joneve, komponimeve dhe përzierjeve;
- 1.2.11 vetitë kimike dhe fizike të lëndës dhe natyrën e shndërimeve kimike dhe fizike të saj;
- 1.2.12 zbatimin e ligjeve të gazeve në sistemet kimike;
- 1.2.13 përbërjen e tretësirave, suspensioneve dhe emulsioneve;
- 1.2.14 vetitë koligative<sup>8</sup> të tretësirave, faktorët që ndikojnë në tretshmëri dhe njësitë e përqendrimit;
- 1.2.15 rregullat e nomenklaturës së substancave inorganike.

## Standardi 2 : LIDHJET KIMIKE

### 2.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesit e kimisë zotërojnë një kuptim të gjerë dhe tërësor të parimeve të lidhjes kimike dhe të karakteristikave të forcave ndërmolekulare.

### 2.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi zotëron:

- 2.2.1 karakteristikat e lidhjes jonike, lidhjes kovalente, lidhjes metalike dhe parimet e lidhjes kimike;
- 2.2.2 përdorimin e strukturave Leëis për të përshkruar lidhjet kimike në një molekulë;
- 2.2.3 zbatimin e teorisë së shtytjes së çifteve elektronike të shtresës valentore (VSEPR), teoria e lidhjes valentore dhe teoria e orbitaleve molekulare;
- 2.2.4 përcaktimin e gjeometrisë molekulare të molekulave dhe joneve;
- 2.2.5 karakteristikat e llojeve të ndryshme të forcave ndërmolekulare si forcat dipol-dipol, forcat e dispersionit dhe forcat e lidhjes hidrogjenore;
- 2.2.6 përcaktimin e vetive të lëndëve nga forcat ndërmolekulare.

## Standardi 3: REAKSIONET KIMIKE

### 3.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesit e kimisë zotërojnë një kuptim të gjerë dhe tërësor të reaksioneve të përgjithshme kimike inorganike, si dhe të parimeve të aktivitetit kimik

### 3.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi zotëron:

- 3.2.1 llojet kryesore të reaksioneve kimike inorganike dhe treguesit e mundshëm të një reaksioni kimik;
- 3.2.2 konceptin e molit dhe përdorimin e tij në njehsimet kimike si reaktantët kufizues, rendimenti teorik dhe rendimentit në përqindje;

<sup>8</sup> Vetitë koligative të tretësirave përcaktohen nga raporti ndërmjet numrit të grimcave të substancës së tretur dhe numrit të molekulave ose joneve të tretësit; ato përfshijnë pikën e ngrirjes, pikën e vlimit, trysninë e avullit dhe trysninë osmotike.

- 3.2.3 ligjin e ruajtjes së masës dhe zbatimin e tij në barazimin e reaksioneve kimike;
- 3.2.4 teorinë e goditjeve dhe faktorët që ndikojnë në shpejtësinë e reaksioneve kimike;
- 3.2.5 kinetikën kimike, duke përfshirë, shpejtësinë e reaksionit, konstanten e shpejtësisë, ligjin e shpejtësisë, rendi i reaksionit dhe mekanizmat e reaksioneve bazë;
- 3.2.6 natyrën dinamike të ekuilibrit kimik, konstanten e ekuilibrit dhe faktorët që ndikojnë në ekuilibrin kimik;
- 3.2.7 përkufizimet e acideve dhe bazave sipas Arrheniusit, Brønsted-Loëry dhe Leëis dhe përcaktimin e pH dhe pOH në acidet dhe bazat e forta dhe të dobëta;
- 3.2.8 mënyrën e funksionimit të sistemeve tamponë si dhe parimet e zbatimit të titrimit acido-bazik;
- 3.2.9 parimet dhe zbatimet e elektrokimisë, duke përfshirë elektrolizën dhe elementin galvanik, potencialet elektrodike, dhe ekuilibrin elektrolitik.

#### **Standardi 4: TERMOKIMIA**

##### **4.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesit e kimisë zotërojnë një kuptim të gjerë dhe tërësor të ligjeve të termodinamikës, si dhe zbatimin e tyre në sistemet kimike.

##### **4.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi zotëron:

- 4.2.1 parimet dhe zbatimet e tre ligjeve të termodinamikës;
- 4.2.2 format e energjisë dhe transformimin e energjisë nga një formë në një tjetër;
- 4.2.3 konceptet e nxehtësisë dhe temperaturës;
- 4.2.4 përdorimin e kalorimetrit për të përcaktuar sasinë e nxehtësisë të thithur ose të çliruar në reaksionet kimike dhe proceset fizike;
- 4.2.5 lidhjen ndërmjet ndryshimeve energjetike, formimit dhe prishjes së lidhjeve kimike;
- 4.2.6 lidhjen ndërmjet ndryshimeve energjetike dhe reaksioneve kimike dhe proceseve fizike;
- 4.2.7 energjinë e lirë dhe reaksionet kimike spontane.

#### **Standardi 5: KIMIA ORGANIKE DHE BIODIMIA**

##### **5.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesit e kimisë zotërojnë një kuptim të gjerë dhe tërësor të kimisë organike dhe biokimisë.

##### **5.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi zotëron:

- 5.2.1 karakteristikat e lidhjeve kimike të atomit të karbonit, duke përfshirë lidhjet njëfishe, lidhjet shumëfishe dhe hibridizimin;
- 5.2.2 përbërjen, strukturën dhe vetitë e komponimeve organike;



- 5.2.3** emërtimin e komponimeve organike dhe grupeve funksionore;
- 5.2.4** llojet kryesore të reaksioneve organike dhe reaktantët dhe produktet e reaksioneve më të përgjithshme organike;
- 5.2.5** frymëmarrjen qelizore, fermentimin, fotosintezën dhe proceset kryesore anabolike dhe katabolike;
- 5.2.6** strukturën dhe vetitë e acideve nukleike, aminoacideve, proteinave, karbohidrateve, lipideve, polimereve dhe rolin e tyre në proceset biokimike.

## **3.4 Standardet profesionale të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”**

### **Përshkrimi përmbledhës**

Standardet e zhvillimit profesional të mësuesve të fushës “Shoqëria dhe mjedisi” përfaqësojnë kompetencat bazë profesionale që duhet të zotërojnë mësuesit e lëndëve të kësaj fushe (Qytetari, Histori, Gjeografi, Sociologji, Psikologji, Filozofi), të cilat u krijojnë mundësi të arrijnë nivelet më të larta të aftësive profesionale. Këto standarde përfaqësojnë një konsensus profesional; raport të drejtpërdrejtë me to do të ketë mësuesi i lëndës si përdoruesi kryesor i tyre.

Në këtë dokument janë theksuar ato standarde që e veçojnë mësuesin e secilës lëndë nga ai i lëndëve të tjera. Kjo do të thotë që këto standarde i bashkëngjiten standardeve të përgjithshme të mësuesve duke e plotësuar sferën e kompetencave profesionale që duhet të zotërojnë mësuesit.

Standardet e zhvillimit profesional të mësuesve të shkencave shoqërore synojnë:

- të përcaktojnë kompetencat profesionale bazë që duhet të përmbushen nga mësuesit e lëndëve Qytetari, Histori, Gjeografi, Sociologji, Psikologji, Filozofi gjatë gjithë karrierës së tyre profesionale;
- të ndihmojnë mësuesit në identifikimin e nevojave për zhvillimin e tyre profesional; përmes tyre mësuesit identifikojnë fushat në të cilat ata janë të aftë, si dhe fushat që duhet të zotërojnë më tej.

Të informojnë dhe të nxisin hartuesit e programeve të trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve, të ndërtojnë dhe realizojnë programe që nxisin zhvillimin profesional dhe ndërmarrjen e veprimtarive konkrete.

### **3.4.1 Standardet profesionale të mësuesit të Shkencave Sociale<sup>9</sup>**

#### **3.4.1.1 Standardet profesionale të mësuesit të qytetarisë, sociologjisë dhe ekonomisë**

### **Përshkrim përmbledhës**

---

<sup>9</sup> Standardet e mësuesit të Shkencave Sociale (lënda Psikologji, Filozofi, Sociologji dhe Ekonomi) i referohen mësuesit të arsimit të mesëm të lartë.

Qytetaria përmbledh në vetvete një tërësi konceptesh ose vlerash themelore që janë të përbashkëta për të gjithë demokracitë moderne. Të kuptuarit ashtu siç duhet i këtyre koncepteve, i vlerave dhe i marrëdhënieve të tyre në kushtet e ndryshimeve të shpejta, si dhe i rreziqeve që bartin, është kushti paraprak për një pjesëmarrje të efektshme dhe të përgjegjshme të qytetarëve në procesin e rindërtimit demokratik.

Standardet e mësuesit të qytetarisë përmbajnë **njohuri, aftësi, shprehi e qëndrime**, të cilat janë të domosdoshme për mësuesin si qytetar dhe për mësuesin si mësues, si dhe ka marrë përsipër të mundësojë realizimin e kurrikulës së lëndës së qytetarisë në arsimin parauniversitar.

### **Cilat janë disa nga kompetencat e mësuesit, si një ndër aktorët kryesorë në procesin e edukimit për qytetarinë demokratike?**

Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin disa aftësi të mësuesit që janë të rëndësishme për procesin e aftësimit të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tija;
- aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuar nga kurrikula e fshehtë.

Aftësitë më të rëndësishme dhe ndoshta vendimtare të mësuesve, të nevojshme për krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi ndërveprues të mësuarit në shkollë janë:

- *të menduarit kritik*: aftësia për të kërkuar, për të analizuar dhe për të zgjedhur informacione, duke shfrytëzuar njohuritë ndërlëndore, aftësitë e shumëfishta dhe qëndrimin kritik; aftësia për të marrë vendime mbi bazën e të dhënave dhe për të ndryshuar qëndrimet si rrjedhojë e argumenteve të vlefshme;
- *të menduarit krijues*: aftësia për të zbuluar mënyra të reja dhe të pazakonta për të grupuar faktet në kuadrin e një procesi vendimmarrjeje, që shmang në maksimum përgjithësimet e tepruara, paragjykimet dhe stereotipat;

- *të menduarit e prirur drejt sjelljeve shoqërore dhe shoqërisë*: aftësia për të analizuar faktet dhe problemet dhe për të bërë zgjedhje në interes të nevojave të tjerëve dhe të shoqërisë në tërësi, duke luftuar egocentrizmin dhe etnocentrizmin; aftësia për të komunikuar me të tjerët dhe për të mësuar nga përvojat e ndryshme;
- *të menduarit e drejtuar nga e ardhmja*: aftësia për të identifikuar dhe kuptuar problemet dhe për të vlerësuar vendimet në dritën e përvojave, me qëllim që e ardhmja e synuar të jetë më e drejtë.

## Standard 1: KULTURA

### 1.1. Përshkrimi i standardit

Mësuesit kuptojnë dhe përdorin konceptet komplekse kulturore për të shpjeguar funksionimin e kulturës dhe të sistemeve kulturore.

### 1.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 1.2.1. analizon dhe shpjegon mënyrat në të cilat grupet shoqëritë dhe kulturat trajtojnë nevojat dhe interesat njerëzore;
- 1.2.2. parashikon se si mund të interpretohen përvojat dhe të dhënat nga njerëz dhe këndvështrime të ndryshme kulturore dhe sisteme të ndryshme referimi;
- 1.2.3. analizon modelet shoqërore për ruajtjen dhe transmetimin e kulturave, krahas përshtatjes së tyre ndaj ndryshimeve mjedisore dhe shoqërore;
- 1.2.4. interpreton modelet e sjelljeve që reflektojnë vlerat dhe qëndrimet që ndihmojnë ose pengojnë mirëkuptimin ndërkulturor
- 1.2.5. argumenton vlerën e diversitetit kulturor, si dhe të kohezionit brenda dhe ndërmjet grupeve;
- 1.2.6. parashikon reagime të mundshme të kulturave ndaj çështjeve njerëzore;
- 1.2.7. shpjegon dhe zbaton ide, teori dhe mënyra e kërkimit në shqyrtimin e çështjeve të problemeve shoqërore;
- 1.2.8. analizon dhe interpreton këndvështrimet e ndryshme aktuale dhe historike brenda një kulture dhe ndërmjet kulturave për çështje të ndryshme shoqërore;
- 1.2.9. shpjegon lidhjet e tyre personale me sistemet shoqërore dhe kulturore në kohë dhe hapësirë;
- 1.2.10. vlerëson ndikimet që kulturat e ndryshme historike dhe bashkëkohore kanë në jetën e përditshme të individit;
- 1.2.11. shqyrton ndërveprimin e ndikimeve kulturore, kombëtare dhe etnike në ngjarje dhe situata të veçanta jetësore;
- 1.2.12. krahason dhe vlerëson ndikimin e stereotipave, konformizmit, altruizmit dhe sjelljeve të tjera tek individët dhe grupet.

## Standard 2: KOHA, VAZHDIMËSIA, NDRYSHIMI

### **2.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesit angazhohen në analizat historike dhe rindërtimin e së kaluarës, duke shqyrtuar marrëdhëniet e saj me të tashmen dhe të ardhmen e mundshme. Ata janë të aftë të lidhin përvojat, njerëzit dhe ngjarjet e veçanta me konceptin e përgjithshëm të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në kohë dhe në hapësirë. Mësuesit nxjerrin përfundime nga njohuritë e tyre historike për të bërë zgjedhjet dhe për të marrë vendimet e tyre në të tashmen.

### **2.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 2.2.1.** shpjegon që njohuritë historike dhe koncepti i kohës janë produkte shoqërore dhe ndikojnë në zgjedhjet që njerëzit u bëjnë çështjeve që duan t'u përgjigjen dhe në faktet që përdorin për to;
- 2.2.2.** analizon dhe shpjegon lidhjet ndërmjet modeleve të ndryshimit dhe të vazhdimësisë historike, duke zbatuar koncepte të tilla si koha, kronologjia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti;
- 2.2.3.** analizon modele ndryshimi kulturore dhe ndërkulturore si zhvillimi i kulturave dhe civilizimeve të ndryshme, formimin e qyteteve dhe të ndryshimeve (edhe të revolucioneve) ekonomike, shoqërore dhe politike);
- 2.2.4.** përdor në *mënyrë sistematike* proceset e hulumtimit kritik për të shpjeguar, interpretuar ngjarjet historike, çështjet e diskutueshme, duke përdorur burime të ndryshme informacioni dhe të dhënash dhe duke kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme besueshmërinë e tyre;
- 2.2.5.** hulumton, interpreton dhe analizon këndvështrimet e ndryshme historike dhe aktuale brenda dhe ndërmjet kulturave që lidhen me çështje të rëndësishme shoqërore, duke dyshuar e në të njëjtën kohë gjykuar në mënyrë kritike;
- 2.2.6.** zbaton në *mënyrë sistematike* ide, teori dhe mënyra të hulumtimit historik për të analizuar zhvillimet historike dhe bashkëkohore dhe për të informuar për të vlerësuar veprimet që lidhen me çështjet publike.

## **Standard 3: KOHA, VAZHDIMËSIA, NDRYSHIMI**

### **3.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesit duhet të jenë të aftë të zbatojnë të kuptuarin e tyre mjedisor në një gamë të gjerë fushash, përfshi artet, shkencat, dhe të gjitha shkencat shoqërore. Konceptet mjedisore bëhen qendër për të mësuarin që lidhet me çështjet globale.

### **3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1.** shpjegon karakterin relativ të vendndodhjes, drejtimit, madhësisë dhe formës përmes përpunimit të hartave mendore të vendeve të botës;
- 3.2.2.** interpreton, zbaton dhe krijon informacione të ndryshme që shprehin botën në përmasa

- dhe aspekte të ndryshme të saj;
- 3.2.3. shpjegon se si mjediset publike dhe private që njerëzit ndërtojnë, pasqyrojnë kulturën, nevojat njerëzore, politikën dhe vlerat dhe idealet e tyre aktuale;
  - 3.2.4. shqyrton, interpreton dhe analizon modelet fizike dhe kulturore dhe bashkëveprimin e tyre;
  - 3.2.5. analizon dhe vlerëson mënyrën se si ngjarjet historike kanë ndikuar dhe janë ndikuar nga faktorët ekonomikë e shoqërorë, rajonalë e globalë;
  - 3.2.6. analizon dhe të vlerëson ndikimet ekonomike dhe shoqërore që shkaktojnë ndryshimet dhe krizat mjedisore;
  - 3.2.7. vlerëson dhe propozon, politika alternative për shfrytëzimin e burimeve të ndryshme në komunitet, shtet, rajon dhe botë.

#### **Standard 4: ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI**

##### **4.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesit duhet të shqyrtojnë zakonet bashkëkohore të sjelljeve humane, duke përdorur metoda nga shkencat e sjelljes për të zbatuar konceptet kyç që burojnë nga psikologjia, psikologjia sociale, sociologjia dhe antropologjia që ata zbatojnë si individë, shoqëri dhe kulturë.

##### **4.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1. analizon lidhjet e tij personale me kohën, hapësirën dhe sistemet social-kulturore;
- 4.2.2. vlerëson ndikimet e kulturave historike dhe bashkëkohore në jetën individuale;
- 4.2.3. shpjegon mënyrat se si familja, feja, gjinia, etnia, kombësia, statusi social-ekonomik faktorë të tjerë kulturore ose të grupeve ndikojnë ndaj zhvillimit të ndjenjës së identitetit personal;
- 4.2.4. zbaton në mënyrë sistematike koncepte, metoda dhe teori për studimin e rritjes dhe zhvillimit njerëzor si: zhvillimi fizik, të nxënit, motivimi, sjellja, perceptimi, dhe personaliteti;
- 4.2.5. analizon ndërveprimin e ndikimeve kulturore, etnike ose kombëtare në dukuri ose situata të veçanta;
- 4.2.6. analizon rolin e perceptimeve, qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve në zhvillimin e identitetit personal;
- 4.2.7. vlerëson ndikimin që ushtrojnë stereotipat, konformizmi, altruizmi dhe sjellje të tjera tek individët dhe grupet;
- 4.2.8. shpjegon faktorët që ndikojnë në zhvillimin ose dëmtimin e shëndetit mendor;
- 4.2.9. analizon çështjet që lidhen me shëndetin mendor dhe çrregullimet e sjelljes në shoqërinë bashkëkohore.

#### **Standard 5: INDIVIDËT, GRUPET DHE INSTITUCIONET**

### **5.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesit duhet të kuptojnë paradigmat ose pikënisjet parimore që qëndrojnë në themel të procesit të krijimit të institucioneve shoqërore dhe politike. Ata duhet të kenë mundësinë të shqyrtojnë, të përdorin njohuritë e shkencave të sjelljes dhe të teorive shoqërore lidhur me mënyrën se njerëzit dhe grupet organizohen për të mirën bindjet dhe interesat e përbashkëta.

### **5.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 5.2.1. zbaton *sistematikisht* koncepte të tilla si roli, statusi dhe klasa shoqërore për të përshkruar lidhjet dhe ndërveprimin e individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri;
- 5.2.2. analizon ndikimin e grupeve dhe institucioneve te njerëzit, ngjarjet dhe elementët e ndryshëm kulturorë në të kaluarën dhe sot;
- 5.2.3. shpjegon zhvillimin e institucioneve në kohë dhe hapësirë;
- 5.2.4. analizon shembuj të kontradiktave ndërmjet shprehjes së individualitetit dhe përpjekjeve që bëhen për të nxitur konformizmin shoqëror nga grupet dhe institucionet;
- 5.2.5. shqyrton sistemet e besimeve që qëndrojnë në themel të traditave dhe ligjeve në shoqërinë e sotme dhe gjatë historisë;
- 5.2.6. vlerëson rolin e institucioneve si në drejtim të trashëgimisë dhe vazhdimësisë ashtu edhe në drejtimin të ndryshimit;
- 5.2.7. analizon shkallën në të cilën grupe dhe institucionet plotësojnë interesat e individëve dhe interesat e përbashkët në shoqërinë e sotme dhe në atë të së kaluarës.

## **Standard 6: PUSHTETI DHE AUTORITETI**

### **6.1.Përshkrimi i standardit**

Nga shqyrtimi i qëllimeve dhe i karakteristikave të sistemeve të ndryshme të qeverisjes, mësuesit ndërtojnë të kuptuarin se si grupet dhe kombet përpiqen të zgjidhin konfliktet dhe të vendosin rregull dhe siguri. Përmes studimit të marrëdhënieve dinamike midis të drejtave dhe përgjegjësiive individuale, nevojave të grupeve sociale dhe koncepteve të një shoqërie të drejtë, mësuesit bëhen problem zgjidhës dhe vendimmarrës më efektivë kur ju drejtohen çështjeve të përhershme dhe problemeve sociale që shtrohen në jetën publike.

### **6.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 6.2.1. shpjegon qëllimin e qeverisjes;
- 6.2.2. analizon rrugën si fitohet, ushtrohet dhe justifikohet pushteti;
- 6.2.3. shpjegon idetë dhe mekanizmin që duhet për plotësimin e nevojave dhe dëshirave të qytetarëve, për të rregulluar territorin, menaxhuar konfliktet, vendosur rendin dhe



- sigurinë dhe balancën e koncepteve për një shoqëri të drejtë;
- 6.2.4.** analizon mënyrën se si kombet dhe organizatat e ndryshme u përgjigjen konflikteve ndërmjet forcës së unitetit dhe të diversitetit;
  - 6.2.5.** krahason sistemet e ndryshme politike (ideologjitë, strukturën, institucionet, proceset dhe kulturat politike) me sistemin shqiptar;
  - 6.2.6.** analizon dhe vlerëson kushtet, veprimet dhe motivimet që ndihmojnë në krijimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet kombeve;
  - 6.2.7.** shpjegon dhe zbaton *sistematikisht* ide, teori dhe mënyra të hulumtimit të shkencave politike për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore.

## **Standard 7: PRODHIMI, SHPËRNDARJA DHE KONSUMI**

### **7.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesit duhet të zhvillojnë këndvështrimet e tyre dhe nivelin e të kuptuarit të koncepteve dhe proceseve themelore ekonomike përmes studimit të sistemeve ekonomike dhe politike, e në mënyrë të veçantë të shqyrtimit të alternativave politikave ekonomike të brendshme dhe globale që lidhen me çështje të tilla si shëndeti, përdorimin e burimeve, papunësinë dhe tregtinë.

### **7.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 7.2.1.** shpjegon pse pamjaftueshmëria e burimeve prodhuese (njerëzore, kapitale, teknologjike dhe natyrore) kërkon zhvillimin e sistemeve ekonomike që marrin vendimet për prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve;
- 7.2.2.** analizon rolin që luajnë kërkesa, oferta, çmimi, shpërblymimi dhe fitimi, kosto etj. në prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve në një sistem konkurrencial tregu; shpjegon marrëdhëniet ndërmjet tyre
- 7.2.3.** shpjegon rëndësinë që ka kosto dhe fitimi për shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve në sektorin privat dhe atë publik;
- 7.2.4.** analizon dhe shpjegon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të ndryshme ekonomike që përbëjnë sistemet ekonomike si prodhimi i vogël (edhe ai familjar), firmat prodhuese, bankat, institucionet qeveritare, sindikatat dhe korporatat;
- 7.2.5.** zbaton *sistematikisht* konceptet dhe arsyetimet ekonomike për vlerësimin e zhvillimeve dhe çështjeve shoqërore aktuale dhe historike;
- 7.2.6.** shpjegon sistemet ekonomike të brendshëm dhe ato globale dhe bashkëveprimin ndërmjet tyre;
- 7.2.7.** zbaton *vazhdimisht* njohuritë për prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin në analizën e çështjeve shoqërore;
- 7.2.8.** harton një plan për plotësimin e kërkesave shoqërore të dëshirueshme që lidhen me to.



## Standard 8: SHKENCA, TEKNOLOGJIA DHE SHOQËRIA

### 8.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesit duhet të argumentojnë që teknologjitë formojnë sisteme dhe si jeta e tyre e përditshme është nën ndikimin e ndërhyrjeve teknologjike; që shkenca dhe teknologjia sjellin ndryshime të tilla që sfidojnë edhe besimet tona, si në rastin e zbulimeve dhe zbatimeve që lidhen me universin, bazat gjenetike të jetës, fizikën atomike dhe të tjera.

### 8.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 8.2.1. historia dhe aktualiteti, shembuj të bashkëveprimit dhe të ndërvarësisë së shkencës, teknologjisë dhe të shoqërisë në mjedise të ndryshme kulturore;
- 8.2.2. gjykon për mënyrën se si shkenca dhe teknologjia kanë transformuar mjedisin fizik dhe shoqërinë njerëzore si dhe mënyrën e të kuptuarit të kohës, hapësirës dhe të bashkëveprimit njerëzor;
- 8.2.3. analizon se si shkenca dhe teknologjia kanë ndikuar dhe ndikojnë në vlerat, bindjet dhe qëndrimet themelore të shoqërisë dhe si si vlerat, bindjet dhe qëndrimet e shoqërisë kanë modeluar ndryshimet shkencore dhe teknologjike;
- 8.2.4. vlerëson politikat e ndryshme që janë propozuar për trajtimin e ndryshimeve shoqërore që kanë qenë rrjedhojë e teknologjive të reja si inxhinieria gjenetike për bimët dhe kafshët;
- 8.2.5. propozon në mënyrë krijuese politika për trajtimin e ndryshimeve shoqërore që kanë qenë rrjedhojë e teknologjive të reja
- 8.2.6. pranon dhe interpreton këndvështrimet e ndryshme për shoqërinë njerëzore dhe botën fizike duke përdorur *vazhdimisht* njohuritë shkencore, standardet etike dhe teknologjitë që vijnë nga kultura të ndryshme botërore;
- 8.2.7. formulon strategji dhe politika zhvillimi për të ndikuar në diskutimet publike për çështje të marrëdhënieve ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë, si për shembull efekti “serrë”.

## Standard 9: LIDHJET GLOBALE

### 9.1.Përshkrimi i standardit

Duke analizuar modelet dhe marrëdhëniet brenda dhe ndërmjet kulturave, të tilla si konkurrenca dhe ndërvarësia ekonomike, armiqësitë e vjetra etnike, aleancat politike dhe ushtarake mësuesi shqyrton alternativat politike që kanë ndikim në nivel kombëtar dhe në nivel global.

### 9.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 9.2.1. shpjegon me shembuj ndërvarësinë globale, lidhjen e të kaluarës, tashmes e të ardhmes dhe ndërvarësinë e sjelljeve dhe veprimeve të individëve me sistemet globale;
- 9.2.2. argumenton me shembuj se këndvështrimet për botën ndryshojnë në varësi të faktorëve të tilla si mosha, besimi, kultura, konteksti gjeografik, gjuha, kombësia, raca etj.;

- 9.2.3. shpjegon me shembuj ndikimin (lehtësues ose jo) e elementëve kulturorë si gjuha, arti, muzika, besimet etj. në mirëkuptimin ose keqkuptimin në nivel global;
- 9.2.4. shpjegon kushtet dhe motivet që ndihmojnë në nivelin e bashkëpunimit, të ndërvarësisë dhe të konflikteve ndërmjet individëve, grupeve ose kombeve;
- 9.2.5. analizon dhe vlerëson ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global;
- 9.2.6. analizon shkaqe, pasoja dhe zgjidhje të mundshme të disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose reja si: shëndeti, sigurimi, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit etj.;
- 9.2.7. analizon marrëdhëniet dhe kontradiktat ndërmjet sovranitetit kombëtar dhe interesave globale në çështje të tilla si territori, zhvillimi ekonomik, armët bërthamore dhe ato në përgjithësi, përdorimi i burimeve natyrore dhe shqetësimet lidhur me të drejtat e njeriut;
- 9.2.8. analizon ose formulon *qartë* deklarata politike që dëshmojnë në praktikë nivelin e të kuptuarit të çështjeve, standardeve dhe konflikteve lidhur me të drejtat e njeriut dhe çështje të tjera globale;
- 9.2.9. vlerëson rolin e organizatave ndërkombëtare dhe ndërshtetërore në nivel global;
- 9.2.10. analizon dhe parashikon ndikimin e mundshëm të veprimeve individuale dhe kolektive në të tashmen dhe ta ardhmen globale.

## Standard 10: IDEALET DHE PRAKTIKAT E QYTETARISË

### 10.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesit duhet të njihen me pikëpamjet ose praktikat e qytetarisë në kohë ose vende të tjera, duke bërë të tyren idenë e ndryshimit në kohë dhe hapësirë të qytetarisë. Ata analizojnë marrëdhëniet ndërmjet idealeve dhe praktikës së qytetarisë dhe janë të vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre qytetare, aftësohen të dallojnë nevojat e shoqërisë dhe të veprojnë për të mirën e përgjithshme dhe dinjitetin personal.

### 10.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 10.2.1. shpjegon origjinën dhe interpreton ndikimin e vazhdueshëm të idealeve themelore demokratike si dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës në jetën e përditshme
- 10.2.2. analizon, interpreton dhe vlerëson burimet dhe shembujt e të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve;
- 10.2.3. praktikon dhe drejton forma të diskutimit dhe të pjesëmarrjes qytetare në përputhje me idealet e qytetarisë demokratike;
- 10.2.4. analizon dhe vlerëson ndikimin e formave të ndryshme të veprimit qytetar në politikën publike;

- 10.2.5.** analizon larminë e madhe të politikave dhe çështjeve publike nga këndvështrimi i aktorëve të ndryshëm që ndikojnë politikën në kombëtare dhe krijojnë qëndrimin e tij për to;
- 10.2.6.** vlerëson shkallën në të cilën politikat publike dhe sjelljet qytetare pasqyrojnë ose ndihmojnë në formimin e idealeve të shpallura të qytetarisë demokratike;
- 10.2.7.** shpjegon përmbajtjen e të drejtave themelore, kuptimet e ndryshme të konceptit të të drejtave të njeriut dhe burimet e tyre;
- 10.2.8.** shpjegon dhe interpreton vlerat që qëndrojnë në themel të të drejtave të njeriut;
- 10.2.9.** shpjegon lidhjen ndërmjet etapave historike dhe zhvillimit të përmbajtjes së konceptit të të drejtave të njeriut dhe të llojeve të ndryshme të tyre;
- 10.2.10.** interpreton në kontekstin historik dokumentet themelore të të drejtave të njeriut;
- 10.2.11.** interpreton përmbajtjen e ligjit kushtetues shqiptar në përgjithësi dhe liritë dhe të drejtat themelore në veçanti;
- 10.2.12.** analizon dhe vlerëson mbrojtjen e të drejtave të njeriut në dokumentet themelore kombëtare, evropiane dhe botërore;
- 10.2.13.** vlerëson dhe mbron me argumente qëndrime të caktuara për lidhjet ndërmjet llojeve të ndryshme të të drejtave;
- 10.2.14.** vlerëson, mban dhe mbron me argumente qëndrime të caktuara për fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave.

### **3.4.1.2 Standardet profesionale të mësuesit të psikologjisë**

#### **Përshkrim përmbledhës**

Studimi i psikologjisë dhe sjelljes njerëzore lejon nxënësit për të kuptuar teoritë që janë propozuar për të përshkruar të menduarit e njeriut, të mësuarit, kujtesën, zhvillimin, personalitetin dhe sjelljen. Kjo i ndihmon ata për t'iu përgjigjur pyetjeve të adresuara si në vijim: Kush jam unë? Cilët faktorë që kanë kontribuar për të qenë ky që jam? Si mund të përshtatemi, përballemi, përfitojmë, dhe për të kontribuar mirëqenien tonë dhe për mirëqenien e të tjerëve? Si mund të ndikojnë faktorët biologjikë dhe faktorët mjedisor në psikologjinë e njerëzve, gjendjen emocionale sociale, rritjen emocionale, zhvillimin dhe sjelljen? Si mund të kuptohen dallimet individuale? Cilat janë konceptet, qasjet, procedurat dhe parimet e kryerjes së kërkimit psikologjik dhe raportimi rezultateve hulumtimit?

Këto standarde synojnë të aftësojnë mësuesit:

- Të shpjegojnë kompleksitetin e mendimit dhe sjelljes njerëzore, si dhe faktorët që lidhen me dallimet individuale midis njerëzve.
- Të demonstrojnë një kuptim bazë të metodave shkencore të cilat janë në thelb të disiplinës.
- Të zbatojnë njohuritë psikologjike në jetën e tyre të përditshme.
- Të vlerësojnë dallimet individuale .

- Të demonstrojnë një kuptim të çështjeve kulturore dhe të diversitetit në lidhje me sjelljen njerëzore.

## Standardi 1. ZHVILLIMI I PSIKOLOGJISË

### 1.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i psikologjisë di dhe mund të shpjegojë qasjet kryesore teorike, rezultatet e kërkimeve shkencore dhe prirjet historike dhe bashkëkohore në shkencën e psikologjisë.

### 1.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 1.2.1 udhëzon nxënësit rreth qëllimeve të psikologjisë, dhe përshkruan zhvillimin e saj si një shkencë;
- 1.2.2 përshkruan, krahason dhe dallon qasjet kryesore teorike në psikologji (p.sh., të sjelljes, biologjike, njohëse, psiko-analitike dhe sociale);
- 1.2.3 parashtron kontributet e qasjeve kryesore teorike në psikologji (p.sh., të sjelljes, biologjike, njohëse, psiko-analitike dhe sociale).

## Standardi 2. NDIKIMI I BIOLOGJISË NË SHËNDETIN MENDOR

### 2.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi i psikologjisë shpjegon se si pjesët përbërëse të trurit ndikojnë në aftësitë njohëse, humor dhe sjellje. Përshkruan strukturat e trurit, funksionet e tyre, dhe se si truri ka evoluar dhe se si kjo ka ndikuar sjellje. Ndhmon për të kuptuar botën e jashtme, interpretimin e stimujve dhe si ato ndikojnë sjelljen.

### 2.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 2.2.1 zotëron njohuri rreth sistemit nervor dhe sistemit endokrin;
- 2.2.2 shpjegon se si hormonet dhe përgjigjet nervore ndikojnë shëndetin mendor;
- 2.2.3 përshkruan proceset e ndjesisë dhe perceptimit, duke shqyrtuar shqisat e ndryshme që njerëzit posedojnë;
- 2.2.4 ndihmon nxënësit të shqyrtojnë nivelet e vetëdijes
- 2.2.5 shpjegon teoritë në lidhje me funksionin e gjumit dhe ndryshimet e nivelit të vetëdijes (të tilla si meditimi, hipnoza, dhe iluzioni);
- 2.2.6 shqyrton pasojat e drogës në vetëdije dhe pikëpamjet e shoqërisë në lidhje me përdorimin e drogës;
- 2.2.7 paraqet funksionin e gjumit dhe lidhjen e vetëdijes me sjelljen.

## Standardi 3. STADET E ZHVILLIMIT DHE TË MËSUARIT

### **3.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi shpjegon se si të mësuarit ndihmon formimin e mendimeve tona dhe të gjuhës, motivimet tona, emocionet dhe qëndrimet tona, dhe në personalitet.

### **3.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1 komunikon tek nxënësit teoritë e zhvillimit, duke përfshirë aftësitë njohëse, morale, dhe sociale;
- 3.2.2 shpjegon çështjet kryesore në foshnjëri, fëmijëri, adoleshencë dhe moshën e rritur;
- 3.2.3 shqyrton llojet e ndryshimeve sociale, njohëse dhe çështjet emocionale që vijnë me plakjen dhe mënyrat si njerëzit i afrohen vdekjes;
- 3.2.4 përzgjedh informacion të bollshëm në funksion të procesit të të mësuarit përmes kushtëzimit klasik dhe atij operant.

## **Standardi 4. NDIKIMI I KONTEKSTIT SOCIAL-KULTUROR**

### **4.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi jep një pamje më të gjerë për konceptin e vetes, të grupeve dhe të dinamikave të ndryshme që ndikojnë në sjellje.

### **4.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1 ndihmon nxënësit të kuptojnë si mjedisi i tyre social ndikon në mënyrën se si ata mendojnë;
- 4.2.2 identifikon marrëdhëniet ndërmjet qëndrimeve dhe sjelljeve dhe demonstroi si teknikat bindëse ndikojnë në sjellje;
- 4.2.3 diskuton se si prania e njerëzve të tjerë ndikon në sjelljen e individëve dhe se si dinamika e grupit të ndikon në sjelljen personale (dhe anasjelltas);
- 4.2.4 nxit dhe mbështet nxënësit të diskutojnë sjelljen pro-sociale, antisociale dhe të mësojnë në lidhje me teoritë e tërheqjes dhe të marrëdhënieve intime;
- 4.2.5 drejton nxënësit në shqyrtimin e natyrës dhe të pasojave të stereotipave dhe paragjyqimeve dhe në eksplorimin e koncepteve që lidhen me diversitetin kulturor;
- 4.2.6 zotëron njohuri në lidhje me racën, gjininë, statusin socio-ekonomik dhe orientimin seksual dhe si këta faktorë kanë lidhen dhe ndikojnë me/në identitetin personal.

## **Standardi 5. PROCESET MENDORE DHE NDIKIMI NË SJELLJE**

### **.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesi ndihmon nxënësit për të lidhur konceptet dhe idetë e përvetësuara dhe si ato ndikojnë në procesin e njohjes, të zhvillimit gjuhësor dhe të kujtesës.

### **.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- .2.1 një shpjegon konceptet dhe teoritë në lidhje me kujtesën, të menduarit dhe

- inteligjencën;
- .2.2 shpjegon llojet e ndryshme të kujtesës, çrregullimet e kujtesës dhe mënyrat e duhura për ta përmirësuar atë;
  - .2.3 interpreton të menduarit dhe ndihmon nxënësit të mësojnë në lidhje me proceset njohëse të përfshira në kuptimin e informacionit, për mënyrën si informacioni organizohet në mendime dhe se si ai funksionon në zgjidhjen e problemeve;
  - .2.4 shqyrton përkufizime të ndryshme të inteligjencës dhe diskuton ndikimet e biologjisë dhe kulturës mbi inteligjencën.

## Standardi 6. NDRYSHIMI INDIVIDUAL

### 6.1 Përshkrimi i standardit

Përshkruan se si motivimi ndikon drejtpërdrejt në sjellje, dhe se si stresi ndikon në gjendjen shëndetësore. Ndihmon nxënësit që me njohurit e mara në njësitë e mëparshme t'i përgjigjen pyetjeve që mund të japin atyre njohuri për veten e tyre dhe botën rreth tyre.

### 6.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 6.2.1 shpjegon dallimet e mëdha mes individëve në lidhje me motivimin, emocionin dhe personalitetin;
- 6.2.2 shpjegon teori të ndryshme në lidhje me motivimin nga faktorët biologjikë, njohës dhe këndvështrimin humanist; shqyrton disa fusha specifike të motiveve të njeriut në sjellje, duke përfshirë ushqimin, arritjet dhe orientimin seksual;
- 6.2.3 shpjegon këndvështrimet e ndryshme në lidhje me emocionet, si dhe për lidhjet dhe ndikimet biologjike dhe kulturore mbi emocion;
- 6.2.4 interpreton lidhjet me teoritë e ndryshme të personalitetit dhe eksploron çështjet e stabilitetit dhe ndryshimit, individualizmit dhe kolektivizmit dhe të konceptit për veten;
- 6.2.5 përcjell tek nxënësit konceptin e çrregullimeve psikologjike dhe klasifikimin e tyre, sfidat në lidhje me diagnozën e çrregullimeve dhe si çrregullimet psikologjike funksionojnë si një koncept shoqëror.

## Standardi 7. ZBATIME TË PSIKOLOGJISË

### 7.1 Përshkrimi i standardit

Ndihmon nxënësit të përdorin njohuritë e tyre për të identifikuar sjelljet dhe mënyrën e trajtimit të sëmundjeve mendore. Mësuesi i psikologjisë zbaton qasjet kryesore teorike në psikologji për çështjet arsimore, emocionale, etike, motivuese, organizative, personale, sociale dhe bazuar në realitet

### 7.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 7.2.1 paraqet konceptin e shëndetit mendor dhe të stresit si një reagim psikologjik;
- 7.2.2 shpjegon strategji të ndryshme përballuese të stresit, rreth sjelljeve dhe qëndrimeve të tjera që promovojnë shëndetin e mirë;



- 7.2.3 përshkruan trajtimin e sëmundjes mendore;
- 7.2.4 ofron njohuri në lidhje me mundësitë e karrierës për psikologët.
- 7.2.5 sugjeron zgjidhje etike të problemeve psikologjike aktuale, duke përfshirë problemet e hasura në arsim, biznesit, industrisë dhe mjedisit;
- 7.2.6 shpjegon shkaqet të ndryshme dhe trajtimet etike për sjellje jonormale;
- 7.2.7 përfshin dhe përdor njohuri dhe gjetjet kërkimore në lidhje me motivimin dhe emocionin e njeriut për të rritur efektshmërinë e procesit të të mësuarit;
- 7.2.8 shpërndan çështjet e diversitetit individual në të gjithë kurrikulën psikologjisë, dhe demonstroi njohuri mbi dallimet socio-kulturore dhe ndikimet e tyre në sjellje.

### 3.4.1.3 Standardet profesionale të mësuesit të filozofisë

#### Përshkrimi përmbledhës

Standardet e lëndës së filozofisë i shërbejnë zhvillimit të aftësive intelektuale, të rëndësishme për jetën në tërësi, përtej njohurive dhe aftësive që kërkohen në profesione ose në fusha të veçantë të veprimtarisë njerëzore . Ato zhvillojnë aftësitë analitike kritike dhe interpretuese që zbatohen dhe janë të domosdoshme në çdo fushë lëndore dhe kontekst jetësor, zhvillojnë aftësinë dhe prirjen për refleksion dhe vetëshprehje, për të shkëmbyer idetë dhe për të debatuar rreth tyre, për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Arritja e standardeve të filozofisë krijon mundësitë për rritjen e pushtetit intelektual dhe për të përballuar ndryshimet e shpejta e të vazhdueshme që karakterizojnë sot veprimin dhe mendimin njerëzor.

Mësuesi i filozofisë duhet të ketë:

- Aftësinë për të zgjidhur probleme, mbi bazën e analizës së koncepteve, të përcaktimeve, të argumenteve e të sintezës së larmisë së këndvështrimeve në një të tërë të vetme. Ajo ofron mundësitë për krijimin e aftësisë për të organizuar idetë dhe çështjet e ndryshme, për të dalluar dhe për të përzgjedhur atë që është thelbësore në sasinë e shumtë të informacionit me të cilin ndeshemi.
- Aftësinë për të komunikuar idetë, duke ofruar mjetet kryesore të vetëshprehjes, si aftësinë për të paraqitur ide duke përdorur argumente të strukturuar mirë dhe sistematikë.
- Aftësinë për të shprehur e mbrojtur një qëndrim të caktuar me argumente. Ajo synon të ndihmojë në zhvillimin e aftësisë për të ndërtuar e për të mbrojtur një pikëpamje, për të vlerësuar e për të mbajtur parasysh argumentet dhe pikëpamjet e ndryshme dhe të kundërta, aftësinë për të përzgjedhur dhe për të justifikuar zgjedhjen e një alternative.
- Aftësinë për të formuluar hipoteza, për të bërë hulumtime, për të parashtruar probleme në mënyrë që të mundësohet zgjidhja e tyre.
- Aftësinë e kërkimit, të kuptimit dhe të përballimit të të gjitha problemeve të rëndësishme të jetës.



- Aftësinë për të kuptuar lidhjen e filozofisë me dijet dhe aktivitetet e tjera njerëzore, duke përdorur metodologjinë e përshtatshme për trajtimin e çështjeve filozofike, në situata të ndryshme.
- Aftësitë e pjesëmarrjes qytetare për të zgjidhur në praktikë probleme të ndryshme jetësore filozofike.
- Aftësinë për të zgjedhur një qëndrim të caktuar filozofik e moral në funksion të angazhimit të tij në jetën shoqërore.

## Standard 1: NJOHURITË FILOZOFIKE

### 1.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi duhet të zotërojë njohuritë e duhura filozofike, në mënyrë që të jetë i aftë të lehtësojë mësimdhënien e lëndës së filozofisë në shkollë, dhe të ndërtojë qëndrimet e tij mbi bazën e argumenteve që mbështeten në njohuri të qëndrueshme.

### 1.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 1.2.1 përshkruan zhvillimin evoluimin e mendimit filozofik, sipas periudhave historike;
- 1.2.2 dallon periudhat kryesore të zhvillimit të mendimit filozofik;
- 1.2.3 përshkruan karakteristikat kryesore të periudhës që lidhen me zhvillimin e filozofisë.
- 1.2.4 përshkruan historinë e mendimit filozofik përmes përfaqësuesve të saj;
- 1.2.5 dallon lidhjen e koncepteve dhe problemeve kryesore të filozofisë me periudhat kryesore të mendimit filozofik në shekuj etj;
- 1.2.6 argumenton lidhjen e pikëpamjeve filozofike me pikëpamjet dhe arritjet e shkencave të natyrës dhe shoqërore;
- 1.2.7 dallon pikëpamjet e kundërta ose të ndryshme në historinë e mendimit filozofik;
- 1.2.8 analizon dallimet dhe pikat e përbashkëta në pikëpamjet e ndryshme filozofike etj.

## Standard 2: HISTORICIZMI DHE LIDHJA E KUSHTËZIMI RECIPROK

### 2.1 Përshkrimi i standardit

Mësuesi duhet të vlerësojë rrymat, mendimin dhe pikëpamjet filozofike, historike etj., në kohë dhe në hapësirë.

### 2.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 2.2.1 dallon tiparet thelbësore të periudhës historike të cilës i përket një pikëpamje ose qëndrim filozofik;
- 2.2.2 shpjegon lidhjen e një rryme, të një pikëpamjeje ose të një qëndrimi filozofik me faktorë historikë (ekonomikë, shoqërore, politikë, kulturorë, fetarë etj.);
- 2.2.3 analizon kufizimet ose vlerat e filozofëve, të mendimtarëve, të historianëve etj;
- 2.2.4 vlerëson kufizimet ose vlerat e filozofëve, të mendimtarëve, të historianëve etj; në

- kohë dhe në hapësirë;
- 2.2.5** tregon rolin e filozofisë në përparimin e fushave ose aspekteve të ndryshme të jetës shoqërore e shkencore;
- 2.2.6** argumenton rëndësinë e të kuptuarit filozofik dhe të zgjidhjeve filozofike në fusha e aspekte të ndryshme shoqërore dhe shkencore;
- 2.2.7** përshkruan mendimin filozofik në Shqipëri në periudha të ndryshme historike;
- 2.2.8** shpjegon ndikimin e mendimit të përparuar botëror në mendimin filozofik në Shqipëri në periudha të ndryshme historike.

### **Standard 3: NDRYSHIMI DHE VAZHDIMËSIA**

#### **3.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesit duhet të kuptojë procesin e ndryshimit dhe të vazhdimësisë së mendimit filozofik dhe të shpjegojë arsyen e ndryshimit dhe vazhdimësisë.

#### **3.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1** dallon ndryshimet dhe vazhdimësinë historike në zhvillimin e historisë së mendimit filozofik;
- 3.2.2** tregon si këto kanë ndikuar ndryshimet ose ngjashmëritë historike në zhvillimin, ndryshimin ose vazhdimësinë e pikëpamjeve filozofike;
- 3.2.3** dallon tiparet kryesore të shoqërisë së sotme;
- 3.2.4** argumenton vazhdimësinë e mendimit filozofik.

### **Standardi 4: KRIJIMI I MENDIMI TË PAVARUR**

#### **4.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesit duhet të jetë në gjendje të krijojë dhe të respektojë mendimin e tij të pavarur.

#### **4.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1** dallon ndryshimet që ekzistojnë në mendimin filozofik
- 4.2.2** shpjegon pse njerëz të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme;
- 4.2.3** dallon lidhjen e pikëpamjeve të ndryshme me interesa të ndryshme ekonomike, politike, fetare etj.;
- 4.2.4** shpjegon lidhjen e pikëpamjeve të ndryshme me interesa të ndryshme ekonomike, politike, fetare etj.;
- 4.2.5** formulon pikëpamjen e tij.;
- 4.2.6** argumenton pse të tjerët duhet të pranojnë mendimin e tij filozofik.

### **Standardi 5: RESPEKTIMI I DIVERSITETIT**

### **5.1 Përshkrimi i standardit**

Mësuesit duhet të jetë në gjendje të krijojë dhe të respektojë mendimin e tij të pavarur.

### **5.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 5.2.1 dallon vlerat pozitive edhe në rrymat filozofike, mendimet e pikëpamjet me të cilat nuk është dakord;
- 5.2.2 argumenton që çdo mendim, pra edhe mendimi i tij është i kufizuar nga koha dhe vendi, nga interesat, arsimimi, përkatësia ekonomike, shoqërore etj;
- 5.2.3 tregon pse të tjerët duhet të pranojnë mendimin e tij filozofik, për të kuptuar pse ai duhet të pranojë pikëpamjet e të tjerëve;
- 5.2.4 pranon mendimin e tij dhe të tjetrit si mendime plotësuese në tablonë e përgjithshme të mendimit njerëzor të epokës.

### **3.4.2 Standardet profesionale të mësuesit të historisë**

Standardet profesionale të mësuesit të historisë grupohen në 11 standarde, ku secili prej tyre ka rëndësi specifike dhe peshë të veçantë në formimin dhe zhvillimin profesional të mësuesit. Këto standarde duhet të përmbushen nga çdo mësues i historisë për të ushtruar këtë profesion në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar.

Të gjithë mësuesit e historisë për të qenë të suksesshëm në klasë duhet të demonstrojnë kompetenca si për standardet e përgjithshme profesionale dhe standardet e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, ashtu edhe për standardet specifike lëndore të cilat u krijojnë mundësi të arrijnë nivelet më të larta të aftësive profesionale.

### **Standardi 1: HISTORIA E QYTETËRIMEVE BOTËRORE**

#### **1.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i historisë zotëron njohuri dhe demonstroi aftësi dhe qëndrime për historinë e shqiptarëve dhe për historinë e qytetërimit botëror në parahistori dhe gjatë periudhave historike, në mënyrë që të argumentojë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvarësinë ndërmjet qytetërimeve.

#### **1.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 1.2.1 zotëron një të kuptuar konceptual të evolucionit të shoqërisë njerëzore nga epoka parahistorike në epokën historike;
- 1.2.2 zotëron dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, për zhvillimin e qytetërimeve antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në vend, në rajon dhe në botë;
- 1.2.3 argumenton etapat kryesore, nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i shoqërisë botërore në

- periudhën antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore;
- 1.2.4** analizon mënyrat e jetesës, botën materiale, mënyrën e organizmit ekonomik, politik dhe kulturor, si dhe botën shpirtërore të qytetërimeve botërore, për të kuptuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve dhe vazhdimësinë e tyre në të ardhmen;
- 1.2.5** vlerëson rolin e arritjeve të qytetërimeve në jetën e sotme;
- 1.2.6** argumenton kalimin nga qytetërimet në lashtësi në qytetërimet mesjetare, moderne dhe bashkëkohore, duke dalluar lidhjen, ndryshimin dhe vazhdimësinë ndërmjet këtyre qytetërimeve;
- 1.2.7** gjykon natyrën dhe shkaqet e konflikteve, si dhe rrugët e bashkëpunimit ndërmjet vendeve dhe popujve, si faktorë me ndikim në çështjet kombëtare, etnike, racore, kulturore apo fetare, duke përfshirë ndikimin e këtyre faktorëve në dy Luftërat Botërore, Holokaustin dhe rolin e institucioneve ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve;
- 1.2.8** zotëron dijet dhe kompetencat e nevojshme historike për të kuptuar të tashmen dhe ndikimin e saj në zhvillimet historike të së ardhmes;
- 1.2.9** gjykon mbi lidhjen dhe perspektivën e zhvillimit të qytetërimeve të sotme dhe prirjet e tyre në të ardhmen;
- 1.2.10** përdor burime historike për studimin dhe interpretimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;
- 1.2.11** interpreton efektin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- 1.2.12** argumenton se si dhe pse ngjarje dhe çështje të veçanta historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;
- 1.2.13** zotëron aftësi për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështje të ndjeshme historike;
- 1.2.14** zotëron aftësi për të shpjeguar, për të organizuar dhe për të komunikuar dijet historike përmes mënyrave të ndryshme dhe përdorimit të medieve të ndryshme.

## **Standardi 2: HISTORIA E SHQIPTARËVE**

### **2.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i historisë zotëron njohuri dhe demonstroi aftësi dhe qëndrime për historinë e shqiptarëve dhe për historinë e qytetërimit botëror në parahistori dhe gjatë periudhave historike, në mënyrë që të argumentojë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvarësinë ndërmjet qytetërimeve.

### **2.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 2.2.1.** zotëron një të kuptuar konceptual të historisë së shqiptarëve nga periudha parahistorike deri në ditët tona;
- 2.2.2.** inkadron historinë e shqiptarëve brenda periudhave historike të qytetërimeve botërore,

- duke gjykuar për jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvarësinë ndërmjet qytetërimeve;
- 2.2.3. vlerëson pozitën e qytetërimit shqiptar brenda qytetërimit botëror;
  - 2.2.4. argumenton vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;
  - 2.2.5. analizon ligjësitë themelore të organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të shoqërisë shqiptare;
  - 2.2.6. argumenton ngjarjet dhe personalitetet që i dhanë tiparet kryesore, përsheptuan dhe thelluan proceset politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në periudha të ndryshme historike të popullit shqiptar;
  - 2.2.7. vlerëson ndikimin e ndërsjellë të kulturave dhe të ngjarjeve historike të popullit shqiptar me ato të popujve të tjerë rajonalë dhe më tej;
  - 2.2.8. gjykon mbi realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin për të argumentuar lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes;
  - 2.2.9. eksploron marrëdhëniet mes të kaluarës dhe të tashmes për të argumentuar që idetë, vlerat, besimet rrjedhin nga një proces ndryshimi dhe ndërveprimi të vazhdueshëm;
  - 2.2.10. vlerëson diversitetin kulturor dhe argumenton faktin se kulturat janë gjithmonë në ndryshim, si rezultat i kontaktit me kulturat e tjera;
  - 2.2.11. përdor burimet historike, muzetë, galeritë, arkivat dhe vendet historike për të gjeneruar ide dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve rreth të shkuarës, si dhe për të interpretuar ngjarjet historike;
  - 2.2.12. përdor TIK-un për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet.

### **Standardi 3: KUPTIMI KRONOLOGJIK**

#### **3.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i historisë zotëron njohuri dhe demonstroi aftësi dhe qëndrime për ndërtimin dhe shpjegimin e ngjarjeve historike, ç'ka përfshin përdorimin e saktë të datave për të krijuar vijimësinë e ngjarjeve, duke përdorur termat dhe fjalorin e saktë kronologjik për historinë e shqiptarëve dhe historinë e qytetërimeve botërore në periudha të ndryshme historike.

#### **3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1. demonstroi organizimin kronologjik të historisë dhe vendos njerëzit dhe ngjarjet në periudhën e saktë historike (parahistorike, antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore);
- 3.2.2. kryen saktë veprime për llogaritjen e kohës;
- 3.2.3. ndërton linjën e kohës duke vendosur në të, figurat dhe ngjarjet e rëndësishme historike, si për historinë e shqiptarëve dhe për historinë e qytetërimeve botërore sipas periudhave historike;

- 3.2.4.** përdor saktë datat dhe fjalorin e duhur historik për historinë e shqiptarëve dhe historinë e qytetërimeve botërore, duke analizuar marrëdhëniet historike në periudha të ndryshme historike;
- 3.2.5.** argumenton ndryshimet brenda dhe gjatë periudhave, duke bërë lidhjet midis tyre.

#### **Standardi 4: NDRYSHIMI DHE VAZHDIMËSIA**

##### **4.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i historisë zotëron njohuri dhe demonstroi aftësi dhe qëndrime për identifikimin dhe shpjegimin e ndryshimit dhe të vazhdimësisë brenda dhe përgjatë periudhave historike, si dhe me kuptimin e temave dhe çështjeve gjithëpërfshirëse të periudhave historike.

##### **4.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1.** argumenton ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike brenda dhe përtej periudhave historike (parahistorike, antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore) për historinë e shqiptarëve dhe historinë e qytetërimeve botërore;
- 4.2.2.** vlerëson shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po, për kë ngjarje dhe periudhë historike;
- 4.2.3.** gjykon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, e situatave dhe e ndryshimeve historike për periudhën parahistorike, antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore, si për historinë e qytetërimit botëror ashtu edhe për historinë e shqiptarëve;
- 4.2.4.** argumenton veçoritë e prirejeve historike sipas periudhave (parahistorike, antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore), të cilat sollën progresin e shoqërisë në shkallë kombëtare, evropiane dhe botërore.

#### **Standardi 5: SHUMËLLOJSHMËRIA KULTURORE, ETNIKE DHE FETARE**

##### **5.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i historisë zotëron njohuri dhe demonstroi aftësi dhe qëndrime për të vlerësuar përvojat, idetë, besimet dhe vlerat e ndryshme të njerëzve dhe të shoqërive në të shkuarën dhe për të argumentuar se si të gjitha këto kanë formësuar botën.

##### **5.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 5.2.1.** argumenton se shumëllojshmëria ekziston brenda dhe ndërmjet grupeve për shkak të dallimeve kulturore, etnike, rajonale, gjuhësore, sociale, ekonomike, teknologjike, politike dhe fetare;
- 5.2.2.** vlerëson shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare të shoqërive të ndryshme

nëpërmjet njohjes dhe studimit të individëve dhe të grupeve të ndryshme shoqërore, si: të pakicave kombëtare, të shoqërive evropiane dhe të atyre joevropiane.

## **Standardi 6: RËNDËSIA HISTORIKE**

### **6.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i historisë zotëron njohuri dhe demonstroi aftësi dhe qëndrime për vlerësimin e rëndësisë së ngjarjeve/figurave historike duke gjykuar pse dhe si ato kanë ndryshuar me kalimin e kohës.

### **6.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 6.2.1.** identifikon dhe vlerëson kriteret e përdorura për vlerësimin e rëndësisë së një çështjeje, ngjarjeje apo personazhi historik, si dhe vlerëson se si këto kritere dhe vlera janë përdorur në përshkrimet e së shkuarës dhe shpjegimin e së tashmes;
- 6.2.2.** vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve historike që i përkasin periudhave të ndryshme historike në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme si për historinë e shqiptarëve dhe për historinë e qytetërimeve botërore.

## **Standardi 7: KËRKIMI HISTORIK**

### **7.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i historisë zotëron njohuri dhe demonstroi aftësi dhe qëndrime për të kryer kërkime për një ngjarje/çështje të caktuar historike nga historia lokale, historia e vendit të tij apo historia e qytetërimeve botërore në periudha të ndryshme historike.

### **7.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 7.2.1.** kërkon, harton dhe drejton pyetje për çështje/ngjarje/figurë historike, nga historia e shqiptarëve dhe nga historia e qytetërimeve botërore, për periudha të ndryshme historike dhe argumenton se si ato lidhen me një kontekst të gjerë historik;
- 7.2.2.** harton pyetje specifike për periudha të ndryshme historike ose çështje që u përkasin këtyre periudhave, duke bërë testimin e hipotezave;
- 7.2.3.** përcakton një çështje për kërkim, harton dhe drejton pyetje për çështjen/ ngjarjen/ figurën historike, duke përdorur një sërë burimesh historike për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet për ngjarjen /çështjen/ figurën historike për të cilën zhvillohet kërkimi historik;
- 7.2.4.** përdor drejt dhe saktë konceptet historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimin dhe vazhdimësinë në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve, lidhjen shkak-pasojë, ndërveprimin, rëndësinë dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;



**7.2.5.** zotëron aftësi për të vendosur ngjarjet, njerëzit dhe ndryshimet në periudhën e saktë kohore duke bërë lidhjet ndërmjet ngjarjeve kryesore, situatave dhe ndryshimeve për një periudhë të caktuar historike dhe për periudha të ndryshme të shoqërisë.

## **Standardi 8: ANALIZA SHKAK-PASOJË**

### **8.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i historisë zotëron njohuri dhe demonstroi aftësi dhe qëndrime për ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë, gjykon dhe shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike.

### **8.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 8.2.1.** argumenton ngjarjet historike që u përkasin periudhave të ndryshme historike duke bërë lidhjet e tyre shkak-pasojë;
- 8.2.2.** argumenton ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë duke treguar lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, situatave dhe ndryshimeve kryesore, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, për një periudhë të caktuar historike apo për periudha të ndryshme të shoqërisë;
- 8.2.3.** identifikon dhe vlerëson rëndësinë relative të faktorëve të ndryshëm, në analizën e lidhjeve shpjeguese ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve shkakësore, dëshmi dhe interpretimeve;
- 8.2.4.** vlerëson shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare, përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë, rëndësinë dhe perspektivat për ngjarjen/çështjen historike dhe argumenton se kultura e shqiptarëve dhe kulturat e tjera janë pjesë e një procesi historik;
- 8.2.5.** shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike që u përkasin periudhave të ndryshme historike.

## **Standardi 9: PËRDORIMI I BURIMEVE HISTORIKE**

### **9.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i historisë zotëron njohuri dhe demonstroi aftësi dhe qëndrime në përdorimin e burimeve historike për të kuptuar lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, periudhave dhe shoqërive të ndryshme, marrëdhëniet shkak-pasojë, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, duke shpjeguar se qytetërimet e sotme janë një vazhdimësi progresive e qytetërimeve të hershme, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Mësuesi i historisë zotëron njohuri për të identifikuar, shqyrtuar dhe vlerësuar burimet që përdor për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.

### **9.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 9.2.1.** përzgjedh me saktësi informacionin historik, duke shfrytëzuar burimet parësore dhe dytësore për ta interpretuar atë;

- 9.2.2. shpjegon tipet e burimeve historike si një domosdoshmëri në punën e historianit dhe në dhënien e përgjigjeve të argumentuara për ndërtimin e ngjarjes historike;
- 9.2.3. vlerëson historinë gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e nxënësve;
- 9.2.4. identifikon, zgjedh dhe përdor një sërë burimesh historike, duke përfshirë burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik për të argumentuar interpretimin e tij në lidhje me ngjarje apo çështje të caktuara që i përkasin periudhave të ndryshme historike;
- 9.2.5. vlerëson, përdor dhe shfrytëzon një sërë hartash dhe burimesh historike për t'iu përgjigjur pyetjeve, për të strukturuar një shqyrtim, për të zhvilluar hipoteza, për të për zgjedhur faktet, si dhe për të nxjerrë dhe për të interpretuar konkluzionet e tij për një ngjarje të caktuar nga historia e vendit të tij ose historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike;
- 9.2.6. vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre;
- 9.2.7. kërkon dhe përdor burime alternative për ndërtimin e ngjarjes historike duke vlerësuar besueshmërinë e tyre;
- 9.2.8. vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike.

## **Standardi 10: INTERPRETIMI HISTORIK**

### **10.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i historisë zotëron njohuri dhe demonstroi aftësi dhe qëndrime për të analizuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo dukuri të ndryshme historike, shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme dhe vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme. Shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre.

### **10.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 10.2.1. interpreton efektin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- 10.2.2. interpreton historinë e shoqërisë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen;
- 10.2.3. argumenton faktin që interpretimet reflektojnë rrethanat në të cilat ato bëhen, dëshmitë në dispozicion, si dhe synimet e atyre që i bëjnë këto interpretime (p.sh.: shkrimtarë, arkeologë, historianë dhe film krijues);
- 10.2.4. argumenton se si dhe pse ngjarje dhe çështje të veçanta historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;  
interpreton të kaluarën në mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muze etj dhe shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme nëpërmjet një sërë mediesh.

## Standardi 11: SHPJEGIMI DHE KOMUNIKIMI PËR TË KALUARËN

### 11.1.Përshkrimi i standardit

Mësuesi i historisë zotëron njohuri dhe demonstroi aftësi dhe qëndrime për të komunikuar dhe shpjeguar njohuritë historike në mënyra të ndryshme (me shkrim, me gojë, TIK) përmes përdorimit të burimeve të ndryshëm historik, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm dhe të saktë historik.

### 11.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 11.2.1. paraqet shpjegime koherente, të strukturuar dhe të arsyetuara për qytetërimet në periudha të ndryshme historike duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik;
- 11.2.2. komunikon njohuritë historike në mënyra të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik;
- 11.2.3. organizon informacionin, e përshtat atë në audiencën e synuar dhe e përcjell në mënyrë të qartë duke përdorur një gjuhë të thjeshtë për ta bërë mesazhin e tij sa më të lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u interpretuar;
- 11.2.4. përzgjedh mjetet e duhura për t'i vendosur të dhënat në tabela, diagrame dhe grafikë;
- 11.2.5. përzgjedh dhe përdor mjete të përshtatshme për prezantim;
- 11.2.6. prezanton informacionin përmes përdorimit të burimeve duke përdorur me lehtësi fjalorin e përshtatshëm historik;
- 11.2.7. parashtron pyetje që nxisin debat për temën/çështjen e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra përmes formave të ndryshme të komunikimit.

### 3.4.3 Standardet profesionale të mësuesit të gjeografisë

#### Përshkrim përmbledhës

Standardet e zhvillimit profesional të mësuesve të gjeografisë përcaktojnë pritshmërinë e performancës dhe dijet shkencore që u nevojiten këtyre mësuesve për të garantuar një mjedis ndërvetësor të nxëni. Këto standarde përmbajnë njohuri, aftësi, shprehje e qëndrime, të cilat janë të domosdoshme për mësuesin e kësaj lënde si qytetar dhe si mësues.

Mësimdhënia e gjeografisë duhet t'i motivojë nxënësit të jenë të suksesshëm dhe të tërhiqen nga studimi i kësaj lënde. Mësuesi si moderator dhe udhëheqës i procesit të të nxënit të nxënësve, duhet të zotërojë kompetencat e nevojshme për t'i aftësuar nxënësit të zhvillojnë njohje dhe kuptim të vendit ku jetojnë, të vendeve të tjera, njerëzve dhe mënyrës si ata ndërvetësojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë; të edukojë vlerësimin për mjedisin, duke rritur shkallën e përgjegjësisë për kujdesin ndaj planetit; të zhvillojë aftësitë për të përdorur informacionin gjeografik në kryerjen e gjyqimeve dhe marrjen e vendimeve sikurse për të realizuar studimin gjeografik, si p.sh., kërkimin gjeografik, punën me hartën dhe punën në terren.

Këto standarde orientojnë mësuesin për zhvillimin e tij të vazhdueshëm profesional dhe përmbushjen e një mësimdhënieje cilësore dhe efektive.

## **Standardi 1: KËRKIMI GJEOGRAFIK DHE PUNA NË TERREN**

### **1.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i gjeografisë mundëson dhe nxit te nxënësit, të nxënit e gjeografisë përmes kërkimit gjeografik, përdorimit të metodave që e mundësojnë atë dhe vëzhgimeve në terren.

### **1.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 1.2.1. zotëron dhe përdor metodat e kërkimit gjeografik;
- 1.2.2. aftëson nxënësit në përdorimin e metodave të kërkimit gjeografik të tilla si, hetimi, zgjidhja e problemit, marrja e vendimeve etj.;
- 1.2.3. gjykon rreth aftësive kryesore, proceseve dhe vlerave që nxënësit duhet të zhvillojnë për kryerjen në mënyrë etike të kërkimit gjeografik;
- 1.2.4. mbështet nxënësit të ndërmarrin kërkime në terren, të përzgjedhin dhe përdorin mjete dhe teknika të punës në terren, duke respektuar sigurinë.
- 1.2.5. aftëson nxënësit të hulumtojnë çështje gjeografike, të formulojnë dhe drejtojnë pyetje për çështjen gjeografike, të spekulojnë me përgjigjet duke shpjeguar idetë e tyre ose duke formuluar hipoteza;
- 1.2.6. aftëson nxënësit për përcaktimin e marrëdhënieve shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në sistemet natyrore dhe humane në nivel lokal, kombëtar, rajonal e botëror.

## **Standardi 2: KOMUNIKIMI GJEOGRAFIK**

### **2.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i gjeografisë zhvillon dhe nxit të menduarin dhe komunikimin gjeografik të nxënësve.

### **2.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 2.2.1. zhvillon te nxënësit të kuptuarin e proceseve fizike dhe humane, të strukturave dhe modeleve, si dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre në terma të vendit, hapësirës dhe kohës;
- 2.2.2. shfrytëzon lidhjen ndërmjet degëve të ndryshme të gjeografisë, duke siguruar burime të shumta që nxisin zhvillimin e të menduarit gjeografik të nxënësve;
- 2.2.3. mbështet nxënësit për të zhvilluar të menduarin hapësinor dhe të përdorin hartat, imazhet satelitore, teknologjinë, për të përzgjedhur, analizuar, vlerësuar dhe prezantuar informacionin gjeografik;
- 2.2.4. aftëson nxënësit të përdorin hartat mendore për të organizuar informacionin rreth njerëzve, vendeve dhe mjediseve në një kontekst hapësinor;
- 2.2.5. u mundëson nxënësve kontekste të ndryshme përmes të cilave ndërtojnë kuptimin e tyre për konceptet gjeografike dhe përdorimin në situata të ndryshme;
- 2.2.6. përdor situata të jetës së përditshme për të zhvilluar të menduarin gjeografik të

- nxënësve;
- 2.2.7.** integron këndvështrime të ndryshme për të analizuar dhe për të vlerësuar çështje aktuale gjeografike;
- 2.2.8.** nxit dhe zhvillon përdorimin e pyetjeve gjeografike për të mbledhur dhe për të analizuar informacionin gjeografik rreth ngjarjeve gjeografike të së shkuarës, të së tashmes dhe të së ardhmes;
- 2.2.9.** aftëson nxënësit të mbledhin, përzgjedhin dhe regjistrojnë të dhëna gjeografike, duke shfrytëzuar burimet e drejtpërdrejta parësore (intervista, statistika, etj.) dhe dytësore (grafikë, harta, ilustrime, video, CD, internet, etj.);
- 2.2.10.** nxit nxënësit të vlerësojnë burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre;
- 2.2.11.** nxit dhe aftëson nxënësit të komunikojnë (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht, përmes përdorimit të TIK-ut) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

### **Standardi 3: VENDIMARRJA PËR ÇËSHTJE GJEOGRAFIKE**

#### **3.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i gjeografisë zhvillon dhe nxit te nxënësit aftësitë për të marrë vendime për çështje gjeografike dhe për të argumentuar qëndrimin e tij.

#### **3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1.** aftëson nxënësit të kombinojnë të dhëna dhe informacion për të nxjerrë konkluzione, duke marrë në konsideratë impaktin e tyre;
- 3.2.2.** mbështet nxënësit të identifikojnë rrugë të ndryshme të veprimit dhe të parashikojnë pasojat për to;
- 3.2.3.** nxit nxënësit të propozojnë alternativa, strategji apo zgjidhje për çështjen gjeografike dhe të japin argumente për zgjedhjen e preferuar.

### **Standardi 4: PROCESET NATYRORE DHE SHOQËRORE**

#### **4.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i gjeografisë demonstroi përdorimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në lidhje me dukuritë dhe proceset natyrore që kanë ndodhur dhe ndodhin në sistemet natyrore të Tokës, ndërveprimin midis tyre dhe me veprimtarinë njerëzore, si dhe rrjedhojat e këtij ndërveprimi për Tokën.

#### **4.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1.** përdor temat bazë të gjeografisë për të zhvilluar qasje të ndryshme për studimin e Tokës;

- 4.2.2. analizon dinamikat ndërmjet komponentëve të gjeosistemit: atmosferës, hidrosferës, litosferës dhe biosferës;
- 4.2.3. analizon proceset fizike për të identifikuar dhe për të shpjeguar modelet hapësinore në mjedisin fizik;
- 4.2.4. interpreton ndërveprimin e komponentëve të gjeosistemeve me aktivitetin njerëzor dhe rrjedhojat e këtij ndërveprimi;
- 4.2.5. analizon pasojat e proceseve fizike në modelet dhe sistemet e Tokës dhe në mjedisin human;
- 4.2.6. analizon dhe vlerëson karakteristikat e përgjithshme fiziko-gjeografike të mjedisit lokal, rajoneve të Shqipërisë dhe të trevave të tjera shqiptare si dhe rajoneve të ndryshme të botës;
- 4.2.7. interpreton pasojat e ndërveprimeve midis sistemeve fizike dhe humane;
- 4.2.8. respekton ndërvarësinë shoqërore, politike, ekonomike e kulturore në shoqërinë globale, duke vlerësuar njëkohësisht trashëgiminë materiale, kulturore e shpirtërore të tyre.

## **Standardi 5: NDËRVARËSIA NDËRMJET NJERËZVE, VENDEVE, RAJONEVE DHE MJEDISEVE**

### **5.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i gjeografisë zotëron njohuritë për vendet, rajonet, ndërvarësinë midis tyre, sfidat dhe perspektivat e kësaj ndërvarësie. Ai demonstroi përdorimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve rreth kësaj tematike duke nxitur nxënësit të analizojnë e vlerësojnë në mënyrë kritike proceset dhe dukuritë e ndryshme të zhvillimit rajonal dhe perspektivën e tyre. Në këtë mënyrë formohen bazat e domosdoshme gjeografike për të ndërtuar këndvështrimet mbi ngjarjet aktuale rajonale e globale dhe proceset integruese në nivel lokal, rajonal e global.

### **5.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 5.2.1. vlerëson dhe interpreton konceptin e rajonit dhe shpjegon se si rajonet përdoren për të interpretuar kompleksitetin e Tokës;
- 5.2.2. analizon lidhjet dhe ndërveprimet brenda një rajoni dhe ndërmjet rajoneve;
- 5.2.3. analizon rajonizimin gjeografik dhe veçoritë gjeografike të rajoneve e nënrajoneve të Republikës së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare;
- 5.2.4. interpreton rolin e mjedisit fizik në jetën e rajoneve të ndryshme (popullsinë, vendbanimet, ekonominë, turizmin etj.);
- 5.2.5. analizon dhe krahason tiparet fizike dhe humane që i japin vendeve dhe rajoneve karakterin e tyre tipik;
- 5.2.6. shqyrton karakteristikat humane të rajoneve të Shqipërisë dhe të trevave të tjera shqiptare dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre;
- 5.2.7. analizon ndikimin e shoqërisë njerëzore në cilësinë e mjediseve gjeografike të vendit



- tonë dhe në shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- 5.2.8.** përdor rajonet për të analizuar çështje të së shkuarës dhe të së tashmes (p.sh., konfliktet e shkaktuara nga kapërcimi i identiteteve rajonale, i ndikimeve të aleancave rajonale etj.);
- 5.2.9.** interpreton veçoritë dalluese të popullsisë, ekonomisë, traditave kulturore, sistemeve politike të vendeve dhe rajoneve të ndryshme të botës;
- 5.2.10.** shpjegon, përmes analizës së karakteristikave demografike, modelet e shpërndarjes së popullsisë, duke dhënë shkaqet e kësaj shpërndarje;
- 5.2.11.** analizon, në këndvështrimin gjeografik, veçoritë e zhvillimit ekonomik, politik e kulturor të rajoneve e vendeve të ndryshme të botës.

## **Standardi 6: KULTURA**

### **6.1. Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i gjeografisë demonstroi përdorimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve rreth kulturës dhe mozaikut kulturor të vendeve dhe rajoneve të botës, shpërndarjes gjeografike të tij, kompleksitetit kulturor të popujve dhe ndërvarësisë kulturore.

### **6.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 6.2.1.** identifikon karakteristikat kulturore të vendeve dhe rajoneve të ndryshme të botës;
- 6.2.2.** analizon shpërndarjen hapësinore të kulturës në shkallë lokale dhe globale;
- 6.2.3.** interpreton ndikimin e kulturës në tiparet e një rajoni;
- 6.2.4.** shpjegon pse vendet dhe rajonet shërbejnë si simbole për individët dhe shoqërinë;
- 6.2.5.** analizon si perceptime të ndryshme për vendet dhe rajonet reflektojnë ndryshime kulturore;
- 6.2.6.** shpjegon si përvoja të ndryshme në vende të ndryshme mund të interpretohen në mënyra të ndryshme nga grupe të ndryshëm kulturorë;
- 6.2.7.** vlerëson ndërvarësinë kulturore midis vendeve dhe rajoneve, konvergjenat dhe divergjenat kulturore;
- 6.2.8.** shpjegon si proceset kulturore ndikojnë ndërvarësinë dhe bashkëpunimet në nivel rajonal dhe global.

## **Standardi 7: POPULLSIA, SHPËRNDARJA HAPËSINORE DHE PROCESET**

### **MIGRUESE**

#### **7.1. Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i gjeografisë demonstroi përdorimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve rreth karakteristikave të popullsisë, shpërndarjes gjeografike dhe proceseve migruese në nivel lokal, rajonal dhe global.



## **7.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 7.2.1.** identifikon prirje të rritjes së popullsisë si pasojë e ndikimit të faktorëve ekonomikë, socialë, mjedisorë dhe politikë;
- 7.2.2.** parashikon tendenca të shpërndarjes gjeografike të popullsisë në botë;
- 7.2.3.** analizon çështje që lidhen me popullsinë dhe propozon zgjidhje të mundshme të këtyre problemeve;
- 7.2.4.** shpjegon rolin e faktorëve ekonomikë, socialë dhe politikë në proceset migruese në nivel kombëtar, rajonal dhe global;
- 7.2.5.** vlerëson ndikimin e migrameve në sistemet fizike dhe humane.

## **Standardi 8: MODELET EKONOMIKE DHE NDËRVARËSIA MIDIS TYRE**

### **8.1. Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i gjeografisë demonstroi përdorimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve rreth proceseve, modeleve dhe rrjeteve të ndërvarësisë ekonomike në botë.

### **8.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 8.2.1.** klasifikon dhe përshkruan shpërndarjen hapësinore të sistemeve ekonomike;
- 8.2.2.** interpreton rritjen e ndërvarësisë ekonomike në botë;
- 8.2.3.** identifikon dhe shpjegon pasojat gjeografike të tregtisë botërore;
- 8.2.4.** shpjegon si proceset ekonomike ndikojnë ndërvarësinë dhe bashkëpunimet në nivel rajonal dhe global.

## **Standardi 9: VENDBANIMET DHE TIPARET E TYRE**

### **9.1. Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i gjeografisë demonstroi përdorimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve rreth proceseve, modeleve dhe funksioneve të vendbanimeve.

### **9.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 9.2.1.** analizon karakteristikat e vendbanimeve në vendet e zhvilluara dhe në zhvillim;
- 9.2.2.** vlerëson ndikimin e sistemeve fizike dhe humane në tiparet e vendbanimeve në nivel lokal, rajonal dhe global;
- 9.2.3.** shpjegon, përmes shembujve konkretë, vendndodhjen dhe karakteristikat gjeografike të vendbanimeve urbane dhe rurale dhe mënyrën si kanë ndryshuar në kohë;
- 9.2.4.** shpjegon shkaqet dhe pasojat e urbanizimit në Shqipëri, Evropë, dhe në botë;
- 9.2.5.** përshkruan natyrën, shkaqet dhe ndikimin hapësinor të ndryshimeve në zonat urbane;
- 9.2.6.** identifikon tiparet e reja të zonave të sotme urbane.

## Standardi 10: MJEDISI DHE SHOQËRIA

### 10.1. Përshkrimi i standardit

Mësuesi i gjeografisë demonstroi përdorimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve rreth zhvillimit të qëndrueshëm, nxit dhe mbështet nxënësit të aftësohen për të kontribuar në debate dhe për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse mbi zhvillimin e qëndrueshëm si qytetarë të informuar dhe të përgjegjshëm.

### 10.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 10.2.1. interpreton konceptin për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- 10.2.2. analizon ndikimin pozitiv dhe negativ të veprimtarisë së njeriut në mjedis;
- 10.2.3. identifikon mënyrat e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- 10.2.4. shpjegon marrëdhënien ndërmjet burimeve dhe shfrytëzimit të tyre në Shqipëri dhe në botë;
- 10.2.5. vlerëson politikat dhe programet që lidhen me përdorimin e burimeve në rajone të ndryshme në Shqipëri dhe në botë;
- 10.2.6. vlerëson rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm përmes koordinimit të politikave globale të zhvillimit;
- 10.2.7. nxit nxënësit të zhvillojnë aftësi vendimmarrëse rreth çështjeve që lidhen me ndikimin dhe përgjegjësitë e shoqërisë mbi mjedisin.

## Standardi 11: PERSPEKTIVA HAPËSINORE

### 11.1. Përshkrimi i standardit

Mësuesi i gjeografisë demonstroi përdorimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve rreth organizimit hapësinor të sipërfaqes së Tokës, proceseve dhe dukurive gjeografike. Ai aftëson nxënësit për përdorimin e mjeteve gjeografike dhe teknologjisë për të shpjeguar dhe interpretuar shpërndarjen hapësinore të proceseve dhe dukurive fizike dhe humane në nivel lokal, rajonal dhe global.

### 11.2. Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 11.2.1. analizon dhe shpjegon organizimin hapësinor të njerëzve, vendeve dhe mjediseve përmes përdorimit të koncepteve hapësinore;
- 11.2.2. përdor modelet e organizimit hapësinor për të analizuar marrëdhënien ndërmjet vendeve;
- 11.2.3. përdor hartat dhe prezantimet e tjera gjeografike, teknologjitë gjeohapësinore dhe të menduarin hapësinor për të kuptuar dhe komunikuar informacionin gjeografik;
- 11.2.4. shpjegon avantazhin e përdorimit të prezantimeve të shumëllojshme gjeografike për t'iu përgjigjur pyetjeve gjeografike si dhe për zgjidhjen e problemeve gjeografike;
- 11.2.5. identifikon e shpjegon në harta tematike e gjeografike apo në instrumente digjitale

hapësinore, rajone të ndryshme të botës;

**11.2.6.** përdor hartat mendore për të organizuar informacionin rreth njerëzve, vendeve dhe mjediseve në pikëpamje hapësinore;

**11.2.7.** ndërton dhe interpreton grafikë të shpërndarjes hapësinore të proceseve dhe dukurive gjeografike.

## **Standardi 12: MJEDIS NDËRVEPRUES TË NXËNI**

### **12.1.Përshkrimi i standardit**

Mësuesi i gjeografisë përdor burime, rutina dhe procedura, të cilat sigurojnë një mjedis pozitiv, të sigurt, me nxënësin në qendër, që nxit dhe përmirëson të nxënit e nxënësve.

### **12.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

**12.2.1.** krijon një mjedis të nxëni në të cilin mbizotëron të menduarit, diskutimi, respekti për pikëpamjet e ndryshme;

**12.2.2.** krijon një mjedis të nxëni në të cilin zhvillohet dhe inkurajohet kompetenca qytetare, të pyeturit, zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja;

**12.2.3.** krijon një mjedis të nxëni, i cili mundëson që nxënësit të bashkëpunojnë, të diskutojnë, të gjejnë konsensus në grupe të vogla ose të mëdha, të pranojnë këndvështrimet e ndryshme me tolerancë, mirëkuptim dhe ndjeshmëri;

**12.2.4.** orienton nxënësit në marrjen e përgjegjësisë për procesin e tyre të të nxënit dhe zhvillon aftësitë e tyre për të marrë iniciativa.

## **3.5 Standardet profesionale të fushës “TIK dhe teknologji”**

### **Përshkrimi përmbledhës për fushën**

#### **3.5.1 Standardet profesionale të mësuesit të TIK-ut**

### **Përshkrimi përmbledhës**

Perspektiva e integritit në Bashkimin Evropian për arsimin në Shqipëri kërkon formësimin e realitetit të ri arsimor në funksion të kërkesave të shoqërisë së sotme, të cilat ndryshojnë përditë si pasojë e zhvillimeve globale të ekonomisë dhe të teknologjisë. Reflektimi i këtyre kërkesave në kurrikulën arsimore përmbush kompetencat kyçe të BE-së në arsim, duke e vendosur arsimin shqiptar përkrah sistemeve të tjera evropiane.

Një nga kompetencat kyçe të BE-së për arsimin është dhe aftësia për të përdorur teknologjinë e informacionit, e cila po bëhet gjithnjë e më e pranishme dhe e rëndësishme në procesin mësimor.

Pothuajse në të gjitha vendet evropiane TIK-u është bërë pjesë e domosdoshme e kurrikulave, si një metodologji e re në mësimdhënie.

Shoqata ndërkombëtare për teknologjinë e edukimit (ISTE) dhe UNESCO kanë përgatitur paketa standardesh të TIK-ut për mësuesit.

Këto paketa standardesh janë hartuar për shtetet, rajonet, shkollat dhe institucionet e arsimit për të lehtësuar dhe për të mundësuar integrimin e teknologjisë në programet lëndore, bazuar tashmë në standarde të njëjta ndërkombëtare.

Për t'iu përgjigjur ndryshimeve dhe sfidave të kohës për një mësimdhënie moderne dhe për ta vendosur sistemin arsimor shqiptar përkrah sistemeve arsimore evropiane është i domosdoshëm hartimi i standardeve të TIK-ut për mësuesit.

Standardet e TIK-ut për mësuesit kanë për qëllim të përcaktojnë **konceptet, njohuritë, aftësitë** që duhet të ketë mësuesi për zbatimin dhe integrimin e teknologjisë në procesin mësimor.

Ky set standardesh synon të përgatisë mësuesit për t'u bërë përdorues të teknologjive të ndryshme të informimit dhe komunikimit.

#### **Mësuesit aftësohen:**

për të marrë informacion dhe njohuri nga burime të ndryshme,  
për komunikim dhe shkëmbim njohurish,  
për efikasitet në punë.

#### **Standardet identifikojnë punën e mësuesit në katër fusha, të parashtruara si më poshtë:**

- Fusha e zhvillimit përmbajtësor të lëndës
- Zhvillimi profesional i mësuesve të lëndës
- Përdorimi i metodologjisë në mësimdhënie/ mësimnxënie. Pedagogjia
- Siguria dhe etika e komunikimit

“Standardet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësuesin” është një dokument i rëndësishëm i cili përfshin elementet e mëposhtme.

#### **Organizimi i dokumentit të mposhtëm:**

##### **- Titulli i fushës**

Titulli i fushës është një formulim konciz që përshkruan fushën kryesore të kompetencës.

##### **- Përshkrimi i fushës**

Përshkrimi i fushës përmban paketën e aftësive (shkathtësive) që mbulon secila fushë.

##### **- Titulli i standardit**

Titulli i standardit është një formulim konciz që përshkruan standardin kryesor.

##### **- Përshkrimi i standardit sipas fushës përkatëse**

Përshkrimi i standardit përmban paketën e treguesve që mbulon secili standard i fushës përkatëse.

#### **Fusha 1: Zhvillimi përmbajtësor i lëndës**

**Përshkrimi i fushës:** Kjo fushë synon zhvillimin e kompetencave që kanë të bëjnë me integrimin e lëndës së TIK-ut në procesin mësimor. Kjo fushë përmban njohuritë dhe aftësitë që lidhen me konceptet tematike dhe operationale të lëndës.

### **Standardi 1: BAZAT E KOMPJUTERIT DHE KONCEPTET TEKNOLOGJIKE**

### 1.1.Përshkrimi i standardit

Zotërimi i njohurive bazë të kompjuterit dhe i koncepteve teknologjike.

### 1.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 1.2.1. përdor terminologjinë që lidhet me kompjuterin dhe teknologjinë në të folur dhe në të shkruar, rrit në mënyrë të vazhdueshme njohuritë teknologjike dhe aftësitë për të qëndruar në një hap me teknologjinë e kuptueshme dhe bashkëkohore;
- 1.2.2. përdor operacionet teknologjike dhe konceptet që lidhen me të;
- 1.2.3. përdor sistemin kompjuterik;
- 1.2.4. operon në sistemin kompjuterik, në të gjithë rrjetin periferik përkatës për të instaluar me sukses dhe për të përdorur paketa të ndryshme të *softëare-it*;
- 1.2.5. zbaton teknika bazë të nevojshme të ndreqjes së defekteve për sistemin kompjuterik;
- 1.2.6. përdor *mausin, tastierën, skanerin, mikrofonin, kamerën digjitale, printerin, modemën dhe CD-ROM-in*;
- 1.2.7. demonstroi përdorimin e terminologjisë teknologjike të përshtatshme me detyrat, përzgjedhjen dhe përdorimin e *softëere-ve* për përcaktimin e detyrave të cilësisë, përshtatshmërisë, efektivitetit dhe eficiencës;
- 1.2.8. përshkruan funksionet bazë të *softëere-ve* aplikuese;
- 1.2.9. përdor internetin, postën elektronike, lokalizimin uniform të burimeve (URL), rrjetin lokal të zonës, rrjetin zonal të gjerë (ËAN), faqen e *Ëeb-it*;
- 1.2.10. përshkruan rëndësinë e përdorimit të teknologjisë në jetën e përditshme për individë të të gjitha moshave dhe si ndikon përdorimi i kësaj teknologjie në shoqëri.

## Standardi 2: NJOHJA E KOMPONENTËVE TË TIK-UT

### 2.1.Përshkrimi i standardit

Demonstrimi i njohurive dhe aftësive në operacionet bazë kompjuterike dhe pajisje të tjera të informimit përfshirë këtu problemet kryesore dhe mirëmbajtjen.

### 2.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 2.2.1. identifikon dhe përcakton funksionet e përbërësve kryesorë (monitor, CPU, tastierë, maus) të kompjuterit;
- 2.2.2. lidh si duhet përbërësit kryesorë, konfiguron pjesët shtesë të kompjuterit dhe instalon draiverat kur kërkohet);
- 2.2.3. konfiguron parametrat e kompjuterit të programeve të ndryshme harduer dhe softuer;
- 2.2.4. kupton funksionet bazë të sistemit operativ;
- 2.2.5. organizon dhe menaxhon skedarët dhe dosjet kompjuterike;
- 2.2.6. përdor pajisjet e magazinimit (hard disk, disketë, CD, USB etj.) për të ruajtur dhe

shpërndarë skedarët. Krijon një dosje me skedarët më të rëndësishëm;  
**2.2.7.** mbron kompjuterin nga viruset, hakerat, keqdashësit, spiunët etj.

### **Standardi 3: APLIKIMI I TEKNOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE**

#### **3.1.Përshkrimi i standardit**

Përdorimi i mjeteve të përshtatshme dhe produktive të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie.

#### **3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1.** përdor një përpunues teksti për të hyrë dhe për të përpunuar tekste dhe imazhe;
- 3.2.2.** formaton tekstin, kontrollon kufijtë (marginat), paraqitjen, faqosjen dhe tabelat;
- 3.2.3.** printon, ruan dhe rikthen tekst dokumenti nga një përpunues teksti;
- 3.2.4.** përdor një faqe llogaritëse për të futur të dhëna, për t'i renditur këto të dhëna dhe për të krijuar qeliza brenda tabelës;
- 3.2.5.** bën llogaritje, përdor formulë dhe krijon grafikë duke përdorur faqe llogaritëse;
- 3.2.6.** printon dhe ruan tabelat e të dhënave duke përdorur aplikacionin e faqes llogaritëse;
- 3.2.7.** përdor një paketë prezantimi për të shtuar tekst dhe për të renditur pjesët e prezantimit;
- 3.2.8.** përmirëson slaidet e prezantimit duke shtuar tinguj, duke përshtatur animacione dhe duke futur figura, imazhe;
- 3.2.9.** printon fletëpalosje të prezantimit dhe ruan slaidet e prezantuara;
- 3.2.10.** bën prezantime efektive në klasë duke përdorur slaidet dhe projektoren LCD;
- 3.2.11.** gjen imazhe digjitale dhe media të tjera nga faqet e internetit, CD, USB etj.;
- 3.2.12.** pret, ndryshon madhësinë, ngjyros saktë për të përmirësuar imazhet digjitale;
- 3.2.13.** përdor skedarë të ndryshëm duke përdorur *media players-at e duhura*;
- 3.2.14.** ndërthur së bashku filmime, muzikë dhe shton ose përmirëson titujt;
- 3.2.15.** bashkëngjit dhe konfiguron skanera, kamera, telefona celulare për të marrë, për të përfutur imazhe digjitale;
- 3.2.16.** ruan imazhet digjitale duke përdorur mediet optike (CD, DVD, disk flesh) “magazinat” në internet.

### **Standardi 4: PËRDORIMI EFEKTIV I INTERNETIT**

#### **4.1.Përshkrimi i standardit**

Planifikon dhe përdor strategji efektive për përdorimin online të TIK-ut.

#### **4.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1.** lidhet me internetin nëpërmjet dial-up ose LAN;



- 4.2.2. konfiguron dhe përdor shfletuesin e rrjetit dhe aplikacionet e ndihmës;
- 4.2.3. dërgon dhe merr e-mail-e me bashkëngjitje, menaxhon e-mail-et dhe përdor LAN dhe Ëeb-in bazuar në serverat e e-mail-it;
- 4.2.4. përdor efektivisht ëeb-in sinkron dhe asinkron bazuar në mjetet e komunikimit si IM, komunikimin me zë dhe telekonferencat;
- 4.2.5. lidh dhe përdor printera të përbashkët, dosje të përbashkëta dhe pajisje të tjera brenda një rrjeti;
- 4.2.6. përdor efektivisht motorët e kërkimit, udhëzimet e internetit dhe faqeshënuesit(bookmarks);
- 4.2.7. shkarkon dhe instalon aplikacione të rëndësishme duke përfshirë: freeëare, shareëare, shikueshmëri dhe aplikacionet mbështetëse.

## Fusha 2: ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE TË LËNDËS (TIK)

### Përshkrimi i fushës:

Kjo fushë përfshin kompetencat në lidhje me rritjen profesionale dhe zhvillimin, kërkimin shkencor novator dhe bashkëpunimin.

### Standardi 5: EKSPLOKIMI I ARRITJEVE NË TEKNOLOGJI

#### 5.1.Përshkrimi i standardit

Njohja e TIK-ut si domosdoshmëri për një zhvillim sipas standardeve bashkëkohore.

#### 5.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 5.2.1. identifikon *ëeb*site arsimore dhe portalet e tyre mësimore;
- 5.2.2. bashkëvepron në komunitetet edukative *online* dhe ka akses në revistat e ndryshme edukative;
- 5.2.3. rekomandon *site* të dobishme dhe të besueshme te kolegët dhe nxënësit;
- 5.2.4. rishikon programe të reja dhe ekzistuese për arsimin (edukimin).

### Standardi 6: EDUKIMI ONLINE

#### 6.1.Përshkrimi i standardit

Vlerësimi i vazhdueshëm dhe reflektimi mbi përdorimin e teknologjisë në profesion për zhvillim dhe risi (novacion).

#### 6.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 6.2.1. hulumton mbi përdorimin e teknologjisë në klasë;
- 6.2.2. ndjek orë mësimore apo programe zhvillimi sipas shkallëve online;
- 6.2.3. harton dhe zbaton një plan individual për rritje profesionale në lidhje me njohuritë dhe

## Standardi 7: KOMUNIKIMI ONLINE

### 7.1.Përshkrimi i standardit

Vlerësimi i vazhdueshëm dhe reflektimi mbi përdorimin e teknologjisë në profesion për zhvillim dhe risi (novacion).

### 7.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 7.2.1. merr pjesë aktive në forumet dhe diskutimet *online*;
- 7.2.2. shkëmben plane mësimore, fletë pune, modele dhe materiale mësimore nëpërmjet *ëbsite-ve*;
- 7.2.3. planifikon dhe vlerëson punën e vet dhe atë të të tjerëve për integrimin e TIK-ut në mësimdhënie;
- 7.2.4. punon efektivisht *online* për kryerjen e punës me standarde të larta;
- 7.2.5. ruan efektivitetin gjatë eksperimenteve të ndryshme të mënyrave të punës dhe në vendin e punës;
- 7.2.6. përshtatet ndaj ndryshimeve kurrikulare për t'i zbatuar ato në mësimdhënie në kohë sa më të shkurtër.

## Fusha 3: PËRDORIMI I METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE/ MËSIMNXËNIE. PEDAGOGJIA

**Përshkrimi i fushës:** Përfshirja e teknologjisë nënkupton përdorimin e kompjuterit dhe *softëare-ve* në mënyrë produktive, internetit dhe përdorimit të rrjeteve kompjuterike për qëllime komunikimi e menaxhimi. Mësuesit duhet të dinë ku, kur dhe si t'i përdorin.

## Standardi 8: MJEDISI I TË NXËNIT

### 8.1.Përshkrimi i standardit

Krijimi i mjediseve të hapura dhe fleksibël të të nxënit, ku teknologjia përdoret për të mbështetur larmi bashkëveprimesh mes nxënësish dhe ndarje përvojash mes kolegëve.

### 8.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 8.2.1. krijon ambiente pune të sigurta dhe fleksibël për nxënësit;
- 8.2.2. planifikon menaxhimin e burimeve të teknologjisë në kontekstin e aktiviteteve mësimore;
- 8.2.3. inkurajon nxënësit që të bëjnë analizën e të dhënave, zgjidhjen e problemeve, vendim-marrjen dhe shkëmbimin e ideve.

## Standardi 9: MENAXHIMI I TË DHËNAVE

### 9.1.Përshkrimi i standardit

Demonstron njohuri dhe aftësi në menaxhimin e informacionit dhe të të dhënave.

### 9.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 9.2.1. përdor efektivisht motorët e kërkimit, udhëzimet, kërkimin e ngadaltë dhe agjentët për të lokalizuar burimet e informacionit;
- 9.2.2. kërkon dhe mbledh informacion tekstual ose jotekstual nga burime online ose offline;
- 9.2.3. ruan dhe organizon efektivisht informacionin e mbledhur duke përdorur udhëzimet ose databazat;
- 9.2.4. shpërndan, boton dhe publikon informacionin nëpërmjet printimit ose internetit;
- 9.2.5. njeh burimet e duhura të informacionit, qofshin ato online dhe offline.

## Standardi 10: APLIKIMI I TEKNOLOGJISË NË KURRIKUL

### 10.1.Përshkrimi i standardit

Aplikimi i teknologjisë në kurrikul sjell ndryshime thelbësore në zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të nxënësit, nxit të menduarin kritik, krijues dhe problem-zgjidhës.

### 10.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 10.2.1. përdor teknologjinë për të inkurajuar nxënësit që të përdorin strategji e zgjidhje të problemave;
- 10.2.2. përdor teknologjinë për të zhvilluar te nxënësit aftësitë krijuese dhe kritike;
- 10.2.3. eksploron përdorimin e mjeteve të vlerësimit elektronik në formë testimi dhe dorëzon projektet përmes e-mail-it ose dorazi;
- 10.2.4. komunikon në mënyrë efektive informacione dhe ide të duhura për nxënësit, prindërit, kolegët duke përdorur shumëllojshmëri formatesh digjitale dhe të medias;
- 10.2.5. përdor në mënyrë efektive mjetet aktuale dhe mjetet e reja digjitale, për të gjetur, për të analizuar, për të vlerësuar dhe për të përdorur burimet e informacionit në mbështetje të kërkimit dhe të të mësuarit;
- 10.2.6. planifikon, krijon dhe redakton tekstin e dokumenteve duke përdorur shkrim të lexueshëm, shtrirjen e tekstit, rregullimin dhe përshtatjen e faqes së dokumentit, tabelat dhe opsione të tjera;
- 10.2.7. krijon dhe redakton të dhëna në *Excel* duke përdorur të gjitha llojet e të dhënave, formulave e funksioneve dhe të dhënave në grafik.

**Standardi 11: STRATEGJITË TEKNOLOGJIKE QË MBËSHTESIN MËSIMDHËNIEN/MËSIMNXËNIEN**

### **11.1.Përshkrimi i standardit**

Vlerësojnë përdorimin dhe integrimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe përdorin rezultatet e gjetura për të përmirësuar projektet mësimore.

### **11.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 11.2.1. informohet me të rejat e teknologjisë, që të mbështesë të nxënit e nxënësve;
- 11.2.2. përdor mjetet teknologjike në mënyrë efektive për të rritur produktivitetin në klasë;
- 11.2.3. përdor *spreadsheets* fletë për të analizuar, për të organizuar dhe për të treguar të dhëna numerike në mënyrë grafike;
- 11.2.4. harton strategji mësimore për mësimdhënien e aplikimeve teknologjike të TIK-ut dhe i integron ato në kurrikul;
- 11.2.5. përdor teknologjinë për të rritur produktivitetin dhe praktikën profesionale të tij;
- 11.2.6. vlerëson siç duhet projektet e nxënësve, duke përdorur metoda vlerësimi formale dhe joformale;
- 11.2.7. përdor burime mësimore për të pasuruar kurrikulën me qëllim krijimin e produkteve mësimore;
- 11.2.8. vlerëson informacionin online nëpërmjet hulumtimit dhe krahasimit të të dhënave nga burime të shumta.

## **Fusha 4: KOMUNIKIMI DHE ETIKA**

**Përshkrimi i fushës:** Kjo fushë përfshin kompetencat që lidhen me problemet shoqërore, etike, ligjore dhe njerëzore si dhe me komunitetin.

## **Standardi 12: SHOQËRIA DHE ETIKA**

### **12.1.Përshkrimi i standardit**

Njohja dhe praktikimi i përdorimit etik të teknologjisë në të dyja nivelet: personale dhe profesionale.

### **12.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 12.2.1. njeh burimet e duhura për t'i përdorur në punën e vet;
- 12.2.2. bëhet mbrojtës i antipiraterisë për të gjitha produktet që kanë të drejtë pronësie intelektuale si muzika, të dhënat, filmat etj.;
- 12.2.3. mbron përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive si kompjuter, telefon celular etj.;
- 12.2.4. tregon respekt për jetën private dhe rregullat e mirësjelljes në internet, në telefon dhe në përdorimin e teknologjive të ngjashme

## **Standardi 13: PËRDORIMI LIGJOR I TEKNOLOGJISË**

### **13.1.Përshkrimi i standardit**

Demonstrimi i njohurive dhe aftësive për zbatimin dhe respektimin e praktikave ligjore në përdorimin e teknologjisë.

### **13.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 13.2.1. përshkruan implikimet ligjore të licencave të *softëare*-it dhe të përdorimit të ndershëm (*Fair Use*);
- 13.2.2. zotëron konceptet themelore të të drejtave të pronësisë intelektuale;
- 13.2.3. identifikon dhe diferencon të drejtat e autorit, markat, patentat e produkteve të ndryshme informative;
- 13.2.4. diskuton ligjet për të drejtën e autorit, dhunën dhe çështjet që lidhen me *haker*-at e kompjuterëve, piraterinë kompjuterike, dërgimin e qëllimshëm të viruseve dhe me cenimet e privatësisë.

## **Standardi 14: TEKNOLOGJI E SIGURT NË MËSIMDHËNIE**

### **14.1.Përshkrimi i standardit**

Planifikon dhe promovon një teknologji të sigurt që mbështet zhvillimin e të nxënit.

### **14.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 14.2.1. demonstroi trajtimin e duhur të pajisjeve kompjuterike dhe përdorimin e aplikacioneve;
- 14.2.2. monitoron nxënësit se si përdorin kompjuterin dhe në mënyrë të veçantë softëere, hardëere, lojëra kompjuterike dhe aktivitete në internet;
- 14.2.3. ruan një mjedis të pastër dhe të rregullt zhvillimi të nxëni për nxënësit;
- 14.2.4. promovon dhe zbaton rregullat dhe rregulloren mbi mënyrën e përdorimit të kompjuterëve;
- 14.2.5. raporton me saktësi keqfunksionimet dhe problemet me programet kompjuterike.

## **Standardi 15: RESPEKTIMI I DIVERSITETIT**

### **15.1.Përshkrimi i standardit**

Lehtësimi i aksesit të barabartë në teknologji që i adresohet diversitetit të të mësuarit, diversitetit social dhe kulturor.

### **15.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 15.2.1. organizon veprimtari gjithëpërfshirëse në klasë për të integruar çdo nxënës në mësim;
- 15.2.2. krijon akses për përdorimin e materialeve digjitale nga të gjithë nxënësit e klasës;
- 15.2.3. përgatit plane mësimore dhe veprimtari të përshtatshme sipas nevojave të nxënësve;
- 15.2.4. përshtat aktivitetet duke përdorur *hardëare* dhe *softëare* të specializuara për nxënësit me probleme fizike;

15.2.5. nxit politika dhe praktika për të siguruar akses të barabartë të burimeve të medias dhe të teknologjisë për nxënësit pa dallim race, etnie, gjinie, besimi apo statusi social-ekonomik;

15.2.6. vlerëson informacionin e nxjerrë në mënyra të ndryshme nga nxënësit, duke përfshirë këtu kopje të printuara, prezantime në ekran, dokumente interneti dhe video.

### 3.6 Standardet profesionale të fushës “Edukim fizik, sporte dhe shëndeti”

#### Përshkrimi përmbledhës

Në përmbushjen e qëllimit për të siguruar arsim cilësor ky dokument është një qasje e re e standardeve profesionale për mësuesit e fushës së edukimit fizik, sporte dhe shëndeti. Standardet e mësuesit përcaktojnë se çfarë pritet që të dinë dhe të jenë në gjendje të demonstrojnë mësuesit që janë në sistem.

Këto standarde janë:

- ✓ bazë për përmirësimin e mësimdhënies dhe të të nxënit në fushë/lëndën edukim fizik, sporte dhe shëndet;
- ✓ bazë për hartimin e programeve të mësuesve dhe përgatitjes së tyre nga universiteti i sporteve;
- ✓ bazë për zhvillimin profesional të mësuesve të edukimit fizik në sistem;
- ✓ bazë për të siguruar përgatitjen cilësore të këtyre profileve mësuesish.

#### **Qëllimi i hartimit të standardeve profesionale të mësuesit fushë/lëndën Edukim fizik, sporte dhe shëndet.**

Standardet e kësaj fushe/lëndë për mësuesit kanë për qëllim të përcaktojnë **njohuritë dhe aftësitë** që duhet të ketë mësuesi i kësaj lënde në njohjen, zbatimin dhe integrimin e edukimit fizik, sportit dhe shëndetit gjatë procesit mësimor. Ky set standardesh synon të përgatisë mësuesit për t’u bërë zbatues të këtyre lëndëve në nivele të ndryshme shkollimi.

#### **Mësuesit aftësohen:**

- ✓ për të marrë informacion dhe njohuri nga burime të ndryshme;
- ✓ për komunikim dhe shkëmbim njohurish;
- ✓ për efikasitet në punë.

### **Standard 1: NJOHURI SHKENCORE DHE TEORIKE MBI EDUKIMIN FIZIK, SPORTE DHE SHËNDET**

#### **1.1.Përshkrimi i standardit**

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në edukimi fizik, për të



njohur dhe zbatuar disiplina shkencore dhe koncepte teorike mbi zhvillimin e edukimit fizik individual.

### **1.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 1.2.1. shpjegon dhe zbaton koncepte fiziologjike dhe biomekanike lidhur me aftësinë *lëvizore,aktivitetin fizik dhe fitnessin;*
- 1.2.2. shpjegon dhe zbaton lëvizjen motorike dhe teoritë fiziologjike/sjelljes lidhur me aftësinë lëvizore, aktivitetin fizik dhe fitnessin;
- 1.2.3. shpjegon dhe zbaton teorinë dhe konceptin e lëvizjes motorike lidhur me aftësinë lëvizore ,aktivitetin fizik dhe fitnessin;
- 1.2.4. shpjegon perspektivat historike,fiziologjike dhe sociale të çështjeve dhe legjislacionit të edukimit fizik;
- 1.2.5. analizon dhe korigjon elementet e lëvizjeve motorike dhe koncepteve të performancës fizike;

## **Standard 2: AFTËSI TË BAZUARA NË PERFORMANCË FIZIKE DHE FITNESS\***

### **2.1.Përshkrimi i standardit**

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në edukim fizik i cili demonstroi njohuri dhe aftësi të performancës lëvizore si dhe njohuri të zbatimit të fitnessit në shkollë.

### **2.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 2.1.1 analizon modele të performancës së *lëvizjes motorike* mbi shumëllojshmëri të aktiviteteve fizike dhe modeleve të lëvizjes;
- 2.1.2 zhvillon programe fitnessi të veçanta për nxënës me probleme shëndetësore;
- 2.1.3 analizon koncepte të performancës lidhur me *aftësitë lëvizore* mbi shumëllojshmëri të aktiviteteve fizike.

\* Mësuesi në edukim fizik disponon njohuri mbi trajtimin dhe inkurajimin e nxënësve me nevoja të veçanta, duke përdorur modele të modifikuara dhe të përshtatura për këtë kategori për demonstrimin e arritjeve të performancës lëvizore dhe fitnessit p.sh: programe trajnimi për peshën , ushtrime për trupin etj.

## **Standardi 3: NJOHURI DHE AFTËSI PEDAGOGJIKE NË LIDHJE ME LËNDËN E EDUKIMIT FIZIK, SPORTE DHE SHËNDETI**

### **3.1.Përshkrimi i standardit**

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi i edukimit fizik në

përdorimin e aftësive komunikuese dhe pedagogjike efektive për të nxitur dëshirën dhe rritur interesin për lëndën Edukim fizik, sporte dhe shëndet.

### **3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1** demonstroi aftësi komunikuese verbale dhe jo verbale gjatë veprimtarive të ndryshme mësimore dhe sportive;
- 3.2.2** jep modele mësimore efektive, duke nxitur lidhjen e koncepteve të aktiviteteve fizike me përvojën mësimore;
- 3.2.3** adapton modele mësimore, sipas infrastrukturës ekzistuese, për përvetësimin e njohurive dhe aftësive fizike;
- 3.2.4** njeh mjedisin mësimor dhe përshtat veprimtaritë sportive bazuar në përmbajtjet e programit mësimor dhe aftësive të nxënësve;
- 3.2.5** zgjedh rrugën metodike bashkëkohore në lidhje me elementët lëvizore gjatë procesit mësimor.

## **Standard 4: ROLI DHE FUNKSIONI I LËNDËS SË EDUKIMIT FIZIK SPORTE DHE SHËNDET NË KONTEKSTE TË NDRYSHME SOCIALE**

### **4.1 Përshkrimi i standardit**

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në edukimin fizik, për të analizuar sesi edukimi fizik dhe sporti funksionon në kontekstet e historisë, filozofisë, marrëdhënieve shoqërore e sociale.

### **4.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 4.2.1** zotëron njohuri mbi parimet e organizimit dhe administrimit të programeve gjithëpërfshirëse të edukimit fizik për të gjitha grup moshat sipas cikleve shkollore;
- 4.2.2** kupton se si aktiviteti fizik funksionon në marrëdhëniet kulturore e sociale të mjedisit përreth dhe një mjedisi më të gjerë;
- 4.2.3** shpjegon se si edukimi fizik ndikon dhe ka një funksion të caktuar për përhapjen e sportit dhe vlerave të tij në zhvillimin e shoqërisë;
- 4.2.4** analizon se si edukimi fizik ka kontribuar gjatë kohërave duke nxitur frymën e olimpizmit dhe fair play-t;
- 4.2.5** identifikon dhe promovon rolin e sportit në komunitet duke nxitur mundësinë e gjithëpërfshirjes me aktivitete fizike.

## **Standard 5: SIGURIA DHE NDIHMA E SHPEJTE NE EDUKIM FIZIK, SPORTE DHE SHËNDETI**

### 5.1 Përshkrimi i standardit

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në edukimin fizik, për të siguruar eliminimin e faktorëve të mundshëm që mund të dëmtojnë shëndetin e nxënësve dhe të evitojë çdo lloj shkak që prek sigurinë fizike të nxënësve.

### 5.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 5.2.1 zotëron njohuri mbi përdorimin e pajisjeve, materialeve (përfshirë edhe digjitale) për të nxitur të mësuarit në një mjedis të sigurt gjatë procesit mësimor;
- 5.2.2 zbaton udhëzimet mbi e sigurinë e ambienteve dhe mjeteve mësimore para dhe gjatë planifikimit të procesit mësimor;
- 5.2.3 zbaton parimet e ndihmës së shpejtë në situata të caktuara mësimdhënie;
- 5.2.7 zbaton rregullat e sakta në përdorimin e mjeteve didaktike, në zgjedhjen e ushtrimeve metodike, kryen korrigjimin e gabimeve dhe jep ndihmën për realizimin e ushtrimit.
- 5.2.8 zbaton njohuritë disiplinore dhe pedagogjike në zhvillimin e përvojave të sigurta mësimore.
- 5.2.9 aplikon procedurat e ndihmës së shpejtë në situata të caktuara duke vepruar i sigurt, përqendrohet dhe ruan qetësinë në një ndërhyrje në mënyrë korrekte.

## 3.7 Standardet profesionale të fushës “Arte”

### Përshkrimi përmbledhës

Në përmbushjen e qëllimit për të siguruar arsim cilësor ky dokument është një qasje e re e standardeve profesionale për mësuesit. Standardet e mësuesit përcaktojnë se çfarë pritet që të dinë dhe të jenë në gjendje për të bërë studentët që do të diplomohen si mësues të fushës së arteve, lënda muzikë dhe art pamor, por edhe standarde që përcaktojnë pritjet për të gjithë mësuesit që janë në sistem.

Këto standarde janë:

- ✓ bazë për përmirësimin e mësimdhënies dhe të të nxënësve në lëndët art pamor dhe muzikë;
- ✓ bazë për hartimin e programeve të mësuesve dhe përgatitjes së tyre nga universiteti i arteve;
- ✓ bazë për zhvillimin profesional të mësuesve të artit pamor dhe muzikës në sistem;
- ✓ bazë për zhvillimin profesional të mësuesve të rinj të artit pamor dhe muzikës;
- ✓ bazë për zhvillimin e vazhdueshëm profesional;
- ✓ bazë për të siguruar përgatitjen cilësore të këtyre profileve mësuesish.

### Qëllimi i hartimit të standardeve profesionale të mësuesit përkatësisht në lëndët art pamor dhe muzikë.

Standardet e këtyre lëndëve për mësuesit kanë për qëllim të përcaktojnë njohuritë dhe aftësitë që duhet të ketë mësuesi i këtyre lëndëve në njohjen, zbatimin dhe integrimin e artit pamor dhe muzikës gjatë procesit mësimor. Ky set standardesh synon të përgatisë mësuesit për t'u bërë zbatues të këtyre lëndëve në nivele të ndryshme shkollimi.

**Mësuesit aftësohen:**

- ✓ për të marrë informacion dhe njohuri nga burime të ndryshme;
- ✓ për komunikim dhe shkëmbim njohurish;
- ✓ për efikasitet në punë.

**3.7.1 Standardet profesionale të mësuesit të artit pamor****Standard 1: GJUHA ARTISTIKE DHE ARTI PAMOR****1.3.Përshkrimi i standardit**

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në artin pamor, në lidhje me elementet, parimet dhe cilësitë shprehëse të artit pamor.

**1.4.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 1.4.1. zotëron elementet e gjuhës pamore: *ngjyrën, formën dydimensionale, vijën, formën tri dimensionale, teksturën, hapësirën dhe vlerën;*
- 1.4.2. zotëron parimet e kompozimit: *balancën, kontrastin, harmoninë (motivin, ritmin), lëvizjen dhe unitetin;*
- 1.4.3. shpjegon cilësitë shprehëse të artit pamor dhe rolin e tyre në komunikimin e ideve;
- 1.4.4. shpjegon karakteristikat e *hapësirës dy dhe tri dimensionale* dhe të *dimensionit të katërt*, në kohë;
- 1.4.5. analizon dhe demonstroi gjatë procesit të mësimdhënies, elementet dhe parimet e gjuhës pamore;
- 1.4.6. analizon dhe demonstroi gjatë procesit të mësimdhënies, cilësitë estetike (p. sh., elementet, parimet dhe idetë shprehëse) dhe mënyrën se si ato gjenden dhe janë përdorur në veprat e artit;
- 1.4.7. analizon dhe vlerëson gjatë procesit të mësimdhënies, mënyrën sesi janë përdorur cilësitë estetike për të përcjellë idenë në veprat e artit.

**Standard 2: LIDHJA E ARTIT PAMOR ME FUSHA TË NDRYSHME TË ARTIT****2.3.Përshkrimi i standardit**

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në artin pamor, për të kuptuar ngjashmëritë, dallimet dhe pikat e lidhjes midis fushave të ndryshme të artit.

**2.4.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 2.4.1. krahason elementet, parimet dhe mjetet e përdorura në dy ose më shumë vepra të artit pamor;

- 2.4.2. dallon në vepra arti të disiplinave të ndryshme artistike, që ndajnë të njëjtat procese, ide shprehëse, tematika, periudha historike dhe kontekste sociale dhe i krahason ato me njëra tjetrën;
- 2.4.3. kupton se si forma arti të ndryshme kombinohen për të krijuar një vepër arti të ndërthurur (p.sh., teatër muzikor dhe kinematografi);
- 2.4.4. bashkëpunon gjatë procesit të mësimdhënies, me specialistë të fushave të tjera të artit, duke ndërthurur njohuritë për të realizuar një vepër artistike;
- 2.4.5. analizon dhe vlerëson karakteristikat e njëjta dhe bën dallimet midis veprave në fusha të ndryshme artistike.

### Standard 3: TEKNIKAT DHE PROCESET ARTISTIKE

#### 3.1.Përshkrimi i standardit

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në artin pamor, në lidhje me procesin dhe realizimin e veprave artistike.

#### 3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 3.2.1. përdor mjetet dhe teknikat artistike në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme;
- 3.2.2. demonstroi aftësi në përdorimin e pesë proceseve artistike (p.sh., stampimin, fotografinë, skulpturën, kolazhin, tekstilet dhe mediet elektronike);
- 3.2.3. shpjegon sesi përzgjedhja e mjeteve/teknikave dhe proceseve krijon efekte të veçanta;
- 3.2.4. vlerëson duke analizuar sesi përzgjedhja e materialeve, mjeteve, teknologjisë dhe proceseve përdoret për të mbështetur dhe ndikuar në komunikimin e ideve;

### Standard 4: NJOHURI DHE AFTËSI PËR PROCESIN KRIJUES

#### 4.1.Përshkrimi i standardit

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në artin pamor, për të krijuar në mënyrë shprehëse me një sërë mjeteve dhe teknikash artistike.

#### 4.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 4.2.1. kupton rëndësinë e aftësive manipuluese, duke përdorur procese kreative për të shprehur idetë, të nevojshme për të realizuar vepra arti;
- 4.2.2. kupton rëndësinë e komunikimit qartë të ideve artistike, bazuar në planifikimin dhe në përzgjedhjen e teknikave për të krijuar punë arti.;
- 4.2.3. demonstroi aftësi dhe sugjeron rrugë të ndryshme gjatë procesit të mësimdhënies, për krijimin e veprave të artit *dy* dhe *tredimensionale*;
- 4.2.4. demonstroi aftësi dhe sugjeron rrugë të ndryshme gjatë procesit të mësimdhënies, për krijimin e veprave të që janë *realiste*, *abstrakte*, *konceptuale*, *funksionale* dhe

*dekorative;*

- 4.2.5.** demonstroi dhe sugjeroi rrugë të ndryshme gjatë procesit të mësimdhënies, për zhvillimin e aftësive manipuluese, në realizimin e veprave të artit, duke përdorur në një sërë teknikash artistike.

## **Standard 5: METODOLOGJITË E MËSIMDHËNIES NË ARTIN PAMOR**

### **5.1.Përshkrimi i standardit**

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në artin pamor, në lidhje me zbatimin e metodologjive të ndryshme të mësimdhënies në lëndën e artit pamor.

### **5.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 5.2.1.** përshkruan zhvillimin moshor të fëmijëve dhe parimet psikologjike të mësimdhënies në artin pamor, duke mundësuar zbatimin e tyre në procesin mësimor;
- 5.2.2.** demonstroi zotërimin e një sërë strategjish të mësimdhënies së artit pamor dhe zbatimin e tyre në përshtatje me grupmosha të ndryshme;
- 5.2.3.** zotëron aftësi në organizimin e mjedisit të të nxëniet në lëndën e artit pamor për të rritur maksimalisht vëmendjen dhe interesin ndaj tij;
- 5.2.4.** demonstroi rëndësinë e vlerësimit dhe metodat e ndryshme të vlerësimit në lëndën e artit pamor;
- 5.2.5.** kuptoi nevojën për rritjen e vazhdueshme të nivelit profesional në artin pamor nëpërmjet studimit të vazhdueshëm dhe vetëvlerësimit;
- 5.2.6.** përshkroi strategji të mësimdhënies bazuar në artin pamor dhe zhvilloi metoda të vlerësimit të tyre edhe sipas nevojave individuale të nxënësve, prejardhjes kulturore dhe nevojave të veçanta të tyre;
- 5.2.7.** përdori në mënyrë efektive: *teknologjinë, materialet dhe mjedisin fizik*, për ta bërë më të lehtë mësimnxënien në lëndën e artit pamor;
- 5.2.8.** artikuloi një arsyetim logjik për rolin e artit pamor në kurrikulën shkollore, duke përfshirë bazat filozofike dhe sociale të edukimit artistik;
- 5.2.9.** zhvilloi më tej njohuritë artistike, duke u bërë pjesë e veprimtarive të zhvillimit profesional (p.sh., kurse profesionale dhe workshope);
- 5.2.10.** identifikoi dhe zbatoi metoda të ndryshme të mësimdhënies, duke integruar artin pamor me format e tjera të artit dhe fushat e tjera të të nxëniet në kurrikul.

## **Standard 6: ROLI DHE FUNKSIONI I ARTIT PAMOR NË KONTEKSTE TË NDRYSHME KULTURORE DHE SOCIALE**



### 3.1 Përshkrimi i standardit

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në artin pamor, për të analizuar sesi arti pamor funksionon në histori, shoqëri dhe në jetën e përditshme.

### 3.2 Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 3.2.1 kupton sesi arti pamor funksionon në kontekstin kulturor dhe social të mjedisit përreth dhe një mjedisi më të gjerë;
- 3.2.2 shpjegon sesi arti pamor ndikon dhe ka një funksion të caktuar në aplikimet komerciale (p.sh., mas media, mjedisin dhe produktin e dizajnit);
- 3.2.3 shpjegon rolin dhe funksionin e artit pamor në shoqëri dhe se si ai ndryshon me kalimin e kohës;
- 3.2.4 kupton se si zhvillohet dhe ndryshon interesi i karrierës profesionale edhe në artin pamor si bazë e ndryshimeve historike dhe sociale që pëson shoqëria dhe mjedisi;
- 3.2.5 analizon sesi arti pamor ka kontribuar gjatë kohërave lidhur me *komunikimin, festimet, punësimin, politikën dhe argëtimin*;
- 3.2.6 analizon sesi arti pamor është përdorur si një mjet i qëllimtë për të informuar dhe për të bindur masat dhe për të ndryshuar konceptet mbi artin dhe shoqërinë;
- 3.2.7 analizon ndikimin, rolin dhe funksionin e artit pamor në kultura dhe periudha të ndryshme historike.

## Standard 7: NDIKIMI I ARTIT PAMOR NË SHOQËRI DHE JETËN E PËRDITSHME

### 7.1.Përshkrimi i standardit

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në artin pamor, për të argumentuar sesi ai reflekton historinë, formon shoqërinë dhe ndikon në jetën e përditshme.

### 7.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 7.2.1. evidenton karakteristikat dalluese të veprave historike dhe atyre bashkëkohore nga periudha dhe kultura të ndryshme;
- 7.2.2. analizon artin pamor dhe sesi ai reflekton dhe ndryshon duke iu përgjigjur ndryshimeve shoqërore;
- 7.2.3. shpjegon ndikimin e medieve dhe artit pamor, në shoqëri.
- 7.2.4. analizon dhe klasifikon karakteristikat dalluese të veprave historike të artit dhe të veprave bashkëkohore të artit nga periudha dhe kultura të ndryshme;
- 7.2.5. analizon sesi arti formon dhe reflekton ide, çështje dhe tema në një sërë kulturash dhe periudha historike.

### 3.7.2 Standardet profesionale të mësuesit të muzikës

#### Standard 1: GJUHA E MUZIKËS

##### 1.1.Përshkrimi i standardit

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në muzikë në lidhje me njohuritë muzikore dhe përdorimin e gjuhës së muzikës.

##### 1.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Mësuesi:

- 1.2.1. shpjegon rolin dhe funksionin e elementeve të gjuhës muzikore: ritmin dhe modelet ritmike, melodinë dhe strukturën e saj, intervalet muzikore, etj.; harmonia, ndërtimi i melodisë, forma muzikore: vokale, instrumentale, etj.;
- 1.2.2. demonstroi kuptimin e termave dinamike dhe shenjave të ngjyritimit gjatë ekzekutimit të veprave muzikore;
- 1.2.3. shpjegon simbolet muzikore - çelësin, kohët e ndryshme muzikore të thjeshta, të përbëra dhe të përziera, vlerat e pushimit, termat dinamike dhe simbolet të tjera muzikore;
- 1.2.4. zotëron dhe përdor një fjalor bazë të gjuhës muzikore;
- 1.2.5. përdor simbolet muzikore për të komunikuar dhe shpjeguar njohuritë muzikore;
- 1.2.6. përdor fjalorin muzikor brenda kontekstit të muzikës që është shkruar apo që luhet dhe dëgjohet.

#### Standard 2: ZBATIMI I TEKNIKAVE DHE PROCESIVE MUZIKORE

##### 2.1.Përshkrimi i standardit

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në muzikë, në zhvillimin e proceseve muzikore dhe praktikimin e njohurive muzikore për të drejtuar ansamble të ndryshme vokale dhe instrumentale.

##### 2.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit

Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit të njohurive:

Mësuesi:

- 2.2.1 përdor metodën e përshtatshme për të shpjeguar *karakteristikat timbrike të zërit* të njeriut si ndryshon nga fëmijëria e hershme e deri në fund;
- 2.2.2 përdor metodën e përshtatshme për të shpjeguar *karakteristikat timbrike të instrumenteve* me goditje;
- 2.2.3 përdor metodën e përshtatshme për të shpjeguar *karakteristikat e instrumenteve ritmike dhe melodike* (duke përfshirë instrumentet popullore);
- 2.2.4 demonstroi aftësi në shpjegimin e *teknikave të të kënduarit dhe luajtjes në instrument solo dhe në grup*;
- 2.2.5 performon me instrumente ritmike dhe melodike (të paktën 1 instrument, duke përfshirë

- instrumentet popullore);
- 2.2.6** zotëron aftësi të interpretimit të kënduarit dhe luajtjes në instrument solo dhe në grup;
- 2.2.7** zotëron aftësi të drejtimit të koreve me shumë zëra, duke iu përgjigjur nivelit të shkollës dhe programit mësimor;
- 2.2.8** zotëron aftësi të drejtimit të ansambleve vokale dhe instrumentale, duke iu përgjigjur nivelit të shkollës dhe programit mësimor;
- 2.2.9** krijon dhe shpjegon modele të ndryshme ritmike me instrumente me goditje.
- 2.2.10** shpjegon rëndësinë e muzikës në arsimin parauniversitar (1-12);
- 2.2.11** demonstroi aftësi në aspektin e shpjegimit se si të interpretohet muzika përmes:
- teknikave vokale,
  - teknikave instrumentale,
  - shoqërimit përmes një vegje muzikore,
  - zhvillimin praktik të ansambleve vokale apo instrumentale;
- 2.2.12** kupton dhe zbaton kriteret për vlerësimin e një shfaqjeje muzikore apo krijimeve të ndryshme muzikore.
- 2.2.13** drejton performimin/interpretimin e klasës solo, punën me ansamble të vogla apo ansamble të mëdha (korin);
- 2.2.14** përdor dhe zbaton në mënyrën të përshtatshme (sipas grupmoshës ku jep mësim) një fjalor muzikor për vlerësimin e shfaqjeve dhe krijimeve muzikore.

### **Standard 3: ZHVILLIMI I KULTURAVE MUZIKORE SIPAS PERIUDHAVE HISTORIKE**

#### **3.1.Përshkrimi i standardit**

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në muzikë rreth shpjegimit historik të muzikës, duke analizuar rolin dhe funksionin e saj në një shumëllojshmëri kulturash muzikore dhe ndikimeve të saj në shoqëri sipas periudhave historike.

#### **3.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 3.2.1.** kupton se si muzika funksionon në kontekste të ndryshme kulturore dhe sociale;
- 3.2.2.** analizon sesi muzika ka kontribuar dhe kontribuon në periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe sociale ( në festimet, luftërat, argëtimet);
- 3.2.3.** analizon karakteristikat dalluese të veprave muzikore nga periudha dhe kultura të ndryshme dhe se si zhvillohet ajo, duke iu përgjigjur ndryshimeve dhe konteksteve aktuale shoqërore;
- 3.2.4.** shpjegon se si veprat muzikore të kompozitorëve të ndryshëm, përfaqësojnë kulturën e një shoqërie nga e shkuara deri tek e tashmja, (p.sh, analizon marrëdhëniet mes muzikës dhe aspekteve të tjera të shoqërisë në periudha të ndryshme Mesjetë, Rilindje, Barok, Romantizëm etj.);
- 3.2.5.** shpjegon se si është zhvilluar muzika dhe jep karakteristikat kryesore që i dallojnë

- veprat muzikore serioze dhe bashkëkohore sipas stilit dhe periudhës;
- 3.2.6. shpjegon stilet dhe gjinitë përmes zhvillimit historik dhe kulturor, kombëtar dhe botëror.
  - 3.2.7. analizon shumëllojshmërinë e *stileve dhe rrymave muzikore* që përfaqësojnë kultura muzikore të vendeve të ndryshme;
  - 3.2.8. transmeton idenë dhe emocionet e një kulturë muzikore të caktuar përmes motiveve kombëtare (p.sh, motivi popullor shqiptar, hungarez, italian, gjerman, rus etj.);
  - 3.2.9. shpjegon se si muzika funksionon në jetë e përditshme edhe në aspektin komercial përmes (p.sh., studiove muzikore, reklamave, shëndeti, etj.);
  - 3.2.10. analizon se si muzika është zgjeruar dhe zhvilluar, duke u bazuar në teknologjitë e reja dhe ndryshimet shoqërore;
  - 3.2.11. demonstroi aftësi në përdorimin e teknologjive të reja dhe ndikimet që jep ajo në shoqëri;
  - 3.2.12. analizon rolin dhe funksionin e muzikës në jetën e përditshme përmes komercit (p.sh., filma dhe reklama);
  - 3.2.13. vlerëson anët pozitive dhe negative të zhvillimit të karrierës në muzikë.

#### **Standard 4: METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES DHE ZBATIMI GJATË PROCESIT MËSIMOR NË MUZIKË**

##### **4.1.Përshkrimi i standardit**

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në muzikë për të zbatuar njohuritë pedagogjike dhe metodologjitë e duhura në procesin e mësimdhënies së muzikës.

##### **4.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

###### **Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit të njohurive:**

Mësuesi:

- 4.2.1. shpjegon rëndësinë dhe vendin e muzikës në arsimin parauniversitar (1-12);
- 4.2.2. zotëron metodat e mësimdhënies gjatë mësimin të muzikës në shkallën e parë dhe të dytë të arsimit fillor, (klasa 1-5);
- 4.2.3. zotëron metodat e mësimdhënies gjatë mësimin të muzikës në shkallën e tretë dhe të katërt të arsimit të mesëm të ulët, (klasa 6-9);
- 4.2.4. zotëron metodat e mësimdhënies gjatë mësimin të muzikës që lidhen me teknikat vokale dhe instrumentale [muzika korale (1-12) si dhe muzika instrumentale (1-9)];
- 4.2.5. përdor metoda specifike të mësimdhënies duke ndërthurur muzikën dhe instrumentin, të nxënësit me nevoja të veçanta;
- 4.2.6. demonstroi aftësi të integritit të muzikës me lëndët brenda fushës së arteve dhe fushat e tjera të kurrikulës;
- 4.2.7. identifikon dhe përdor llojet të ndryshme të teknologjisë të përshtatshme për të bërë muzikë, sipas programit mësimor/ muzikor;
- 4.2.8. zbaton me korrektësi teknikat e vlerësimit të nxënësve në muzikë dhe arritjeve të tyre,

sipas kërkesave të programit mësimor.

## **Standardi 5: LIDHJA E MUZIKËS ME ARTET DHE FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT**

### **5.1.Përshkrimi i standardit**

Ky standard synon të arrijë kompetencën që duhet të zotërojë mësuesi në muzikë, duke lidhur lloje të ndryshme të njohurive dhe të aftësive të muzikës brenda lëndës apo dhe me arte të tjera.

### **5.2.Treguesit që lidhen me demonstrimin e standardit**

Mësuesi:

- 5.2.1.** shpjegon parimet estetike të muzikës.
- 5.2.2.** identifikon ngjashmëritë dhe dallimet në kuptimin e termave artistike të përbashkëta në arte të ndryshme;
- 5.2.3.** identifikon dhe demonstroi se si bashkëveprojnë konceptet muzikore edhe me fusha të tjera të të nxënës që mësohen në shkollë (p.sh: fizika zhvillon njohuritë e dridhjeve të tingullit.);
- 5.2.4.** zbaton parimet e muzikës brenda lëndës dhe me artet e tjera.

## PJESA E KATËRT: VETËVLERËSIMI I MËSUESIT BAZUAR NË STANDARDET PROFESIONALE

Mësuesi është përgjegjës për arritjet e nxënësve të tij. Atij i duhet të shqyrtojë here pas here se si po e përmbush këtë përgjegjësi. Analiza serioze, e detajuar e periodike e vetes mbi bazën e këtyre standardeve i jep mësuesit një mundësi të çmuar për të kuptuar në kohë pikat e tij të forta dhe ato të dobëta.

Përshkrimet e mëposhtme vlejné thjesht për të ndihmuar mësuesin të vetëvlerësohet dhe orienton drejtuesin për të vlerësuar performancën e mësuesit. Vetëvlerësimi mund të bëhet me katër nivele dhe secilit nivel i takon një numër i caktuar pikësh. Këto nivele dhe pikët përkatëse janë:

Përshkrimi i nivelit	Niveli
Arritje shumë të mira	4
Arritje të mira që kanë nevojë për përmirësim	3
Arritje të mjaftueshme që kanë nevojë të konsiderueshme për përmirësim	2
Arritje të dobëta që kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim	1

Mësuesi mund të vlerësojë veten për një bllok treguesish, si p.sh. për aftësitë e tij të komunikimit, ose vetëm për një standard, ose bën një vlerësim tërësor të tij, d.m.th. për të gjitha standardet një nga një.

### Shembull

#### Standardi: “Komunikimi dhe Etika”.

**Treguesi 11.4.7:** “Mësuesi është transparent në veprimtarinë e tij dhe krijon në mjediset e të nxënësve kulturën e transparencës”.

Në këtë tregues, ashtu si edhe në disa tregues të tjerë, kërkohet që mësuesi, jo vetëm, të gëzojë një virtut profesional, siç është transparenca e veprimeve të tij, por edhe të jetë i aftë të krijojë të njëjtën kulturë me nxënësit e tij. Pra, vetëvlerësimi ka dy përmasa. Njëra përmasë është thjesht veçori e karakterit të tij (A është transparent ai?), kurse përmasa tjetër është një aftësi profesionale (A është ai i aftë të kultivojë kulturë e transparencë me nxënësit e tij?).

Pyetësorë pa emër me nxënësit e prindërit për aspekte të caktuara të punës së tij, i japin mundësi të vlefshme të përmirësojë punën e tij.



Nëse mësuesi është i interesuar në mënyrë të veçantë të kuptojë sa e përmbush standardin, duhet të analizojë veç e veç secilin tregues. Pastaj gjen shumën e pikëve. Këtë shumë e pjesëton me numrin e treguesve dhe rezultatin e rumbullakos me një shifër pas presjes. P.sh.:

Nr.	Standardi 11: “Komunikimi dhe etika” Vlerësimi i treguesit	Niveli
11.2.1	respekton të drejtat e liritë e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve dhe është i aftë të krijojë në mjediset e të nxënësve atmosferën ku respektohen këto të drejta;	3
11.2.2	krijon një mjedis miqësor për nxënësit;	2
11.2.3	nuk ushtron diskriminim, dhunë, keqtrajtim e dëm moral të nxënësit dhe të personeli;	2
11.2.4	kultivon te nxënësit respektin ndaj dallimeve individuale, kulturave të etnive dhe popujve të tjerë:	3
	<ul style="list-style-type: none"> <li>a) duke përdorur stile dhe praktika të ndryshme të komunikimit me nxënësit, kolegët, prindërit etj.;</li> <li>b) duke komunikuar hapur, në mënyrë korrekte, bindëse dhe frymëzuese me nxënësit;</li> <li>c) duke krijuar në mjediset e të nxënësve frymën e komunikimit të hapur e të lirshëm të nxënësve me të dhe të nxënësve në mes tyre;</li> </ul>	
11.2.5	krijon një atmosferë, ku nxënësit ndjehen të lirshëm të pyesin atë dhe shokët dhe të mos kenë frikë se gabojnë, si dhe kultivon kurajën e tyre për të shprehur mendimin vetjak	3
11.2.6	është transparent në veprimtarinë e tij dhe krijon në mjediset e të nxënësve kulturën e transparencës	2
11.2.7	është i hapur ndaj gabimeve të tij dhe krijon në mjediset e të nxënësve një klimë të hapur dhe reflektuese	4
11.2.8	përdor metoda të ndryshme të negociimit, të zgjidhjes së konflikteve dhe të arritjes së konsensusit në marrëdhëniet me kolegët, me nxënësit dhe të nxënësve mes tyre	3
11.2.9	shmang çfarëdo lloj konflikti interesi dhe njofton drejtorin e institucionit për raste të tilla.	3
<b>SHUMA E PIKËVE</b>		<b>26</b>
<b>MESATARJA E PIKËVE</b>		<b>26:9=2.9</b>

Kur mesatarja e pikëve është 1 deri në më pak se 1,8, standardi vetëvlerësohet “Niveli 1”. Mesatarja nga 1,9 deri në më pak se 2,5 tregon që standardi është “Niveli 2”. Standardi është “Niveli 3”, kur mesatarja e pikëve është nga 2,6 deri në më pak se 3,3, kurse mbi 3,4 - 4 është “Niveli 4”. Në shembullin e mësipërm, mësuesi vlerësohet “Niveli 3” për standardin “Komunikimi dhe etika”.

Sigurisht ky vetvlerësim është vetëm sugjerues.